

# RAPORT I DYTË I MONITORIMIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (2016-2020)



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



**SHDPAK**  
FONDACIONI  
SHQIPTAR  
PËR TË DREJTAT  
E PERSONAVE ME  
AFTËSI TË KUFIZUAR



**World Vision**





# **RAPORT I DYTË I MONITORIMIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (2016-2020)**

**DHJETOR 2020**

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadrin e projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, i cili zbatohet nga “World Vision Albania”, “Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (FShDPAK), dhe “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësitë Kufizuar” (MEDPAK).

Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e ADRF, WVA, MEDPAK dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# Tabela e Përmbajtjes

---

<b>Parathënie</b> .....	<b>7</b>
<b>Lista e tabelave</b> .....	<b>8</b>
<b>Shkurtime</b> .....	<b>11</b>
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>12</b>
<b>1. Hyrje</b> .....	<b>20</b>
<b>2. Metodologjia</b> .....	<b>22</b>
2.1. Instrumenti.....	22
2.2. Kampionimi .....	23
2.3. Mbledhja e të dhënave .....	26
2.4. Analiza e të dhënave.....	26
2.5. Kufizimet e studimit .....	27
<b>3. Gjetjet e studimit</b> .....	<b>28</b>
3.1. Aksesueshmëria .....	29
3.2. Barazia në sistemin e drejtësisë .....	37
3.3. Arsimi, formimi profesional dhe punësimi .....	42
3.4. Arsimi .....	48
3.5. Kujdesi shoqëror.....	52
3.6. Kujdesi shëndetësor.....	59
3.7. Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike.....	65
3.8. Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit .....	70
<b>4. Përfundime</b> .....	<b>72</b>
<b>5. Rekomandime</b> .....	<b>74</b>
<b>6. Shtojca</b> .....	<b>82</b>
6.1. Shtojca A: Instrumentet dhe forma e pëlqimit.....	82
6.2. Shtojca B: Përqindjet sipas aktiviteteve të çdo qëllimi .....	103



# Parathënie

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) është dokumenti strategjik i Qeverisë shqiptare për përfshirjen dhe integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.483, datë 29.06.2016. Plani përmban aktivitete për periudhën 2016-2020 dhe përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve duke vendosur një theks të veçantë mbi bashkëpunimin mes institucioneve në nivel qendror dhe vendor, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Plani Kombëtar i Veprimit parashikon monitorimin e përvitshëm të PKVPAK në nivel vendor dhe mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të realizuar një raport progresi të pavarur. Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, që zbatohet nga “World Vision Albania”, “Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (FShDPAK), dhe “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara” (MEDPAK) në vitin 2019 është realizuar raporti i parë i monitorimit të PKVPAK, përmes të cilit u vlerësua zbatimi i PKVPAK nga prespektiva e vetë personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe organizatave që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar në Berat, Dibër, Korçë dhe Lezhë. Ky është raporti i dytë i monitorimit i cili u realizua bazuar në të njëjtën metodologji me raportin e parë, me qëllim identifikimin e ndryshimeve të ndodhura, gjatë vitit 2020, në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, në të katër rajonet, për zbatimin e PKVPAK.

Falenderojmë personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar si dhe organizatat e shoqërisë civile, në bashkitë Berat, Dibër, Korçë dhe Lezhë që u përfshinë dhe u bënë pjesë e procesit. Falenderojmë institucionet shtetërore në nivel rajonal e vendor, qendrat që ofrojnë shërbime dhe administratorët socialë pranë bashkive dhe njësisive administrative, si dhe përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar, për ndihmën e ofruar për identifikimin e personave me aftësi të kufizuara sipas tabelës së kampionimit të këtij raporti të monitorimit të PKVPAK. Falenderim për ekipin e organizatave “World Vision Albania”, “Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (FShDPAK), dhe “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara” (MEDPAK) partnerë në zbatimin e projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, për ndihmën e ofruar në realizimin e këtij raporti, si edhe falenderim të veçantë për ekspertin kryesore që udhëhoqi dhe realizoi procesin, Msc. Kristina Voko. Shprehim mirënjohje dhe falenderim për Bashkimin Evropian, për mbështetjen financiare për hartimin e raportit të monitorimit të PKVPAK.

# Lista e tabelave

---

- Tabela 1: Kampioni sipas subjekteve nga organizatat dhe personat me aftësi të kufizuara e familjarët e tyre
- Tabela 2: Kampioni sipas bashkive dhe vendbanimit për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë
- Tabela 3: Kampioni persona me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë
- Tabela 4: Kampioni familjarë sipas gjinisë së tyre dhe llojit të aftësisë së kufizuar të të afërmit
- Tabela 5: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me aksesueshmërinë nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 6: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me aksesueshmërinë nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 7: Aksesueshmëria fizike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 8: Aksesueshmëria fizike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 9: Aksesimi në informacion vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 10: Aksesimi në informacion vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 11: Aksesueshmëria në transport publik vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 12: Aksesueshmëria në transport publik vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 13: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 14: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 15: Ndihma juridike falas vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 16: Ndihma juridike falas vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 17: Sigurimi i barazisë para ligjit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 18: Sigurimi i barazisë para ligjit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 19: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me pjesëmarrjen në tregun e punës dhe promovimin e mundësive të barabarta nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 20: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me pjesëmarrjen në tregun e punës dhe promovimin e mundësive të barabarta nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 21: Përmirësimi i cilësisë së AFP-së vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 22: Përmirësimi i cilësisë së AFP-së vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 23: Integrimi në tregun e punës vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 24: Integrimi në tregun e punës vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 25: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 26: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 27: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi arsimin cilësor dhe gjithëpërfshirës nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 28: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi arsimin cilësor dhe gjithëpërfshirës nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 29: Arsimiti gjithëpërfshirës vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 30: Arsimiti gjithëpërfshirës vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 31: Vlerësimi i përmirësimit të cilësisë së jetës nëpërmjet shërbimeve shoqërore nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 32: Vlerësimi i përmirësimit të cilësisë së jetës nëpërmjet shërbimeve shoqërore nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 33: Vlerësimi nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve

- Tabela 34: Vlerësimi nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 35: Vlerësimi i shërbimeve sociale të integruara nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 36: Vlerësimi i shërbimeve sociale të integruara nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 37: Vlerësimi i deinstitutionalizimit nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 38: Vlerësimi i deinstitutionalizimit nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 39: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me kujdesin shëndetësor të aksesueshëm dhe të barabartë nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 40: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me kujdesin shëndetësor të aksesueshëm dhe të barabartë nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 41: Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 42: Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 43: Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 44: Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 45: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 46: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 47: Mundësia për të votuar, mbrojtur interesat dhe për vendimmarrje vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 48: Mundësia për të votuar, mbrojtur interesat dhe për vendimmarrje vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 49: Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 50: Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 51: Pjesëmarrja në aktivitete sportive vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 52: Pjesëmarrja në aktivitete sportive vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 53: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi nxitjen e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimin nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve
- Tabela 54: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi nxitjen e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimin nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve
- Tabela 55: Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimin vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve
- Tabela 56: Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimin vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve

#### **Tabelat në Shtojcën B të raportit:**

- Tabela 57: Aksesueshmëria fizike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 58: Aksesueshmëria fizike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 59: Aksesit në informacion vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 60: Aksesit në informacion vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 61: Aksesueshmëria në transport publik vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 62: Aksesueshmëria në transport publik vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 63: Ndihma juridike falas vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje

- Tabela 64: Ndihma juridike falas vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 65: Sigurimi i barazisë para ligjit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 66: Sigurimi i barazisë para ligjit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 67: Përmirësimi i cilësisë së AFP-së vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 68: Përmirësimi i cilësisë së AFP-së vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 69: Integrimi në tregun e punës vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 70: Integrimi në tregun e punës vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 71: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 72: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 73: Arsimi gjithëpërfshirës vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 74: Arsimi gjithëpërfshirës vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 75: Vlerësimi nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 76: Vlerësimi nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 77: Vlerësimi i shërbimeve sociale të integruara nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 78: Vlerësimi i shërbimeve sociale të integruara nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 79: Vlerësimi i deinstitutionalizimit nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 80: Vlerësimi i deinstitutionalizimit nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 81: Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 82: Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 83: Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 84: Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 85: Mundësia për të votuar, mbrojtur interesat dhe për vendimmarrje vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 86: Mundësia për të votuar, mbrojtur interesat dhe për vendimmarrje vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 87: Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 88: Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 89: Pjesëmarrja në aktivitete sportive vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 90: Pjesëmarrja në aktivitete sportive vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje
- Tabela 91: Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në numër dhe përqindje
- Tabela 92: Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave në numër dhe përqindje

# Shkurtime

---

AFP	Arsimi Formimi Profesional
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
FSHDPAK	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)/ Agjencia Gjermane e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim
ICD-10	Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Vlerësimit të Aftësisë për Punë
KNJ	Komisioni për Ndihmë Juridike
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MEDPAK	Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale NJQV
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PEI	Plan Edukativ Individual
PNP	Programet e Nxitjes së Punësimit
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara QAFP
QAFP	Qendër Arsimit e Formimi Profesional
QFP	Qendër Formimi Profesional
QS	Qëllimi strategjik
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZA	Zyra Arsimore
WVA	World Vision Albania

.....

# Përmbledhje Ekzekutive

.....

Në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri”, FShDPAK në partneritet me World Vision Albania dhe MEDPAK, ndërmorën gjatë vitit 2019 nismën e parë për monitorimin e përmbushjes së aktiviteteve të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, duke sjellë përmes këtij studimi perceptimin e vetë personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre, si dhe organizatave të shoqërisë civile. Me qëllim identifikimin e ndryshimeve të ndodhura në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave që punojnë në këtë fushë gjatë vitit 2020, tre organizatat partnere ndërmorën këtë studim të dytë monitorues.

Gjetjet e këtij monitorimi të dytë të zhvilluar gjatë periudhës Qershor – Gusht 2020 synojnë të informojnë në mënyrë sa më të drejtë institucionet e linjës përgjegjëse për zbatimin e Planit aktual, por dhe të ofrojnë këndvështrimin e grupeve të interesit mbi ndërhyrjet e nevojshme që duhet të prioritetizohen gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të ardhshëm të veprimit që po hartohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për harkun kohor 2021-2025.

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij monitorimi të dytë të zbatimit të PKVPAK është bazuar në metodologjinë e hartuar dhe testuar gjatë monitorimit të parë, duke përdorur metoda sasiore të mbledhjes së të dhënave e kombinuar me atë cilësore. Kjo qasje mundëson një përshkrim numerik të të dhënave që ndihmon në gjetjen e asaj që është tipike, mesatare dhe që përfaqëson popullatën e përfshirë në vlerësim, si dhe mbështetet me të dhëna cilësore.

Edhe gjatë vitit 2020, për qëllim të këtij studimi u përdorën dy instrumente të testuar gjatë monitorimit të mëparshëm, një për personat me aftësi të kufizuara e familjarët e tyre i përbërë nga 89 pyetje dhe një për organizatat e shoqërisë civile i përbërë nga 88 pyetje. Në të dy instrumentet pyetjet janë të mbyllura dhe vlerësohen sipas shkallës Likert, nga 1 - 4, ku (1) shpreh aspak të kënaqur, (2) pak të kënaqur, (3) disi të kënaqur dhe (4) shumë të kënaqur. Në fund të çdo dimensionit vlerësimi, për të dy instrumentet, ka dy pyetje të hapura.

Pyetësorët u plotësuan nga 70 përfaqësues të organizatave dhe 528 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre në katër bashki të vendit: Berat, Dibër, Lezhë dhe Korçë. Gjetjet e këtij studimi janë konsultuar dhe validuar në 8 tryeza diskutimi të mbajtura në secilën nga bashkitë e përfshira në studim.

## Gjetjet kryesore

Të dhënat e këtij raporti të dytë monitorimi tregojnë se në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, të gjithë qëllimet specifike ende vlerësohen në nivel aspak ose pak të kënaqshëm, me mesatare që variojnë nga 1.37 në 2.39. Gjetjet kryesore të monitorimit të realizuar gjatë vitit 2020, si dhe krahasimi i tyre me ato të një viti më parë përmbledhen më poshtë nën secilin qëllim strategjik.

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre vlerësojnë me nivel më të ulët kënaqësie përmbushjen e qëllimit strategjik lidhur me nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, monitorimin dhe vlerësimin të PKVPAK (M = 1.37) dhe atij lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë (M = 1.44). Ndërkohë, qëllimet e vlerësuar më pozitivisht nga ky grupim gjatë vitit 2020 lidhen me arsimin gjithëpërfshirës (M = 2.39) dhe shërbimet shoqërore (M = 2.06).

Krahasuar me rezultatet e monitorimit të një viti më parë, përmes të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2020, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre identifikuan ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme në katër nga tetë qëllimet strategjike të PKVPAK, si dhe në 11 nga 19 objektivat e përfshirë në këtë studim.

Në krahasim me personat me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e organizatave në monitorimin e vitit 2020 ofrojnë një vlerësim më të unifikuar lidhur me përmbushjen e qëllimeve strategjike të PKVPAK, me mesatare që variojnë nga 1.92 në 2.39, por duke u shprehur “pak” të kënaqur me ecurinë e tyre.

Pavarësisht një vlerësimi të përgjithshëm më pozitiv, krahasuar me rezultatet e ofruara nga i njëjti grupim në monitorimin e parë, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme vetëm në dy nga tetë qëllimet strategjike dhe tre nga 19 objektivat e vlerësuar. Ndryshimet pozitive të raportuara nga ky grupim lidhen me fushën e arsimit gjithëpërfshirës (M = 2.39) dhe kujdesin shëndetësor të aksesueshëm dhe të barabartë për personat me aftësi të kufizuara (M = 2.07).

## Aksesueshmëria

Në lidhje me këtë qëllim të parë strategjik, pjesëmarrësit e përfshirë në studim gjatë vitit 2020 vazhdojnë të jenë “pak të kënaqur”. Pavarësisht ndryshimeve mes dy grupimeve kryesore, analiza e të dhënave tregon një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë, e cila lidhet kryesisht me ndryshime pozitive të identifikuara në objektivat mbi aksesueshmërinë fizike dhe aksesin në informacion nga i njëjti grup.

Aksesueshmëria fizike është objektivi i vlerësuar më pozitivisht nën këtë qëllim të parë të Planit të Veprimit edhe gjatë vitit 2020, megjithëse ka ende shumë nevojë për përmirësime për sigurimin e aksesit në qendrat e votimit dhe institucionet e drejtësisë, për të cilat më shumë se tre të katërtat e pjesëmarrësve vlerësojnë se qendrat e votimit (76%) dhe institucionet e drejtësisë (78.5%) janë “aspak” ose “pak” të aksesueshme prej personave me aftësi të kufizuara.

Aksesi në informacionin e ofruar nga media dhe institucionet publike është vlerësuar si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, me rreth 40% e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre që raportojnë se informacioni dhe komunikimi në institucionet publike (40.6%), në familje (42.1%) dhe në faqet zyrtare të internetit (39.9%) nuk janë “aspak” të përshtatura në format audio apo Braille, në gjuhën e shenjave apo me gjuhë të thjeshtë, duke vështirësuar aksesin në informacion.

Megjithatë, objektivi i vlerësuar më negativisht nën këtë qëllim strategjik është ai mbi aksesueshmërinë në transportin publik, për të cilin të dy grupimet nuk raportojnë asnjë ndryshim statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e tyre gjatë vitit 2020, krahasuar me një vit më parë. Të dhënat tregojnë se dy në tre persona të përfshirë në studim nuk janë aspak të kënaqur me rimbursimin e kostove në transportin urban dhe interurban (64%) dhe atyre të lidhura me karburanti (67.7%), ndërsa 40.7% e tyre vlerësojnë se rrugët e qyteteve ku banojnë nuk janë aspak të përshtatura për lëvizjen e një personi me karrige me rrota apo një personi të verbër.

## Barazia

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre raportojnë se janë “të pakënaqur” lidhur me garantimin e aksesit në sistemin e drejtësisë, ndërsa përfaqësuesit e organizatave e vlerësojnë me “nivel të ulët kënaqësie” këtë qëllim strategjik, duke mos raportuar ndryshime në vlerësim krahasuar me një vit më parë.

Kështu, pavarësisht ndryshimeve në mesataren e vlerësimit lidhur me objektivin mbi ndihmën ligjore falas mes personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të organizatave, gjatë vitit 2020, të dy këto nëngrupe të kampionit kanë identifikuar ndryshime statistikisht të rëndësishme të ndodhura gjatë vitit të fundit në këtë drejtim, por në kahe të ndryshme. Teksa personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre raportojnë një ndryshim pozitiv nga viti 2019 në vitin 2020 në disa nga aktivitetet e lidhur me këtë objektivi, përfaqësuesit e organizatave vlerësojnë se gjatë vitit të fundit janë bërë hapa pas.

Kështu, të dhënat tregojnë se rreth tre të katërtat e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre vlerësojnë se mundësitë e ofrimit të ndihmës ligjore falas (73.8%) dhe përshtatshmëria e gjuhës dhe informacionit gjatë ofrimit të këtij shërbimi (78.1%) janë “aspak” të kënaqshme edhe gjatë vitit 2020.

Objektivi i dytë lidhur me sigurimin e barazisë përpara ligjit është vlerësuar edhe gjatë vitit 2020 si “aspak i kënaqshëm” nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre. Kështu, 69.9% e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre shprehen se nuk janë “aspak” të kënaqur me mënyrën e ushtrimit të kujdestarisë ligjore, ndërsa gati gjysma e të intervistuarve (49.9%) vlerësojnë se institucionet e sistemit të drejtësisë nuk janë “aspak” të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, të dhënat e vitit 2020, në mënyrë të ngjashme me ato të vitit të kaluar, tregojnë se shumica e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre nuk kanë “aspak” informacion mbi ndryshime ligjore në lidhje me kujdestarinë (58.2%) dhe vendimmarrjen e mbështetur (66.2%).

## **Arsimi, formimi profesional dhe punësimi**

Në lidhje me këtë qëllim strategjik, pjesëmarrësit në studim gjatë vitit 2020 vazhdojnë të jenë “pak të kënaqur”.

Të dhënat tregojnë një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë, e cila lidhet kryesisht me ndryshime pozitive të identifikuara në objektivat mbi integrimin në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit dhe përmirësimin e shërbimeve të punësimit nga i njëjti grup. Ndërkohë, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme vetëm në lidhje me objektivin e dytë.

Pavarësisht se krahasimi i të dhënave mes viteve nuk tregojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të Arsimit e Formimit Profesional është objektivi i vlerësuar më pozitivisht nën këtë qëllim edhe gjatë vitit 2020. Aktiviteti i vlerësuar më negativisht nën këtë objektivi është ai lidhur me mbështetjen me pajisje dhe mjete për vetëpunësim pas mbarimit të kurseve të formimit profesional, për të cilin 41.4% e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre u shprehën “aspak” të kënaqur.

Objektivi lidhur me integrimin në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit (PNP) është vlerësuar si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, me më shumë se tre në katër persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre vlerësojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me të gjithë aktivitetet nën këtë objektivi: mundësitë që u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për t’u punësuar në përpunime me aftësitë e tyre (84.5%); programet e nxitjes së punësimit që ofron zyrë e punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (75.4%); mundësitë e ofruara për të kryer praktika profesionale në institucione apo biznese (86.8%); dhe mbështetjen e ofruar për ndërmarrjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara (87.5%).

Në nivele të ngjashme vlerësimi është raportuar dhe përmbushja e objektivit të tretë lidhur me përmirësimin e shërbimeve të punësimit. Duke krahasuar vlerësimet e mbledhura gjatë të dy viteve të monitorimit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme gjatë vitit të fundit lidhur me tre nga gjashtë aktivitetet e përfshira nën këtë objektivi, të cilët lidhen me cilësinë e shërbimit që ofrohet nga zyrat e punësimit, informacionin e ofruar prej tyre, si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara pranë qendrave rinore.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve pozitive, 85.6% e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre e vlerësojnë si “aspak” ose “pak” të kënaqshëm nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrën e Punësimit dhe më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (57.8%) nuk njohin asnjë person me aftësi të kufizuara të punësuar në Qendra Rinore.

## Arsimi

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, në mënyrë të ngjashme me përfaqësuesit e organizatave, e vlerësojnë përmbushjen e qëllimit mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe cilësor në tërësi si “pak” të kënaqshëm.

Pavarësisht vlerës mesatare të njëjtë mes dy grupimeve, të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 tregojnë se vlerësimi i këtij qëllimi nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre ka ngelur i ngjashëm me atë të vitit të kaluar, ndërsa përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në krahasim me vlerësimin e një viti më parë. Të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 tregojnë se personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre e vlerësojnë më pak të kënaqshme situatën krahasuar me vitin e mëparshëm lidhur me cilësinë e shkollimit, punën e komisioneve të vlerësimit pranë DAR dhe institucioneve arsimore dhe mundësitë që iu ofron shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u integruar me fëmijët e tjerë.

Ndërkohë, personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre raportojnë përmirësim të situatës lidhur me informacionin e ofruar nga Bashkia për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mundësinë e transportit falas për ndjekjen e procesit mësimor. Vlerësime më pozitive vërehen lidhur me praninë e mësuesit ndihmës dhe përdorimin e Planit Edukativ Individual (PEI), aktivitete për të cilat 58.1% dhe 54.2% e të anketuarve respektivisht shprehen “disi” ose “shumë” të kënaqur.

## Kujdesi shoqëror

Lidhur me përmirësimin e cilësisë së jetës nëpërmjet shërbimeve sociale, pjesëmarrësit në studim gjatë vitit 2020 raportojnë përmbushjen e tij në nivel “pak” të kënaqshëm.

Të dhënat tregojnë një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë, e cila lidhet me ndryshime pozitive të identifikuara në të tre objektivat përbërës të këtij qëllimi. Ndërkohë, përfaqësuesit e organizatave nuk kanë raportuar asnjë ndryshim statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin mesatar të qëllimit dhe objektivave të tij nga viti në vit.

Ndryshimet e nisura në procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke kaluar nga modeli mjekësor në atë bio-psiko-social, përbëjnë dhe objektivin e vlerësuar më pozitivisht nën këtë qëllim edhe gjatë vitit 2020, me më shumë se gjysmën e pjesëmarrësve në kampionin e vitit 2020 që kanë raportuar se janë “disi” ose “shumë” të kënaqur me njohuritë e stafit (60.9%) dhe procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (55.2%).

Objektivi lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale të integruara është vlerësuar si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet. Pavarësisht ndryshimeve pozitive krahasuar me vitin e mëparshëm, edhe në rezultatet e vitit 2020 vërehen ndryshime në nivelin e raportuar të kënaqësisë mes katër aktiviteteve të këtij objektivi, ku shërbimet e marra nga shërbimet sociale dhe informacionet e ofruara prej tyre vlerësohen më të kënaqshme se masa e pagesës cash dhe ofrimi i paketave higjienike dhe sanitare për personat me aftësi të kufizuara.

Lidhur me dy aktivitetet e fundit, më shumë se 3 në 4 persona më aftësi të kufizuar dhe familjarë raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me masën e pagesës cash (83.4%) dhe paketat higjienike dhe sanitare (80%).

Ndërkohë, objektivi i vlerësuar në nivel më pak të kënaqshëm brenda këtij qëllimi strategjik nga të dy grupimet e kampionit për të dytin vit radhazi është ai i lidhur me nxitjen e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet. Kështu, gjatë vitit 2020, më shumë se 3 në 4 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me shërbimet që mbështesin jetesën e pavarur (85.5%), grantet për strehimin social (76.9%) dhe aplikimin e tarifave favorizuese për legalizimin e banesave e mjediseve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara (82.2%).

## **Kujdesi shëndetësor**

Pjesëmarrësit në studim raportojnë “nivel të ulët kënaqësie” lidhur me sigurimin e kujdesit shëndetësor të aksesueshëm, të përballueshëm dhe të barabartë, pavarësisht ndryshimeve pozitive statistikisht të rëndësishme në vlerësimin e tij raportuar nga personat me aftësi të kufizuar, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë.

Objektivi i parë lidhur me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara është vlerësuar edhe gjatë vitit 2020 si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, pavarësisht ndryshimeve pozitive të identifikuara, duke u raportuar vlerësim më pozitiv lidhur me shërbimet e përgjithshme shëndetësore në krahasim me ato të ofruar nga shërbimi stomatologjik. Kështu, rreth gjysma e pjesëmarrësve në kampionin e vitit 2020 kanë raportuar se janë “aspak” të kënaqur me ofrimin e shërbimit dentar falas në zonën e banimit (48.2%) dhe në shkolla (61.9%).

Objektivi i dytë lidhur me zhvillimin e shërbimeve të parandalimit, integritit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara është vlerësuar gjithashtu si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet. Pavarësisht se në nivel objektivi është raportuar një ndryshim pozitiv, rezultatet e vitit 2020 tregojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme në gjashtë nga nëntë aktivitetet e vlerësuar. Megjithatë, këto ndryshime janë vlerësuar pozitive krahasuar me një vit më parë vetëm për pesë aktivitete, lidhur me ofrimin e trajtimit të specializuar dhe shërbimeve riaftësuese, informacionin e dhënë nga institucionet publike për shërbime shëndetësore, informacionin që ofrohet në lidhje me sëmundje të ndryshme që mund të shkaktojnë aftësi të kufizuara dhe rimbursimin e shpenzimeve për pajisje ndihmëse.

Në të kundërt, personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre kanë raportuar përkeqësim të situatës lidhur me diagnostikimin e aftësisë së kufizuar krahasuar me një vit më parë, ku rreth tre në katër të intervistuar (73.1%) raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me këtë proces. Pavarësisht se vlerësimet lidhur me parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk kanë shënuar ndryshime lidhur me vitin e mëparshëm, këto dy aktivitete vijojnë të raportohen në nivel të pakënaqshëm dhe gjatë vitit 2020, me respektivisht 78.7% dhe 81.5% që përgjigjen se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur.

## **Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike**

Lidhur me pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike, pjesëmarrësit në studim gjatë vitit 2020 raportojnë përmbushjen e tij në nivel “pak” të kënaqshëm, duke mosidentifikuar ndryshime statistikisht të rëndësishme në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë.

Objekti i parë nën këtë qëllim strategjik lidhur me mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje është vlerësuar si “pak” i kënaqshëm edhe gjatë vitit 2020, ku aktiviteti i vlerësuar më negativisht lidhet me ofrimin e informacionit në formate të përshtatura (gjuha e shenjave, audio, Braille, titra, etj.) për pjesëmarrjen në zgjedhje.

Brenda këtij qëllimi strategjik, objekti lidhur me promovimin e punës së artistëve me aftësi të kufizuara shënon të vetmin objektiv për të cilin gjatë vitit 2020 është raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht i rëndësishëm nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre krahasuar me një vit më parë. Pavarësisht këtij ndryshimi, vetëm 22.8% e personave me aftësi të kufizuara dhe 21.1% e përfaqësuesve të organizatave të anketuar gjatë vitit 2020 shprehën “disi” ose “shumë” të kënaqur me nivelin e nxitjes dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike të katër bashkive.

Ndërkohë, objekti i tretë brenda këtij qëllimi strategjik lidhur me dhënien e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive është vlerësuar si “pak i kënaqshëm”. Rezultatet tregojnë se një në dy persona me aftësi të kufizuara (57.4%) dhe një në tre përfaqësues të organizatave (33.9%) nuk janë “aspak” të kënaqur me nivelin dhe mundësitë e ofruara për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive.

## **Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit**

Qëllimi lidhur me nxitjen e bashkëpunimit ndërinstucional, monitorimin dhe vlerësimin të PKVPAK, të dhënat tregojnë se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre janë “të pakënaqur” me përmbushjen e këtij qëllimi strategjik, me aktivitete që vlerësohen gjatë vitit 2020 me mesatare që variojnë nga 1.15 në 1.55, duke identifikuar dy ndryshime të rëndësishme statistikore.

Kështu, pavarësisht se gjatë monitorimit të dytë pjesëmarrësit shprehën më të kënaqur me nivelin e pjesëmarrjes në procese të monitorimit të Planit të Veprimit, niveli i pjesëmarrjes së tyre në konferenca në vende anëtare të BE për të parë e shkëmbyer përvoja pozitive në fushën e aftësisë së kufizuara ka shënuar rënie. Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve pozitive të raportuara lidhur me aktivitetin e parë, vetëm një në dhjetë persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre (9.5%) shprehën se janë përfshirë “disi” ose “shumë” në proceset e monitorimit të PKVPAK.

Ndërkohë, përfaqësuesit e organizatave raportojnë një vlerësim pak më të lartë lidhur me përmbushjen e këtij qëllimi strategjik, duke u shprehur se janë “pak të kënaqur” për sa i përket nxitjes së bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit mes sektorëve të ndryshëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

# Rekomandime

- 1.** Të dhënat e këtij monitorimi duhet t'i shërbejnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe institucioneve të linjës përgjegjëse për zbatimin e PKVPAK si një tregues i ecurisë së deritanishme të zbatimit dhe arritjes së objektivave dhe qëllimeve të tij, si dhe duhet të furnizojnë me ide dhe të priorizojnë fushat kryesore të ndërhyrjes gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të ardhshëm të veprimit për periudhën 2021-2025.
- 2.** Marrja e masave të shpejta nga të gjitha institucionet publike dhe private, në nivel qendror dhe vendor, për të siguruar akses pa barrierë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- 3.** Mjetet, mënyrat dhe formatet e komunikimit të përdorura në ofrimin e shërbimeve publike dhe operatorët e medias duhet të përbushin kërkesat e përshatshmërisë në komunikim.
- 4.** Njësitë e pushtetit vendor duhet të monitorojnë me përparësi përbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve private ose publike të licencuara për ofrimin e transportit urban dhe interurban me mjete tërësisht të përshtatura.
- 5.** Vënia në zbatim i Ligjit për Ndhmën Juridike të garantuar nga shteti dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij dhe sigurimi i njohjes së barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara.
- 6.** Sigurimi i aksesueshmërisë fizike dhe në informacionin që ofrohet në qendrat dhe në shkollat e arsimit dhe formimit profesional, duke i bërë ato të arritshme dhe të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.
- 7.** Monitorimi dhe zbatimi i sanksioneve për çdo punëdhënës, me fokus të veçantë në institucionet publike, që nuk zbatojnë parashikimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- 8.** Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës nga MAS, DAR dhe ZA në bashkëpunim me pushtetin vendor për sigurimin e mëuesve ndihmës për çdo fëmijë dhe sigurimin e aksesit dhe mosdiskriminimit brenda sistemit arsimor.
- 9.** Shtrirja e përdorimit të modelit të ri bio-psiko social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ndërmarrja e fushatave të informimit nga MSHMS, SHSSH dhe nga bashkitë e njësitë administrative mbi qëllimin, procesin dhe përfitimet që sjell ky model.
- 10.** Rishikimi i skemave të mbështetjes financiare për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë nivelin e pagesës që ofrohet për shkak të aftësisë së kufizuar, për të ndikuar në përbalimin e kostove shtesë të jetesës së përditshme që lidhen me aftësinë e kufizuar, por edhe për të krijuar skema për përbalimin e kostove të nevojshme të shërbimeve shoqërore, të cilat aktualisht nuk ofrohen nga shërbimet publike.
- 11.** Ngritja e më shumë qendrave ditore dhe rezidenciale të cilat do u shërbejnë fëmijëve, por dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në të gjitha bashkitë e vendit, si dhe sigurimi i aksesueshmërisë në shërbimet ekzistuese publike, duke përfshirë sigurimin e transportit falas.
- 12.** Sigurimi i mbulimit të të gjithë bashkive me mjekë specialistë të nevojshëm për trajtimin e problematikave shëndetësore të personave me aftësi të kufizuar dhe forcimi i kapaciteteve të stafëve ekzistuese.
- 13.** Forcimi i njohurive dhe kapaciteteve të personelit shëndetësor, sidomos atij në konsultore për identifikimin, diagnostikimin dhe ndërhyrjen e hershme në fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 14.** Ngritja në nivel lokal e qendrave të aftësisë dhe rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara, ofrimi në banesë i shërbimeve në rastet e nevojshme, si dhe respektimi i masave lidhur me rimbursimin e shpenzimeve për medikamente, karrige me rrota, orteza, aparate dëgjimi apo pajisje të tjera të teknologjisë ndihmëse.
- 15.** Respektimi i procedurave ligjore lidhur me konsultimin publik me të gjithë aktorët e interesit të vendimmarrjes dhe politikave të hartuara në nivel qendror dhe lokal që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë personat me aftësi të kufizuara.
- 16.** Përmirësimi dhe zbatimi i Kodit Zgjedhor që mundësojnë votim të drejtpërdrejtë, të fshehtë e të barabartë për të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara.
- 17.** Sigurimi i përfshirjes domethënëse të personave me aftësi të kufizuar në procesin e hartimit dhe priorizimit të aktiviteteve dhe buxheteve që lidhen me PKVPAK 2021-2025, si dhe krijimi i strukturave të monitorimit, para së gjithash duke emëruar/përcaktuar pikat e kontaktit në çdo institucion në nivel qendror e vendor, përgjegjës për të mbledhur të dhëna, për të informuar, koordinuar e monitoruar zbatimin e PKVPAK.
- 18.** Zbërthimi i PKVPAK në plane lokale, të shoqëruara me afate kohore dhe kosto financiare, si dhe forcimi i mekanizmave të ankimit mbi moszbatimin e parashikimeve të kuadrit rregullator dhe ndjekjes së tyre.

# Hyrje

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 29 Qershor 2016 dhe përcakton objektivat që duhet të arrihen në periudhën 2016-2020 dhe përgjegjësitë e institucioneve në nivel qendror dhe lokal në arritjen e këtyre objektivave. PKVPAK parashtron angazhimin e Qeverisë Shqiptare lidhur me nxitjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, parandalimin e diskriminimit dhe eliminimin e pengesave në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjinë e Bashkimit Evropian për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Plani i Veprimit ka identifikuar tetë fusha prioritare, të cilat janë përkthyer në planifikimin e 179 aktiviteteve, treguesve për realizimin e tyre, objektivave afatmesme dhe përfundimtarë, afateve kohore përkatëse, institucioneve zbatuese dhe raportuese, si dhe burimeve financiare të nevojshme për përmbushjen e tyre.

Një nga qëllimet kryesore të këtij plani lidhet dhe me nevojën e monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura gjatë periudhës 2016-2020. Monitorimet duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme nga të gjitha institucionet e linjës, por e rëndësishme së veçantë është identifikuar dhe nevoja e ngritjes dhe përdorimit të mekanizmave monitorues dhe nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar.

Në kuadër të projektit financiar nga Bashkimi Evropian “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri”, FShDPAK në partneritet me World Vision Albania dhe MEDPAK, ndërmoren gjatë vitit 2019 nismën e parë për monitorimin e përmbushjes së aktiviteteve të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, duke sjellë përmes këtij studimi perceptimin e vetë personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre, si dhe organizatave të shoqërisë civile.

Për përpilimin e raportit të parë monitorues, organizatat mblodhën qëndrimet dhe opinionet e 62 përfaqësuesve të organizatave lokale dhe 530 personave me aftësi të kufizuara dhe familjarë

të tyre, të përqendruar në katër bashki me një shtrirje dhe pozitë gjeografike me rëndësi përfaqësuese: Dibër, Lezhë, Korçë dhe Berat.

Në mënyrë që të vlerësohen nëse ka pasur ndryshime në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave që punojnë në këtë fushë gjatë vitit të fundit të zbatimit të PKVPAK në secilat nga fushat prioritare, gjatë vitit 2020, tre organizatat partnere ndërmoren këtë studim të dytë monitorues.

Gjetjet e këtij monitorimi të dytë të zhvilluar gjatë vitit 2020 kanë për qëllim të ofrojnë këndvështrimin e grupeve të interesit mbi përmbushjen e qëllimeve strategjike të planit aktual, si dhe prioritizimin e nevojave kryesore që duhet të merren parasysh nga institucionet përgjegjëse gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të ardhshëm të veprimit për harkun kohor 2021-2025.

## **Qëllimet strategjike të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020 janë:**

◇ Të realizohet aksesueshmëria për shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.

**Synimi:** Deri në vitin 2020 të gjitha godinat ku ofrohen shërbime publike të jenë të aksesueshme

◇ Të garantohet akses në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

**Synimi:** Deri në vitin 2020, institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të sigurojnë akses të barabartë në përfitimin e ndihmës ligjore falas, në qasjen e proceseve gjyqësore duke përfshirë edhe ofrimin e interpretimit në gjuhën e shenjave.

◇ Të rritet pjesëmarrja në tregun e punës dhe të promovohen mundësi të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara.

**Synimi:** Deri në vitin 2020, numri i PAK që punësohen nga zyrat e punësimit nëpërmjet programeve specifike të nxitjes së punësimit të rritet çdo vit me 50% si dhe të rritet numri i të rinjve me AK që punësohen në administratën shtetërore.

◇ Të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

**Synimi:** Deri në vitin 2020, të ngrihen të gjitha Komisionet Multidisiplinare të Arsimit për vlerësimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe të rritet numri i mësuesve ndihmës të rekrutuar në përputhje me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

◇ Të përmirësohet cilësia e jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/ përfitimeve të aksesueshme, të përballeshme financiarisht, të fokusuar te klienti dhe sa më pranë tij në komunitet.

**Synimi:** Deri në vitin 2020, të ketë filluar aplikimi i vlerësimit të ri të PAK sipas modelit bio-psiko-social nga komisionet e reformuara dhe të rritet numri dhe llojet e shërbimeve shoqërore në komunitet duke përfshirë edhe ato të jetesës së pavarur.

◇ Të sigurohet kujdes shëndetësor i aksesueshëm, i përballeshëm dhe i barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

**Synimi:** Deri në vitin 2020, të rritet numri dhe lloji i mjeteve ndihmëse të rimbursuara nga shteti për PAK sipas nevojave dhe të realizohet sigurimi i funksionimit të një Qendre Kombëtare të Rehabilitimit.

◇ Të mundësohet për personat me aftësi të kufizuara që të përfaqësojnë interesat e tyre dhe të marrin pjesë në jetën publike dhe politike në Shqipëri.

**Synimi:** Deri në vitin 2020, të rritet numri i PAK që marrin pjesë në procesin e votimit dhe që përfaqësohen në këshillat bashkiakë nëpërmjet një pjesëmarrjeje më të madhe në jetën politike.

◇ Të krijohen sinergji midis sektorëve të ndryshëm për nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

.....

# Metodologjia

.....

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij monitorimi të dytë të zbatimit të PKVPAK është bazuar në metodologjinë e hartuar dhe testuar gjatë monitorimit të parë, duke përdorur metoda sasiore të mbledhjes së të dhënave e kombinuar me atë cilësore. Kjo qasje mundëson një përshkrim numerik të të dhënave që ndihmon në gjetjen e asaj që është tipike, mesatare dhe që përfaqëson popullatën e përfshirë në vlerësim, si dhe mbështetet me të dhëna cilësore.

## 2.1. Instrumenti

Për të mbledhur të dhënat e monitorimit, edhe gjatë vitit 2020 u përdorën dy instrumente të testuar gjatë monitorimit të vitit 2019, një për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe një për organizatat e shoqërisë civile, me dallime shumë të vogla nga njëri tjetri. Secili nga instrumentet përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë, e cila përmban të dhënat demografike dhe pjesa e dytë e organizuar në tetë dimensione. Çdo dimension përfaqëson një qëllim strategjik të planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016-2020. Pyetësi për personat me aftësi të kufizuara në total përmban 89 pyetje, ndërsa pyetësi për organizatat përbehet nga 88 pyetje, të cilat janë mbështetur në objektivat dhe aktivitetet përkatëse të planit të veprimit.

Në të dy instrumentet pyetjet janë të mbyllura dhe vlerësohen sipas shkallës Likert, nga 1 - 4, ku (1) shpreh aspak të kënaqur, (2) pak të kënaqur, (3) disi të kënaqur dhe (4) shumë të kënaqur. Në fund të çdo dimensionit vlerësimi, për të dy instrumentet, ka dy pyetje të hapura; pyetja e parë synon të mbledhë informacion mbi përvojën jetësore të të intervistuarit/ës në lidhje me vlerësimin për qëllimin strategjik dhe pyetja e dytë ka për qëllim të identifikojë nevojat prioritare për t'u trajtuar në lidhje me qëllimin strategjik.

Gjetjet e këtij studimi janë konsultuar dhe validuar në 8 tryeza diskutimi të mbajtura në secilën nga bashkitë e përfshira në studim. Gjatë takimeve të konsultimit morën pjesë në total 66

pjesëmarrës, ndër të cilët 32 janë PAK dhe familjarët e tyre dhe 34 përfaqësues organizatash. Të dy instrumentet mund t'i gjeni në Shtojcën 2 të këtij raporti.

## **Qëndrueshmëria e brendshme e instrumentit**

Për të vlerësuar shkallën me të cilën secila pyetje brenda një qëllimi strategjik dhe objektivave përkatëse përputhet me pyetjet e tjera të tij dhe për të vlerësuar se sa mirë këto pyetje kontribuojnë së bashku për të matur fenomenin që po studiohet, u llogaritën koeficientet e besueshmërisë, bazuar në të dhënat (n=528) për instrumentin për personat me aftësi të kufizuara dhe (n=70) për instrumentin për organizatat. Koeficienti i Cronbach's alpha, i cili tregon qëndrueshmërinë e brendshme të pranueshme, rezulton të jetë më i lartë se 0.60, vlera minimale e pranueshme për studime në shkencat sociale.

## **2.2. Kampionimi**

Pjesëmarrësit në studim janë: përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, para së gjithash organizatat që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në katër nga bashkitë e vendit: Berat, Dibër, Lezhë dhe Korçë. Në vlerësim morën pjesë 70 përfaqësues të organizatave dhe 528 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre.

### **Kampioni dhe karakteristikat e tij**

Numri i kampionit të synuar në total ishte i përcaktuar paraprakisht, në mënyrë që të garantonte një numër pjesëmarrësish të ngjashëm me atë të monitorimit të parë me këtë qëllim: gjithsej 600 persona me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues të organizatave, të shpërndarë në mënyrë sa më të barabartë në katër të katër rajonet. Më tej, u përcaktua numri i kampionit të synuar për organizatat dhe personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht 70 përfaqësues organizatash dhe 530 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre. Numri i kampionit të përfaqësuesve të organizatave u përcaktua duke marrë në konsideratë popullatën e vogël të organizatave, nivelin e ulët të angazhimit dhe përputhshmërisë së tyre me qëllimin e vlerësimit, si dhe veçorinë e qëllimit të vlerësimit. Përzgjedhja e karakteristikave të kampionit është mbështetur në përshtatshmërinë, bashkëpunimin dhe interesin e vlerësimit.

Kriteret për përzgjedhjen e organizatave janë:

- ◊ Të jetë e regjistruar në gjykatë (të paktën prej një viti nga momenti që paraqitet në vlerësim);
- ◊ Në momentin e vlerësimit të ketë të paktën një person i/e cila është i/e angazhuar dhe përditësuar në lidhje me fushën ku është aktive organizata;
- ◊ Të ketë pasur të paktën një projekt aktiv, që nga viti 2016 (periudhë që përputhet me fillimin e planit të veprimit);
- ◊ Nëse nuk ka pasur projekte, të demonstrojë që ka kryer aktivitete vullnetare (që nga viti 2016) që përputhen me misionin e organizatës;

- ◊ Aktivitetet e organizatës të jenë kryer në qytetin/zonën në fokus të vlerësimit;
- ◊ Subjekti mund të jetë degë e një organizate, e cila zyrën qendrore mund ta ketë në një qytet tjetër nga ai i vlerësimit.

Kriteret për personat me aftësi të kufizuara:

- ◊ Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- ◊ Të kenë aftësi të kufizuara fizike, problem shqisor (dëmtim ose humbje të shikimit/nuk shikon apo me shikim të pjesshëm, dëmtim ose humbje të dëgjimit/ nuk dëgjon, nuk flet e nuk dëgjon), aftësi të kufizuara intelektuale, apo të shëndetit mendor.

Kriteret për familjarët e personave me aftësi të kufizuara:

- ◊ Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- ◊ Të ketë statusin e kujdestarit dhe konsumojë kohë me personin me aftësi të kufizuara;
- ◊ Nëse nuk ka statusin e kujdestarit të jetë familjar i tij ose;
- ◊ Të jetë person që të jetë kujdesur për personin me aftësi të kufizuara, të paktën 6 muajt e fundit;
- ◊ Të jetë prind/kujdestar/familjar i një fëmije me aftësi të kufizuara nga 2-17 vjeç.

## Numri dhe lloji i kampionit

Për përzgjedhjen e organizatave u përdor kampioni i qëllimshëm<sup>1</sup>, duke u bazuar në të dhënat e studimit për hartëzimin e OSHC-ve<sup>2</sup> dhe monitorimit të vitit 2019, në katër zonat në fokus të vlerësimit dhe në karakteristikat e përcaktuara më sipër. Nga secila organizatë u synua që të intervistohen dy anëtarë, drejtuesi i organizatës dhe një profesionist i përfshirë në shërbime të drejtpërdrejta apo të tërthorta me grupet në fokus të misionit të organizatës. Në rastet kur organizata nuk kishte dy punonjës, në vlerësim u përfshi një organizatë tjetër. Gjatë vitit 2020, në monitorim morën pjesë 70 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar në katër bashkitë e përfshira në studim.

Kampioni për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre u bazua në shpërndarjen gjeografike, duke synuar numër të ngjashëm pjesëmarrësish nga secila bashki e përfshirë në monitorim. **Përzgjedhja** u krye në mënyrë rastësore<sup>3</sup> nga listat e personave me aftësi të kufizuara në bashki, njësi administrative, qendrat komunitare të shëndetit mendor, qendra shëndetësore,

1. Kampioni i qëllimshëm përzgjidhet bazuar në karakteristikat e popullatës dhe objektivit të studimit. Njihet ndryshe si kampionimi përzgjedhës dhe subjektiv dhe është i dobishëm në situata kur duhet të arrijmë shpejt një kampion të synuar.

2. Hartëzimi dhe vlerësimi i nevojave të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara në rrethin e Beratit, Dibrës, Lezhës dhe Korçës. Qershor 2018.

3. Kampioni i rastësishëm përdoret për popullata të mëdha ku secilit i jepet mundësia e barabartë për të marrë pjesë në studim.

organizatat që ofrojnë shërbime, deri në përmbushjen e numrit të kampionit të synuar për çdo bashki. Nga 530 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre të synuar, në vlerësim u përfshinë 528 të tillë.

Tabelat në vijim paraqesin një pamje më të detajuar të kampionit të përfshirë në studimin e realizuar gjatë vitit 2020.

**Tabela 1: Kampioni sipas subjekteve nga organizatat dhe personat me aftësi të kufizuara e familjarët e tyre**

	Berat	Dibër	Korçë	Lezhë	Total
<b>Nr. personave nga organizatat</b>	10	16	20	24	70
<b>Nr. i personave me aftësi të kufizuara</b>	70	68	61	63	262
<b>Nr. i familjarëve</b>	70	66	67	63	266
	150	150	148	150	598

**Tabela 2: Kampioni sipas bashkive dhe vendbanimit për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë**

	Qytet			Fshat			Gjithsej		
	Tot.	PAK	Familjarë	Tot.	PAK	Familjarë	Tot.	PAK	Familjarë
<b>Berat</b>	70	35	35	70	35	35	140	70	70
<b>Dibër</b>	67	34	33	67	34	33	134	68	66
<b>Korçë</b>	63	33	30	65	28	37	128	61	67
<b>Lezhë</b>	46	24	22	80	39	41	126	63	63
<b>Gjithsej</b>	246	126	120	282	136	146	528	262	266

**Tabela 3: Kampioni persona me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë**

	Aftësi e kufizuar intelektuale			Aftësi e kufizuar fizike			Aftësi e kufizuar shqisore			Probleme të shëndetit mendor			Gjithsej		
	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F
<b>Berat</b>	13	8	5	23	13	10	19	10	9	15	10	5	70	41	29
<b>Dibër</b>	18	9	9	18	13	5	16	9	7	16	8	8	68	39	29
<b>Korçë</b>	8	4	4	22	8	14	16	10	6	15	8	7	61	30	31
<b>Lezhë</b>	17	11	6	19	11	8	15	7	8	12	6	6	63	35	28
<b>Gjithsej</b>	56	32	24	82	45	37	66	36	30	58	32	26	262	145	117

**Tabela 4: Kampioni familjarë sipas gjinisë së tyre dhe llojit të aftësisë së kufizuar të të afërmit**

	Aftësi e kufizuar intelektuale			Aftësi e kufizuar fizike			Aftësi e kufizuar shqisore			Probleme të shëndetit mendor			Gjithsej		
	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F
<b>Berat</b>	13	2	11	23	11	12	18	2	16	16	3	13	70	18	52
<b>Dibër</b>	18	4	14	16	3	13	16	6	10	16	13	3	66	26	40
<b>Korçë</b>	15	2	13	20	10	10	16	8	8	16	2	14	67	22	45
<b>Lezhë</b>	19	13	6	22	14	8	6	5	1	16	10	6	63	42	21
<b>Gjithsej</b>	65	21	44	81	38	43	56	21	35	64	28	36	266	108	158

## 2.3. Mbledhja e të dhënave

Për administrimin e pyetësorit u angazhuan 7 intervistues, të cilët u trajnuan nga ekspertët në lidhje me qëllimin e vlerësimit, përmbajtjen e instrumentit dhe administrimin e tij, çështjet etike, rëndësinë e formës së pëlqimit, mënyrën e identifikimit dhe përzgjedhjes së kampionit për personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat.

Mbledhja e të dhënave për organizatat u realizua gjatë muajve qershor dhe korrik 2020. Në secilin rajon të përfshirë në vlerësim u organizua një takim me pjesëmarrës nga anëtarë të organizatave parashikuar në karakteristikat e kampionit. Gjatë takimit fillimisht pjesëmarrësit plotësuan instrumentin dhe më pas u prezantuan me planin e veprimit dhe qëllimin e vlerësimit, duke theksuar rëndësinë e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në proceset monitoruese të PKVPAK në të ardhmen. Ekspertët dhe intervistuesi për bashkinë përkatëse lehtësuan procesin në rastet e nevojshme. Koha e plotësimit të instrumentit ka varjuar 45-55 minuta, në varësi të të kuptuarit dhe përqendrimit të të intervistuarit.

Mbledhja e të dhënave nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre u realizua në periudhën qershor dhe korrik 2020. Instrumentet u administruan nga intervistuesit dhe kohëzgjatja e intervistës ka variuar 45–60 minuta. Intervistuesit morën të dhënat nga institucionet dhe organizatat dhe më tej kontaktuan subjektet, deri në plotësimin e plotë të specifikave të kampionit.

Personi me aftësi të kufizuar ose familjari i tij/saj apo fëmijës, paraprakisht është informuar për intervistën, qëllimin dhe kohëzgjatjen, duke siguruar ruajtjen e privatësisë dhe ndërprerjen e saj në rast kërkesë. Miratimi me shkrim nga secili i intervistuar është siguruar para fillimit të intervistës. Intervistuesit gjatë gjithë procesit kanë raportuar periodikisht dhe janë mbikëqyrur nga organizatat partnere në këtë projekt.

## 2.4. Analiza e të dhënave

Hedhja e të dhënave u realizua paralelisht me procesin e mbledhjes së të dhënave. Baza e të dhënave u hartua në Excel dhe më pas u importua në SPSS. Më tej u zhvillua pastrimi dhe përgatitja e bazës së të dhënave për përpunim të mëtejshëm.

Analiza e të dhënave gjeneroi të dhëna përshkruese si mesatarja, devijimi standard, minimum dhe maksimum për çdo variabël, objektiv dhe qëllim strategjik, duke u përqendruar dhe në statistika përshkruese si frekuenca dhe krostabulime, duke vijuar me analiza dinferenciale si chi-square, të cilat mundësuan krahasimet mes dy grupeve që morën pjesë në monitorimin e vitit 2019 dhe atë të vitit 2020.

Të dhënat cilësore të mbledhura gjatë 8 tryezave të diskutimit u zbardhën dhe u përputhën me fushat e PKVPAK-së.

## 2.5. Kufizimet e studimit

Metodologjia e ndjekur në këtë monitorim paraqet kufizime që janë relativisht të njohura në këtë fushë dhe të ngjashme me ato të ndeshura gjatë monitorimit të parë.

Një pjesë e konsiderueshme e intervistave janë zhvilluar me familjarë të personave me aftësi të kufizuara, duke u bazuar në perceptimin e këtyre të fundit mbi vështirësitë që ndeshin gjatë veprimtarive të përditshme. Në këto raste gjykohet se familjarët jo gjithmonë mundën të diferencojnë vështirësitë e tyre nga ato të personave me aftësi të kufizuara dhe të jenë objektive në vlerësim.

Një kufizim tjetër i studimit është përfshirja vetëm e katër zonave (Lezhe, Dibër, Korçë, Berat) dhe pamundësia për të arritur në zona të thella rurale.

Megjithëse u dhanë shpjegime në hyrje të çdo pyetësori dhe u orientua e u trajnuar grupi që do kryente intervistat, pyetësori rezultoi të jetë i vështirë për t'u kuptuar në disa nga fushat për shkak të terminologjisë specifike. Kjo vihet re edhe në përqindjen e personave me aftësi të kufizuara dhe familjareve të tyre që janë përgjigjur 'nuk kam informacion' për treguesit e qëllimeve strategjike.

Ndryshe nga një vit më parë, në perceptimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 mund të ketë ndikuar dhe pezullimi i shumë shërbimeve publike, kryesisht gjatë periudhës Mars – Maj 2020, për shkak të kufizimeve në qarkullim si rrjedhojë e përballjes me pandeminë e COVID-19. Pavarësisht përballjes me situatën e emergjencës, perceptimi i pjesëmarrësve në monitorim mbi cilësinë e shërbimeve publike mbetet një element i rëndësishëm për t'u analizuar lidhur me efikasitetin e këtyre të fundit për t'iu përgjigjur nevojave në zhvillim të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre.

# Gjetjet e studimit

Ky kapitull i raportit fokusohet në prezantimin e gjetjeve të përfuara nga analiza e të dhënave të mbledhura nga anketimi dhe intervistat e realizuara me personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Seksionet në vijim janë organizuar në tetë nënseksione që i korrespondojnë tetë qëllimeve strategjike të planit të veprimit. Çdo nënseksion vijon me vlerësimin e përgjithshëm të qëllimit strategjik, objektivave dhe aktiviteteve përkatëse **të shprehur në mesataren** e raportuar nga secili nga dy grupimet kryesore gjatë vitit 2019 dhe 2020.

Të dhënat sasiore janë të shprehura në mesatare në nivel qëllimi strategjik, objektivi dhe aktiviteti, si edhe në përqindje për aktivitetet nën objektivat respektivë. Mesatarja vlerësohet me një shkallë nga 1 në 4, ku 1 shpreh 'aspak i kënaqur', 2 'pak i kënaqur', 3 'disi i kënaqur' dhe 4 'shumë i kënaqur'.

Në secilën nga tabelat e këtij kapitulli, ndryshimet statistikisht të rëndësishme në mesataret e vlerësimit të ofruar gjatë monitorimit të vitit 2020 krahasuar me atë të një viti më parë janë theksuar me ngjyrë portokalli.

Përqindjet e mbledhura nga secila nga shkallët e vlerësimit për aktivitetet nën objektivat respektivë detajohen më tej në Shtojcën B të këtij raporti.

Gjetjet janë të prezantuara për të katër bashkitë së bashku, të ndara sipas dy grupimeve kryesore të kampionit dhe të krahasuara mes dy viteve. Në fund të çdo nënseksioni është përmbledhur dhe analiza cilësore e përfuara nga përgjigjet e marra gjatë pyetjeve të hapura të instrumentit të anketimit dhe diskutimeve në grup në të katër bashkitë e përfshira në këtë monitorim.

## 3.1. Aksesueshmëria

Aksesi i barabartë në shërbime dhe informacion përbën qëllimin e parë strategjik<sup>4</sup> të PKVPAK, i cili përbëhet nga tre objektiva përkatësisht: aksesueshmëria fizike në institucionet publike<sup>5</sup>; aksesimi në informacion<sup>6</sup> dhe aksesimi në transport publik<sup>7</sup>. Të tre objektivat janë parashikuar të përmbushen përmes realizimit të 18 aktiviteteve.

Në lidhje me këtë qëllimin strategjik, pjesëmarrësit e përfshirë në studim gjatë vitit 2020 vazhdojnë të jenë “pak të kënaqur”, duke e vlerësuar me një mesatare **1.99** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre (Tabela 5) dhe **2.14** nga përfaqësuesit e organizatave (Tabela 6).

**Tabela 5: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me aksesueshmërinë nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Aksesueshmëria</b>	<b>500</b>	<b>1.80</b>	<b>541</b>	<b>1.99</b>
Aksesueshmëria fizike	498	1.95	541	2.20
Aksesi në informacion	471	1.65	534	1.86
Aksesueshmëria në transportin publik	463	1.57	523	1.61

**Tabela 6: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me aksesueshmërinë nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Aksesueshmëria</b>	<b>62</b>	<b>1.96</b>	<b>64</b>	<b>2.14</b>
Aksesueshmëria fizike	62	2.17	64	2.35
Aksesi në informacion	61	1.83	64	2.01
Aksesueshmëria në transportin publik	62	1.68	62	1.84

Pavarësisht ndryshimeve mes dy grupimeve kryesore, analiza e të dhënave tregon një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë, e cila lidhet kryesisht me ndryshime pozitive të identifikuara në objektivat mbi aksesueshmërinë fizike dhe aksesin në informacion nga i njëjti grup.

4. Qëllimi strategjik nr. 1: “Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara”

5. Objektiv nr. 1.1: “Përmirësimi i aksesueshmërisë fizike në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara”

6. Objektiv nr. 1.2: “Përmirësimi i aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara”

7. Objektiv nr. 1.3: “Aksesueshmëria e transportit publik për të gjithë”

Aksesueshmëria fizike është objektivi i vlerësuar më pozitivisht nën këtë qëllim të parë të Planit të Veprimit edhe gjatë vitit 2020, duke u raportuar me një mesatare **2.20** nga personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre dhe **2.35** nga përfaqësuesit e organizatave.

Akresi në informacionin e ofruar nga media dhe institucionet publike është vlerësuar si pak i kënaqshëm nga të dy grupimet, duke mbledhur një mesatare **1.86** nga personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre dhe **2.01** nga përfaqësuesit e organizatave.

Megjithatë, objektivi i vlerësuar më negativisht nën këtë qëllim strategjik është ai mbi aksesueshmërinë në transportin publik, i cili është vlerësuar me një mesatare **1.61** nga personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre dhe **1.84** nga përfaqësuesit e organizatave. Gjithashtu, të dy këto grupime nuk raportojnë asnjë ndryshim statistikor të rëndësishëm në vlerësimin e këtij objektivi gjatë vitit 2020, krahasuar me një vit më parë.

Më poshtë përmbledhen vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuar, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave lidhur me secilin nga aktivitetet e përfshirë në studim për të tre objektivat kryesore të lidhur me aksesueshmërinë.

### **3.1.1. Vlerësimi i aktiviteteve të aksesueshmërisë fizike në shërbimet publike**

Aktivitetet e objektivit lidhur me aksesueshmërinë fizike në institucionet publike vlerësohen nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në nivelin “pak” të kënaqshëm, me mesatare që variojnë nga **1.91 – 2.46** (Tabela 7).

Duke krahasuar vlerësimet e mbledhura gjatë të dy viteve të monitorimit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar ndryshime pozitive statistikor të rëndësishme gjatë vitit të fundit lidhur me gjashtë nga tetë aktivitetet e përfshira nën këtë objektiv, të cilët lidhen kryesisht me aksesueshmërinë në institucionet e pushtetit vendor, ato të shërbimeve shëndetësore, kulturore dhe sociale.

Dy aktivitetet nën këtë objektiv për të cilat nuk raportohen përmirësime në nivelin e aksesueshmërisë fizike lidhen me qendrat e votimit dhe institucionet e drejtësisë, të cilat gjatë vitit 2020 janë vlerësuar të dyja me mesatare **1.91**.

E shprehur në përqindje, të dhënat tregojnë se më shumë se tre të katërtat e pjesëmarrësve në studim gjatë vitit 2020 vlerësojnë se qendrat e votimit (**76%**) dhe institucionet e drejtësisë (**78.5%**) janë aspak ose pak të aksesueshme prej personave me aftësi të kufizuara (Shtojca B).

Ashtu si dhe gjatë vitit të mëparshëm, edhe gjatë vitit 2020, përfaqësuesit e organizatave kanë dhënë vlerësime më pozitive lidhur me aktivitetet e parashikuara nën objektivin e “aksesueshmërisë fizike” krahasuar me personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre, duke raportuar mesatare që variojnë nga “pak” drejt “disi” të kënaqur me vlera nga **2.14 – 2.65** (Tabela 8).

Rezultatet e mbledhura gjatë vitit 2020 tregojnë se shumica e vlerësimeve lidhur me përmbushjen e aktiviteteve nën këtë objektivin raportohen nën të njëjtin trend me atë të vitit të kaluar, por përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar vetëm një ndryshim statistikor të rëndësishëm lidhur me rritjen e nivelit të aksesueshmërisë në institucionet e shërbimeve shoqërore, mesatarja e të cilës ka ndryshuar nga **2.31** në vitin 2019, në **2.65** për vitin 2020.

**Tabela 7: Aksesueshmëria fizike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Aksesueshmëria fizike	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Në Bashkinë tuaj/ në zyrat e njësisë administrative ku ju banoni	475	2.23	536	2.38
Në institucionet edukuese/arsimore (DAR, Zyrat arsimore, institucionet parashkollore, ato të arsimit bazë/fillor dhe të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, universitet)	452	2.17	531	2.36
Në institucionet kulturore e sportive (qendër kulturore, qendër rinore, kinema, muzeum, fushë sporti, ambiente sportive në shkolla e në sallat sportive, etj) në qytetin / fshatin ku ju banoni	412	1.66	522	2.00
Në institucionet shëndetësore (qendër shëndetësore, qendër spitalore, qendër rehabilitimi fizik) në qytetin / fshatin ku ju banoni	480	2.06	538	2.38
Në institucionet e shërbimeve shoqërore (qendër ditore/ qendër zhvillimi, zyrat e Drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror, zyrat e sigurimeve shoqërore) në qytetin / fshatin ku ju banoni	438	1.82	528	2.46
Në zyrat e punësimit, qendrat e formimit profesional, shkollat e mesme profesionale, në qytetin/fshatin ku ju banoni	431	1.79	517	2.15
Në qendrat e votimit në qytetin / fshatin ku ju banoni	419	1.81	503	1.91
Në institucionet e drejtësisë (gjykata, prokurori, polici) në bashkinë tuaj	383	1.97	428	1.91

Pavarësisht këtij ndryshimi pozitiv, edhe në këtë aktivitet të vlerësuar me mesataren më të lartë, sërish **40%** e përfaqësuesve të organizatave mendojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë aspak ose pak akses në shërbimet shoqërore të katër bashkive të përfshira në monitorim (Shtojca B).

**Tabela 8: Aksesueshmëria fizike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Aksesueshmëria fizike	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Në Bashkinë tuaj/ në zyrat e njësisë administrative ku ju banoni	62	2.27	61	2.33
Në institucionet edukuese/arsimore (DAR, Zyrat arsimore, institucionet parashkollore, ato të arsimit bazë/fillor dhe të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, universitet)	60	2.23	60	2.53
Në institucionet kulturore e sportive (qendër kulturore, qendër rinore, kinema, muzeum, fushë sporti, ambiente sportive në shkolla e në sallat sportive, etj) në qytetin / fshatin ku ju banoni	56	1.83	57	2.18
Në institucionet shëndetësore (qendër shëndetësore, qendër spitalore, qendër rehabilitimi fizik) në qytetin / fshatin ku ju banoni	57	2.33	59	2.59
Në institucionet e shërbimeve shoqërore (qendër ditore/ qendër zhvillimi, zyrat e Drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror, zyrat e sigurimeve shoqërore) në qytetin / fshatin ku ju banoni	58	2.31	60	2.65
Në zyrat e punësimit, qendrat e formimit profesional, shkollat e mesme profesionale, në qytetin/fshatin ku ju banoni	53	1.94	59	2.14
Në qendrat e votimit në qytetin / fshatin ku ju banoni	52	2.03	53	2.19
Në institucionet e drejtësisë (gjykata, prokurori, polici) në bashkinë tuaj	52	2.19	45	2.20

### 3.1.2. Vlerësimi i aktiviteteve lidhur me aksesin në informacion

Të pyetur lidhur me aktivitetet e objektivit të dytë mbi aksesin në informacion, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre vlerësojnë edhe gjatë vitit 2020 se janë “pak” të kënaqur me përshtatshmërinë e informacionit të ofruar nga institucionet publike, mediat dhe brenda familjeve të tyre, duke raportuar mesatare që variojnë nga **1.74 në 2.05** (Tabela 9).

Të shprehura në përqindje, rreth 40% e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre vlerësojnë se informacioni dhe komunikimi në institucionet publike (**40.6%**), në familje (**42.1%**) dhe në faqet zyrtare të internetit (**39.9%**) nuk janë “aspak” të përshtatura në format audio apo Braille, në gjuhën e shenjave apo me gjuhë të thjeshtë, duke vështirësuar aksesin në informacion (Shtojca B).

Pavarësisht vështirësive të raportuara, ky grupim vlerëson ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme në katër nga gjashtë aktivitetet e këtij objekti gjatë vitit të fundit.

**Tabela 9: Aksesin në informacion vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Aksesin në informacion	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Informacioni i ofruar nga shërbimet publike mbi legjislacionin/ politikën/ programet/ projektet/ çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar.	437	1.72	502	2.05
Ofrimi i komunikimit të përshtatur (në format audio apo Braille; në gjuhën e shenjave; në formate të thjeshta, me gjuhë të thjeshtë, me figura; me gjuhën e shenjave etj.) në Bashki, në KMCAP, në qendra ditore, në qendra shëndetësore.	396	1.43	488	1.74
Mundësi për komunikim të përshtatur (me gjuhën e shenjave, etj.) në shtëpi dhe me anëtarët e familjes për personat me problem në dëgjim.	337	1.88	477	1.85
Përdorimi i faqeve të internetit të institucioneve publike.	412	1.70	469	1.87
Faqe interneti të përshtatura.	164	1.76	336	1.78
Informacioni i përshtatur në media kombëtare (përkthim në gjuhën e shenjave, informacion të thjeshtuar, titra).	398	1.64	472	1.88

Të pyetur rreth të njëjtave aktivitete, dhe përfaqësuesit e organizatave ndajnë të njëjtin vlerësim mbi mundësitë e pakta të aksesit në informacion nga ana e personave me aftësi të kufizuara, duke raportuar mesatare që variojnë nga **1.54 në 2.40** (Tabela 10).

Problematikat më të theksuara në këtë drejtim raportohen lidhur me përshtatshmërinë e informacionit të ofruar nga institucionet publike, ku mbi 60% e përfaqësuesve të organizatave vlerësojnë se në Bashki, në KMCAP, në qendra ditore, në qendra shëndetësore dhe në kopsht / shkollë / muze nuk ofrohet asnjë informacion në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë (**63%**) ose në gjuhë të thjeshtuar (**59.3%**) (Shtojca B).

Në krahasim me një vit më parë, gjatë vitit 2020 përfaqësuesit e organizatave raportojnë vetëm një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm, lidhur me ofrimin e më shumë informacioni të përshtatur në mediat kombëtare (M = 2.36).

**Tabela 10: Aksesi në informacion vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Aksesi në informacion	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Informacioni i ofruar nga shërbimet publike mbi legjislacionin/ politikat/ programet/ projektet/ çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar.	57	2.03	58	2.33
Mundësi për komunikim të përshtatur (në format audio apo Braille) në Bashki, në KMCAp, në qendra ditore, në qendra shëndetësore, në kopsht/shkollë/muze ose ndërmarrje për një person me problem në shikim.	53	1.49	56	1.80
Mundësi për komunikim të përshtatur (në gjuhën e shenjave etj.) në Bashki, në KMCAp, në qendra ditore, në qendra shëndetësore, në kopsht/ shkollë/ në muze ose ndërmarrje për një person me probleme në dëgjim e në të folur.	54	1.68	54	1.54
Mundësi për komunikim të përshtatur, (në formate të thjeshta, me gjuhë të thjeshtë, me figura) në Bashki, në KMCAp, qendra ditore, në qendra shëndetësore, në kopsht/shkollë/ në muze ose ndërmarrje për një person me aftësi të kufizuara intelektuale.	54	1.81	59	1.70
Mundësi për komunikim të përshtatur (me gjuhën e shenjave, etj.) në shtëpi dhe me anëtarët e familjes për personat me probleme në dëgjim.	42	1.88	51	1.96
Përdorimi i faqeve të internetit të institucioneve publike dhe niveli i përshtatshmërisë së tyre.	53	2.15	53	2.40
Informacioni i përshtatur në media kombëtare (përkthim në gjuhën e shenjave, informacion të thjeshtuar, titra).	55	1.61	59	2.36

### 3.1.3. Vlerësimi i aktiviteteve të aksesit në transport publik

Vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre lidhur me aksesin në ambientet dhe transportin publik në katër bashkitë e përfshira në studim edhe gjatë vitit 2020 janë më të ulëta, duke variuar nga “aspak” në “pak” të kënaqur me mesatare nga **1.46** në **1.80** (Tabela 11).

**Tabela 11: Aksesueshmëria në transport publik vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Aksesueshmëria në transport publik	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Lëvizja e një personi me karrige me rrota apo një personi të verbër në rrugët e qytetit.	449	1.72	496	1.80
Rimbursimi i kostove të transportit kur udhëton me mjete të transportit urban e interurban.	410	1.54	517	1.50
Rimbursimi i karburantit.	386	1.39	474	1.46

Të dhënat tregojnë se dy në tre persona të përfshirë në studim nuk janë aspak të kënaqur me rimbursimin e kostove në transportin urban dhe interurban (**64%**) dhe atyre të lidhura me karburanti (**67.7%**), ndërsa **40.7%** e tyre vlerësojnë se rrugët e qyteteve ku banojnë nuk janë aspak të përshtatura për lëvizjen e një personi me karrige me rrota apo një personi të verbër (Shtojca B).

Gjithashtu, në ndryshim me dy objektivat e tjerë nën këtë qëllim, në vlerësimet e dhëna lidhur me aktivitetet e aksesit në transport publik, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre nuk raportojnë asnjë ndryshim statistikor të rëndësishëm gjatë vitit të fundit.

Pavarësisht se përfaqësuesit e organizatave e vlerësojnë situatën lidhur me aksesin në ambientet dhe transportin publik me nota më pozitive se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, duke i vlerësuar aktivitetet nën këtë objektiv me mesatare që variojnë nga **1.64 në 2.62**, edhe ky grupim nuk ka raportuar ndryshime statistikisht të rëndësishme të arritura gjatë vitit të fundit (Tabela 12).

Të shprehura në përqindje, më shumë se 40% e përfaqësuesve të organizatave vlerësojnë situatën aktuale të rimbursimit të kostove të transportit urban (**41.9%**), atij interurban (**45.5%**) dhe karburantit (**47.7%**) si aspak të kënaqshme për personat me aftësi të kufizuara (Shtojca B).

**Tabela 12: Aksesueshmëria në transport publik vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Aksesueshmëria në transport publik	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Lëvizja e një personi me karrige me rrota apo një personi të verbër në rrugët e qytetit.	60	1.78	61	2.62
Rimbursimi i kostove të transportit për personat me aftësi të kufizuara, kur udhëtojnë me mjete të transportit urban.	49	1.97	43	1.95
Rimbursimi i kostove të transportit kur udhëtojnë me mjete të transportit interurban.	28	1.39	22	1.82
Rimbursimi i karburantit.	48	1.47	44	1.64

Të dhënat e mësipërme statistikore konfirmohen dhe nga shembujt dhe nevojat e identifikuara nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave përmes pyetjeve të hapura në pyetësor dhe fokus grupeve të organizuara në të katër bashkitë e monitoruara dhe gjatë vitit 2020.

Problematikat kryesore të raportuara nga pjesëmarrësit në monitorim lidhur me aksesueshmërinë fizike lidhen me mungesën e aksesit në institucionet publike, sidomos ato të pushtetit vendor, shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore, si dhe mungesën e rampave dhe sinjalistikës së përshtatur në këto institucione.

*“Të gjitha zyrat në të cilat duhet të shkoj pothuaj çdo muaj janë në katet e sipërme, përfshirë këtu administratorin social, zyrën e punës, sigurimet shoqërore e kështu me radhë. Unë as vetëm dhe as i shoqëruar nga një familjar i vetëm nuk mund të ngjitem. Vetëm administratori social më ka bërë nder dy, tre herë dhe ka zbritur në kat të parë për të më takuar.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Në përgjithësi rampat mungojnë. Vetëm në disa nga institucionet që janë ndërtuar ose rikonstruktuar së fundmi janë vendosur, por dhe ato shpeshherë jo funksionale. Për shembull, Bashkia e ka vendosur një të tillë, por vetëm për në katin e parë, ndërkohë të gjitha shërbimet e nevojshme janë në katin e dytë.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

*“Rampa në Bashkinë tonë përdoret nga fëmijët që të rrëshqasin. Është shumë e pjerrët, pa asnjë relief që të frenojë rrëshqitjen, sidomos në ditë me shi, dhe për më shumë pa asnjë bordurë mbajtëse.” (përfaqësues i një organizate)*

Lidhur me aktivitetet e parashikuara në objektivin e dytë të këtij qëllimi strategjik, pjesëmarrësit në studim identifikuan mungesa të thella në ofrimin e informacionit në mënyrë të thjeshtë dhe të përshtatur nga institucionet publike, mungesën e programeve kompjuterike dhe aplikacioneve celulare në gjuhën shqipe që do të mundësonin aksesin në informacionin e shkruar të personave që nuk shikojnë, mungesën e **interpretëve** për gjuhën e shenjave, si dhe mundësitë e kufizuara për informacion të përshtatur nga mediat lokale dhe kombëtare.

*“Nuk ka aplikacione në shqip për kthimin e informacionit të shkruar në audio. Unë me zor kam gjetur një version të piratuar në celularin tim, por dhe ai shumicën e kohës nuk më ndihmon.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

*“Asnjë nga institucionet publike nuk ofron informacion në gjuhën Braille.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Pavarësisht se jemi një nga bashkitë më të mëdha në vend, nuk ka asnjë interpret për gjuhën e shenjave që të mund të asistojë personat që nuk dëgjojnë në institucione publike a gjykatë. Ndhimohen vetëm pak nga familjarët, të cilët nuk janë të trajnuar dhe ‘kanë shpikur’ gjuhën e tyre të shenjave.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Lajmet në televizionin lokal, pavarësisht se është publik, nuk janë ofruar asnjëherë në gjuhën e shenjave. Vetëm ato pak minuta në RTSH mendojnë se janë të nevojshme. Të paktën të vendosin titra.” (familjar personi me aftësi të kufizuara)*

Të pyetur rreth eksperiencave të tyre lidhur me aktivitetet e parashikuara në PKVPAK mbi aksesin në transportin publik, pjesëmarrësit në studim identifikuan një seri problematikash. Disa nga vështirësitë më shpesh të raportuara lidhen me vështirësitë e hasura nga personat me aftësi të kufizuara gjatë lëvizjes në ambientet publike të qyteteve dhe fshatrave ku banojnë, pavarësisht ndërhyrjeve të shumta që mund të jenë kryer në infrastrukturën rrugore.

*“Kur u rindërtua sheshi, vjet ose parvjet, Bashkia nuk mendoj se duhet të dëgjonte dhe nevojat tona. Kështu, papritur u gjendëm më një shesh të ri, krejt të panjohur për personat me vështirësi në shikim - plot me shkallë dhe disnivele për të kaluar nga një anë në tjetrën dhe pa asnjë sinjalistikë ndihmëse” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

*“Në shumicën e rrugëve dhe trotuareve të qytetit është e pamundur të lëvizesh në mënyrë të pavarur nëse ke një fëmijë me vështirësi në lëvizje. Edhe në ato pak trotuare të cilët kanë riparuar dhe kanë vendosur zona të pjerrëta, nuk e di pse nuk e mendojnë që është e pamundur t'i përdorësh në mënyrë të pavarur nëse i bëjnë me hark ose nuk eliminojnë ullukun e rrugës.” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Vijat e bardha shuhen një – dy muaj pasi i kanë bërë. Për mua (që kam vështirësi në shikim) ato janë të domosdoshme për orientim se ku mund të kaloj rrugën.” (person me aftësi të kufizuara)*

Pavarësisht se në bashkitë ku ka shërbim të transportit urban pjesëmarrësit në të shumtën e rasteve vlerësonin pozitivisht rimbursimin e biletës, sërish kishte disa vështirësi të raportuara në këtë drejtim. Megjithatë, këto problematika u raportuan më të shumta në numër lidhur me

transportin interurban dhe rimbursimin e kostos së karburantit. Shumica e pjesëmarrësve në takimet e zhvilluara në të katër bashkitë e përfshira në studim raportuan se nuk kanë përfituar rimbursim të kostove lidhur me transportin interurban.

*“Fëmijës tim, pavarësisht se tani është rritur, nuk i kanë marrë asnjëherë biletë, por mua gjithmonë. Ai nuk mund të lëviz i vetëm dhe unë duhet gjithmonë ta shoqëroj, megjithatë mua nuk me njihet asnjë ulje në pagesë.” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Shumica e autobusëve (urbanë) e kanë nga një tabelë të vogël për vendet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, por asnjë nga autobusët e qytetit nuk është I përshtatur, sidomos për personat me karrocë. Edhe në rast se dua të marr urbanin, më duhet ndihma e të paktën dy a tre vetëve të tjerë për të hipur.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Asnjërin nga ne nuk e kanë lejuar ndonjëherë të udhëtojë me autobusë ose furgonë dhe të paguaj pjesërisht biletën. Vetëm nëse e bëjnë për ‘gjynah’. Gjithmonë kam qenë kurioz ta di nëse Bashkia ua ka vendosur si kriter zbatimin e ligjit për t’u dhënë licencat ose nëse e kanë të shënuar brenda kontratës.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

*“Djali im është tetraplegjik. Herën e fundit që më duhet ta dërgoja për arsye shëndetësore në Tiranë, asnjë nga shoferët e furgonave nuk ma pranoi. Sidomos kur e shikonin me ‘panolino’ me thonin që nuk e pranonte asnjë nga pasagjerët e tjerë. Dhe ashtu ishte. Për këtë arsye u detyrova të paguaj taksi 200 mijë lek (të vjetra) që ta çoja në spital. Dhe më pas të thonë që duke qenë se nuk ka makinë në emrin e tij dhe nuk e përdor për punë, nuk të rimbursohet as karburanti.” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

## 3.2. Barazia në sistemin e drejtësisë

Garantimi i aksesit në sistemin e drejtësisë përbën qëllimin e dytë strategjik<sup>8</sup> të PKVPAK, i cili është vlerësuar në këtë monitorim përmes përmbushjes së 16 aktiviteteve lidhur me dy objektivat në vijim: (1) ndihma juridike falas<sup>9</sup> dhe (2) sigurimi i barazisë para ligjit<sup>10</sup>.

Të dhënat në Tabelën 13 dhe në Tabelën 14 paraqesin vlerësimin e përgjithshëm të qëllimit të dytë strategjik dhe objektivave përkatëse, nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të organizatave gjatë vitit 2019 dhe 2020, të shprehura në mesatare, ku 1 është vlera më e vogël dhe 4 vlera më e madhe.

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre raportojnë se janë “të pakënaqur” lidhur me garantimin e aksesit në sistemin e drejtësisë vlerësuar me mesatare **1.44** (Tabela 13) ndërsa përfaqësuesit e organizatave e vlerësojnë me “nivel të ulët kënaqësie” këtë qëllim strategjik, vlerësuar me mesatare **1.97** (Tabela 14).

**Tabela 13: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Barazia në sistemin e drejtësisë</b>	<b>463</b>	<b>1.36</b>	<b>500</b>	<b>1.44</b>
Ndihma juridike falas	448	1.27	487	1.44
Sigurimi i barazisë para ligjit	437	1.43	476	1.45

**Tabela 14: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Barazia para ligjit</b>	<b>59</b>	<b>2.07</b>	<b>63</b>	<b>1.97</b>
Ndihma juridike falas	57	2.20	61	1.88
Sigurimi i barazisë para ligjit	56	1.93	61	2.04

Ndryshimet në vlerësimin e përmbushjes së qëllimit strategjik lidhen me ndryshimet e raportuara nga të dy grupimet kryesore në këtë studim lidhur me secilin nga objektivat e matur.

Kështu, pavarësisht ndryshimeve në mesataren e vlerësimit lidhur me objektivin mbi ndihmën ligjore falas mes personave me aftësi të kufizuara (M = **1.44**) dhe përfaqësuesve të organizatave (M = **1.88**), gjatë vitit 2020, të dy këto nëngrupe të kampionit kanë identifikuar ndryshime statistikisht të rëndësishme të ndodhura gjatë vitit të fundit në këtë drejtim, por në kahe të

8. Qëllimi strategjik 2. “Të garantohet akses në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara”

9. Objektivi nr. 2.1: “Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara, të kualifikueshëm për ndihmë juridike falas, që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas”

10. Objektivi nr. 2.2: “Sigurimi i barazisë para ligjit të të gjithë personave me aftësi të kufizuara”

ndryshme. Teksa personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre raportojnë një ndryshim pozitiv nga viti 2019 në vitin 2020 në disa nga aktivitetet e lidhur me këtë objektiv, përfaqësuesit e organizatave vlerësojnë se gjatë vitit të fundit janë bërë hapa pas.

Objektivi i dytë lidhur me sigurimin e barazisë përpara ligjit është vlerësuar sërish si “aspak i kënaqshëm” nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, duke mbledhur një mesatare **1.45** dhe si “pak i kënaqshëm” nga përfaqësuesit e organizatave me një mesatare **2.04**.

Më poshtë përmbledhen vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave lidhur me secilin nga aktivitetet e përfshirë në studim për të dy objektivat kryesore të lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë.

### 3.2.1. Vlerësimi i aktiviteteve të ndihmës juridike falas

Aktivitetet e objektivit lidhur me “ndihmën juridike falas” vlerësohen nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në nivel “aspak” ose “pak” të kënaqshëm, me mesatare që variojnë nga **1.30 – 1.70** (Tabela 15).

Duke krahasuar vlerësimet e mbledhura gjatë të dy viteve të monitorimit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme gjatë vitit të fundit lidhur me dy nga gjashtë aktivitetet e përfshira nën këtë objektiv, të cilët lidhen me ofrimin e ndihmës juridike dhe përshtatshmërinë e komunikimit gjatë marrjes së këtij shërbimi. Pavarësisht këtyre ndryshimeve pozitive, të dy këto objektiva raportohen ende në nivel të pakënaqshëm me mesatare **1.30** dhe **1.45** respektivisht.

E shprehur në përqindje, të dhënat tregojnë se mbi dy në tre pjesëmarrës në studim gjatë vitit 2020 vlerësojnë se mundësitë e ofrimit të ndihmës ligjore falas (**73.8%**) dhe përshtatshmëria e gjuhës dhe informacionit gjatë ofrimit të këtij shërbimi (**68.3%**) janë “aspak” të kënaqshme (Shtojca B).

**Tabela 15: Ndhimja juridike falas vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Ndhimja juridike falas	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Ofrimi i ndihmës juridike (ndihmë ligjore) për personat me aftësi të kufizuara	377	1.19	446	1.30
Niveli i kënaqësisë për ndihmë juridike	133	1.59	174	1.57
Njohuritë dhe kapacitetet e juristëve që kanë ofruar ndihmën juridike për çështjet e aftësisë së kufizuar	124	1.62	175	1.70
Përkthim në gjuhën e shenjave, formate Braille, gjuhë e thjeshtuar gjatë ofrimit të ndihmës juridike	160	1.28	208	1.45
Trajnim për shërbimet e ndihmës juridike, kriteret e përfitimit, e të tjera	386	1.18	432	1.39
Informacion në internet për ndihmën juridike	384	1.48	438	1.56

Edhe gjatë vitit 2020, përfaqësuesit e organizatave i vlerësojnë me një nivel më të lartë kënaqësie përmbushjen e aktiviteteve të këtij objektivi në krahasim me personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, duke raportuar mesatare që variojnë nga **1.61 në 2.31** (Tabela 16).

Pavarësisht këtyre ndryshimeve në mesatare, përfaqësuesit e organizatave raportojnë një përkeqësim të situatës lidhur me këtë objektiv në krahasim me një vit më parë, i cili reflektohet dhe nga ndryshimi statistikisht i rëndësishëm në vlerësimin e aktivitetit mbi informacionin e ofruar në internet mbi ndihmën ligjore falas. Ky aktivitet është vlerësuar më një mesatare **1.67** në vitin 2020, kundrejt vlerës mesatare **2.28** të raportuar gjatë monitorimit të kryer në vitin 2019. E shprehur në përqindje, të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 tregojnë se **61.1%** e përfaqësuesve të organizatave raportojnë se nuk kanë marrë asnjëherë informacion në internet lidhur me ndihmën juridike (Shtojca B).

**Tabela 16: Ndihma juridike falas vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Ndihma juridike falas	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Ofrimi i ndihmës juridike (ndihmë ligjore) për personat me aftësi të kufizuara	39	2.20	52	2.12
Niveli i kënaqësisë për ndihmë juridike	21	2.09	31	2.10
Njohuritë dhe kapacitetet e juristëve që kanë ofruar ndihmën juridike për çështjet e aftësisë së kufizuar	34	2.50	39	2.31
Përkthim në gjuhën e shenjave, formate Braille, gjuhë e thjeshtuar gjatë ofrimit të ndihmës juridike	34	2.17	31	1.74
Trajnim për shërbimet e ndihmës juridike, kriteret e përfitimit, e të tjera	42	2.02	49	1.61
Informacion në internet për ndihmën juridike	50	2.28	54	1.67

### 3.2.2. Sigurimi i barazisë para ligjit

Për vlerësimin e objektivit “Sigurimi i barazisë para ligjit”, edhe gjatë monitorimit të kryer gjatë vitit 2020, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre u kërkuan të vlerësonin dhjetë aktivitete të parashikuara në PKVPAK. Të dhënat e pasqyruara në Tabelën 17 tregojnë se vlerësimi i aktiviteteve të këtij objektiv varion nga **1.16** në **1.68**.

Duke krahasuar të dhënat mes dy viteve, rezultatet tregojnë se pavarësisht se kampioni i intervistuar gjatë vitit 2020 raporton dijeni për më shumë persona që janë nën kujdestarinë ligjore (**M = 1.56**) dhe kanë pasur çështje të adresuara në gjykata ose prokurori (**M = 1.41**), vlerësimi lidhur me ushtrimin e kujdestarisë (**M = 1.43**) dhe aksesueshmërinë në institucionet e drejtësisë (**M = 1.63**) është përkeqësuar, duke rezultuar në ndryshime statistikisht të rëndësishme krahasuar me një vit më parë. Kështu, **69.9%** e personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre shprehen se nuk janë “aspak” të kënaqur me mënyrën e ushtrimit të kujdestarisë ligjore, ndërsa gati gjysma e të intervistuarve (**49.9%**) vlerësojnë se institucionet e sistemit të drejtësisë nuk janë “aspak” të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara (Shtojca B).

Gjithashtu, të dhënat e vitit 2020, në mënyrë të ngjashme me ato të vitit të kaluar, tregojnë se shumica e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre nuk kanë “aspak” informacion mbi ndryshime ligjore në lidhje me kujdestarinë (**58.2%**) dhe vendimmarrjen e mbështetur (**66.2%**) (Shtojca B).

**Tabela 17: Sigurimi i barazisë para ligjit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Sigurimi i barazisë para ligjit	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Të paturit e kujdestarit ligjor (përveç kujdestarit që përfitoni në bazë të vendimit të KMCAP)	377	1.19	392	1.16
Mënyra e ushtrimit të kujdestarisë	118	1.73	166	1.43
Njohje të personave që janë nën kujdestari ligjore	267	1.32	345	1.56
Çështje në gjykatë/ prokurori	369	1.15	389	1.41
Niveli i kënaqësisë nga shërbimi i avokatit që ka ndjekur çështje ligjore	136	1.57	278	1.68
Niveli i kënaqësisë me procedurat, shpenzimet, kohëzgjatja, aksesin, komunikimi në sistemin e drejtësisë	158	1.66	272	1.55
Dijeni për persona në kujdestari ligjore dhe hasin probleme me vendimmarrjen	55	1.64	183	1.57
Informacion mbi ndryshime ligjore në lidhje me kujdestarinë ligjore	221	1.45	347	1.54
Njohuri mbi vendimmarrjen e mbështetur	240	1.35	325	1.42
Aksesueshmëria në sistemin e drejtësisë për PAK	370	1.80	397	1.63

Lidhur me aktivitetet e parashikuar nën këtë objektiv, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar mesatare që variojnë nga **1.46 në 2.29** (Tabela 18).

Në ndryshim nga personat me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e organizatave vlerësojnë më pozitivisht njohuritë e tyre lidhur me ndryshimet ligjore mbi kujdestarinë (**M = 2.27**) dhe vendimmarrjen e mbështetur (**M = 2.29**), duke raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm krahasuar me të dhënat e mbledhura një vit më parë lidhur me këto dy aktivitete.

Megjithatë, edhe mes këtij grupimi, **33.3%** e përfaqësuesve të organizatave nuk janë “aspak” të kënaqur me mënyrën e ushtrimit të kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa **44.4%** e tyre nuk janë “aspak” të kënaqur me procedurat, shpenzimet, kohëzgjatjen, aksesin dhe komunikimin e ofruar nga institucionet në sistemin e drejtësisë (Shtojca B).

**Tabela 18: Sigurimi i barazisë para ligjit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Sigurimi i barazisë para ligjit	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Të paturit e kujdestarit ligjor (përveç kujdestarit që përfitoni në bazë të vendimit të KMCAP)	40	2.22	45	1.87
Mënyra e ushtrimit të kujdestarisë	19	2.57	24	2.04
Mbështetje për persona me aftësi të kufizuara në gjykatë, prokurori	47	1.44	46	1.46
Niveli i kënaqësisë me procedurat/ shpenzimet, kohëzgjatja, aksesin, komunikimi në sistemin e drejtësisë	34	1.70	27	2.04
Informacion mbi ndryshime ligjore në lidhje me kujdestarinë ligjore	34	1.73	48	2.27
Njohuri mbi vendimmarrjen e mbështetur	34	1.79	45	2.29
Aksesueshmëria në sistemin e drejtësisë për PAK	40	2.15	47	2.09

Të dhënat cilësore të mbledhura nga pyetjet e hapura të pyetësorit dhe diskutimet në grup me personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë identifikojnë mungesë informacioni nga ana e pjesëmarrësve lidhur me kuadrin rregullator në fuqi dhe kriteret e përfitimit të ndihmës ligjore falas për personat me aftësi të kufizuara, si dhe informacion të kufizuar mbi shërbimet që ofrohen në këtë drejtim nga organizatat e shoqërisë civile.

*“E di që është një zyrë që ofron shërbime ligjore falas pranë gjykatës, por në dijeninë time u ofron shërbim vetëm disa grupeve të caktuara, si grave viktime të dhunës në familje, etj. Nuk di nëse e ofrojnë këtë shërbim për personat me aftësi të kufizuara, ose nëse kanë dhe njohuritë e nevojshme.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Nëpër zyra (institucione publike) të thonë që të gjitha ligjet dhe kriteret i ke ‘online’, por nuk është e lehtë. Ka shumë faqe të ndryshme, ka shumë ligje, si dhe ka shumë ndryshime të këtyre ligjeve. Përveç gjuhës ligjore, asnjëherë nuk je e sigurtë nëse ke gjetur variantin përfundimtar.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Në gjykata nuk ka asnjëherë interpret. Është si të jesh në një vend të huaj ku nuk di gjuhën.” (person me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues i një organizate)*

*“Shoqata jonë ofron informacion mbi ligjet. Nuk kemi jurist, por me gjithë këto vite eksperiencë dhe trajnime, mund t’i orientojmë të verbërit për procedurat dhe të drejtat që kanë. Por dhe për këtë shërbim, njësoj si në institucionet publike, aksesit (fizik) është i vështirë, duke qenë se Bashkia na ka dhënë një zyrë të vogël dhe shumë të errët në katin e tretë.” (person me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues i një organizate)*

### 3.3. Arsimi, formimi profesional dhe punësimi

Pjesëmarrja në tregun e punës dhe promovimi i mundësive të barabarta përbën qëllimin e tretë strategjik<sup>11</sup> të PKVPAK dhe përbëhet nga tre objektiva, përkatësisht: përmirësimi i cilësisë dhe mbulimi i shërbimeve të Arsimit e Formimit Profesional, të cilat nxisin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës<sup>12</sup>; lehtësimi i integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit (PNP)<sup>13</sup> dhe përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve të tregut të punës<sup>14</sup>. Të tre objektivat janë parashikuar të përmbushen përmes realizimit të 15 aktiviteteve.

Në lidhje me këtë qëllimin strategjik, pjesëmarrësit në studim gjatë vitit 2020 vazhdojnë të jenë “pak të kënaqur”, duke e vlerësuar me një mesatare **1.92** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre (Tabela 19) dhe **2.00** nga përfaqësuesit e organizatave (Tabela 20).

**Tabela 19: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me pjesëmarrjen në tregun e punës dhe promovimin e mundësive të barabarta nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Arsim, Formim Profesional dhe Punësim</b>	<b>363</b>	<b>1.77</b>	<b>502</b>	<b>1.92</b>
Përmirësimi i cilësisë së AFP-së	304	2.02	477	2.07
Integrimi në tregun e punës përmes PNP	313	1.50	477	1.82
Përmirësimi i shërbimeve të punësimit	339	1.73	478	1.89

**Tabela 20: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me pjesëmarrjen në tregun e punës dhe promovimin e mundësive të barabarta nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Arsim, Formim Profesional dhe Punësim</b>	<b>57</b>	<b>1.79</b>	<b>62</b>	<b>2.00</b>
Përmirësimi i cilësisë së AFP-së	51	1.95	58	2.15
Integrimi në tregun e punës përmes PNP	57	1.62	62	1.96
Përmirësimi i shërbimeve të punësimit	54	1.75	59	1.93

11. Qëllimi strategjik nr. 3: “Të rritet pjesëmarrja në tregun e punës dhe të promovohen mundësi të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara”

12. Objektivi nr. 3.1: “Përmirësimi i cilësisë dhe shtrirjes së shërbimeve të AFP-së që nxisin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës”

13. Objektivi nr. 3.2: “Lehtësimi i integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit”

14. Objektivi nr. 3.3: “Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve dhe shërbimeve të punësimit që synojnë nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës”

Të dhënat e mësipërme tregojnë një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë, e cila lidhet kryesisht me ndryshime pozitive të identifikuar në objektivat mbi integrimin në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit dhe përmirësimin e shërbimeve të punësimit nga i njëjti grup. Ndërkohë, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme vetëm në lidhje me objektivin e dytë.

Pavarësisht se krahasimi i të dhënave mes viteve nuk tregojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të Arsimit e Formimit Profesional është objektivi i vlerësuar më pozitivisht nën këtë qëllim edhe gjatë vitit 2020, duke u raportuar me një mesatare **2.07** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.15** nga përfaqësuesit e organizatave.

Objektivi lidhur me integrimin në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit (PNP) është vlerësuar si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, duke u raportuar me mesatare **1.82** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **1.96** nga përfaqësuesit e organizatave.

Në nivele të ngjashme vlerësimi, objektivi i tretë lidhur me përmirësimin e shërbimeve të punësimit është vlerësuar me një mesatare **1.89** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **1.93** nga përfaqësuesit e organizatave.

Më poshtë përmbledhen vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave lidhur me secilin nga aktivitetet e përfshirë në studim për të tre objektivat kryesore të lidhur me arsimin dhe formimin profesional, si dhe punësimin.

### **3.3.1. Vlerësimi i aktiviteteve të përmirësimit të cilësisë dhe mbulimit të shërbimeve të Arsimit e Formimit Profesional, të cilat nxisin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës**

Lidhur me përmbushjen e pesë aktiviteteve kryesore nën këtë objektivi, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 nuk kanë raportuar asnjë ndryshim të rëndësishëm statistikor krahasuar me një vit më parë, duke vlerësuar aktivitetet me mesatare që variojnë nga **1.72** në **2.24** (Tabela 21).

Aktiviteti i vlerësuar më negativisht është ai lidhur me mbështetjen me pajisje dhe mjete për vetëpunësim pas mbarimit të kurseve të formimit profesional (**M = 1.72**), për të cilin **41.4%** e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre u shprehën “aspak” të kënaqur (Shtojca B).

**Tabela 21: Përmirësimi i cilësisë së AFP-së vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Përmirësimi i cilësisë së AFP-së	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i informimit dhe niveli i ndjekjes së kurseve të formimit profesional falas për personat me aftësi të kufizuara	284	2.12	462	2.20
Tipologjia e kurseve që ofrohen në qendrat e formimit profesional	262	2.05	444	2.09
Cilësia e mësimdhënies/përgatitja e instruktorëve në kurset e formimit profesional	251	2.25	427	2.24
Kurrikula të qarta, të thjeshta dhe në formate të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara	238	2.12	417	2.12
Mbështetje me pajisje, mjete për vetëpunësim pasi mbaron kursin e formimit profesional	226	1.74	413	1.72

Në mënyrë të ngjashme, dhe përfaqësuesit e organizatave raportojnë se janë “pak” të kënaqur me përmbushjen e aktiviteteve të këtij objektivi, të cilët vlerësohen me mesatare nga **1.95** në **2.42**, ndërsa aktiviteti i vlerësuar më negativisht mbetet ai lidhur me mbështetjen me pajisje dhe mjete për vetëpunësim pas mbarimit të kurseve të formimit profesional (**M = 1.95**) (Tabela 22).

Pavarësisht ngjashmërive në vlerësim, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm gjatë vitit 2020 krahasuar me një vit më parë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e instruktorëve në kurset e formimit profesional (**M = 2.42**), me **52.5%** të pjesëmarrësve që shprehen “disi” ose “shumë” të kënaqur lidhur me këtë aktivitet (Shtojca B).

**Tabela 22: Përmirësimi i cilësisë së AFP-së vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përmirësimi i cilësisë së AFP-së	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i informimit dhe niveli i ndjekjes së kurseve të formimit profesional falas për personat me aftësi të kufizuara	45	2.31	49	2.29
Tipologjia e kurseve që ofrohen në qendrat e formimit profesional	44	1.77	49	2.08
Cilësia e mësimdhënies/përgatitja e instruktorëve në kurset e formimit profesional	40	1.92	40	2.42
Kurrikula të qarta, të thjeshta dhe në formate të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara	34	2.14	41	2.07
Mbështetje me pajisje, mjete për vetëpunësim pasi mbaron kursin e formimit profesional	40	1.82	45	1.95

### 3.3.2. Vlerësimi i aktiviteteve për lehtësimin e integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit (PNP)

Në ndryshim nga objektivi i mëparshëm, gjatë vitit 2020, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme lidhur me të gjithë aktivitetet e përfshirë nën objektivin mbi integritin në vendin e punës përmes programeve të nxitjes së punësimit krahasuar me një vit më parë, pavarësisht se vlerësimet vijnë të jenë “pak” të kënaqshme, me mesatare që variojnë nga **1.73** në **1.95** (Tabela 23).

Më shumë se tre në katër persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre vlerësojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me të gjithë aktivitetet nën këtë objektiv: mundësitë që u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për t’u punësuar në përputhje me aftësitë e tyre (**84.5%**); programet e nxitjes së punësimit që ofron zyra e punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (**75.4%**); mundësitë e ofruara për të kryer praktika profesionale në institucione apo biznese (**86.8%**); dhe mbështetjen e ofruar për ndërmarrjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara (**87.5%**) (Shtojca B).

**Tabela 23: Integrimi në tregun e punës vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Integrimi në tregun e punës përmes PNP	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Mundësitë që u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për t’u punësuar në përputhje me aftësitë e tyre	290	1.40	465	1.79
Programet e nxitjes së punësimit që ofron zyra e punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara	254	1.65	456	1.95
Mundësitë e ofruara për të kryer praktika profesionale në institucione apo biznese	265	1.53	447	1.82
Mbështetja e ofruar për ndërmarrjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara	270	1.60	440	1.73

Edhe për këtë objektiv, vlerësimet e përfaqësuesve të organizatave gjatë vitit 2020 janë të ngjashme me ato të personave me aftësi të kufizuara, duke raportuar gjatë vitit 2020 mesatare që variojnë nga **1.87 në 2.02**, dhe ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme krahasuar me një vit më parë në tre nga katër aktivitetet e përfshira në objektiv (Tabela 24).

I vetmi aktivitet për të cilin përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 nuk raportojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme lidhet me mbështetjen e ofruar për ndërmarrjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara (**M = 1.96**), të cilën **72.7%** e të anketuarve në këtë grupim e vlerësojnë si “aspak” ose “pak” të kënaqshme (Shtojca B).

**Tabela 24: Integrimi në tregun e punës vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Integrimi në tregun e punës përmes PNP	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Mundësitë që u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për t’u punësuar në përputhje me aftësitë e tyre	54	1.61	56	2.02
Programet e nxitjes së punësimit që ofron zyra e punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara	51	1.56	56	1.93
Mundësitë e ofruara për të kryer praktika profesionale në institucione apo biznese	48	1.39	53	1.87
Mbështetja e ofruar për ndërmarrjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara	45	1.77	55	1.96

### 3.3.3. Vlerësimi i aktiviteteve lidhur me përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve të tregut të punës dhe shërbimeve që synojnë nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Aktivitetet e objektivit lidhur me përmirësimin e shërbimeve të punësimit vlerësohen nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në nivel “pak” të kënaqshëm, me mesatare që variojnë nga **1.61 – 2.09** (Tabela 25).

Duke krahasuar vlerësimet e mbledhura gjatë të dy viteve të monitorimit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar ndryshime pozitive statistiki të rëndësishme gjatë vitit të fundit lidhur me tre nga gjashtë aktivitetet e përfshira nën këtë objektiv, të cilët lidhen me cilësinë e shërbimit që ofrohet nga zyrat e punësimit, informacionin e ofruar prej tyre, si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara pranë qendrave rinore.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve pozitive, **85.6%** e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre e vlerësojnë si “aspak” ose “pak” të kënaqshëm nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrën e Punësimit dhe më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (**57.8%**) nuk njohin asnjë person me aftësi të kufizuara të punësuar në Qendra Rinore (Shtojca B).

**Tabela 25: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Përmirësimi i shërbimeve të punësimit	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Cilësia e shërbimit që ofrohet për personat me aftësi të kufizuara nga zyrat e punësimit.	298	1.79	451	2.09
Realizimi nga punonjësit e zyrave të punësimit i një vlerësimi të detajuar mbi aftësitë dhe nevojat e veçanta për një person me aftësi të kufizuara.	253	1.98	437	1.92
Informacioni i ofruar nga zyrat e punësimit për programet dhe subvencionet (mbështetjet financiare) që ato ofrojnë për punësimin e PAK.	196	1.67	427	2.06
Realizimi i fushatave informuese (mbi respektimin e kuotës, çështjet e diskriminimit, shembuj pozitive, etj.) nga zyrat e punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.	284	1.93	436	1.89
Niveli i punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrën e Punësimit.	297	1.70	458	1.77
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në Qendrën Rinore.	275	1.36	425	1.61

Në ndryshim nga dy objektivat e tjerë, përfaqësuesit e organizatave nuk kanë raportuar asnjë ndryshim të rëndësishëm statistikor për asnjë nga aktivitetet e lidhur me shërbimet e punësimit gjatë vitit 2020, me vlerësime nga “aspak” në “pak” të kënaqshme dhe mesatare që variojnë nga **1.40 në 2.16** (Tabela 26).

Edhe për përfaqësuesit e organizatave, dy aktivitetet e vlerësuar më negativisht mbeten ato të lidhur me nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrën e Punësimit (**M = 1.70**) dhe pranë Qendrave Rinore (**M = 1.40**), ndërkohë që **42.6%** e tyre mendojnë se cilësia e shërbimit që ofrohet për personat me aftësi të kufizuara nga zyrat e punësimit është “aspak” e kënaqshme (Shtojca B).

**Tabela 26: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përmirësimi i shërbimeve të punësimit	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Cilësia e shërbimit që ofrohet për personat me aftësi të kufizuara nga zyrat e punësimit.	50	1.64	54	1.89
Realizimi nga punonjësit e zyrave të punësimit i një vlerësimi të detajuar mbi aftësitë dhe nevojat e veçanta për një person me aftësi të kufizuara.	38	1.81	45	2.16
Informacioni i ofruar nga zyrat e punësimit për programet dhe subvencionet (mbështetjet financiare) që ato ofrojnë për punësimin e PAK.	34	1.70	44	2.09
Realizimi i fushatave informuese (mbi respektimin e kuotës, çështjet e diskriminimit, shembuj pozitive, etj.) nga zyrat e punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.	39	1.76	50	2.02
Niveli i punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrën e Punësimit.	32	1.53	30	1.70
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në Qendrën Rinore.	30	1.63	35	1.40

Të dhënat cilësore të mbledhura gjatë këtij studimi tregojnë se personat me aftësi të kufizuara ndeshen me disa problematika të shtuara në përfitimin e arsimit dhe kurseve të formimit profesional, si dhe përfshirjen në tregun e punës.

Lidhur me ndjekjen e arsimit profesional, në të shumtën e rasteve, personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave raportojnë se nuk ofrohen mundësi të tilla pranë zonave të tyre të banimit. Gjithashtu, mangësi raportohen dhe lidhur me mundësitë për ndjekjen e kurseve të formimit profesional të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, duke ndikuar negativisht në mundësitë e mëtejshme të punësimit ose përfshirjes në aktivitete prodhuese.

*“Në bashkinë tonë ka vetëm një shkollë profesionale për pedagogji dhe në dijeninë time nuk ka asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara që e ndjek atë. Në të vërtetë, për këta fëmijë ka nevojë për shkolla ose kurse profesionale që u mësojnë zanatë” (familjar personi me aftësi të kufizuara)*

*“Në qytetin tonë ka një ‘atelie’ për personat me aftësi të kufizuara, por numri i personave që mund ta ndjekin është shumë i vogël krahasuar me nevojat. Gjithashtu, kurset e ofruara nuk janë të strukturuar ose akredituar, pra nuk të njihen në tregun e punës. Mund të quhet më shumë si një qendër ditore me kapacitete shumë të kufizuara.” (përfaqësues i një organizate)*

Qëndrimet e pjesëmarrësve lidhur me eksperiencat në zyrat e punës dhe integrimin në tregun e punës identifikuan një seri problematikash që lidhen kryesisht me aksesin fizik në zyrat e punës, mungesën e vlerësimit lidhur me nevojat e personave me aftësi të kufizuara për kushte pune të përshtatura, mosrespektimin e kuotave të punësimit edhe brenda institucioneve publike, si dhe mundësitë e pakta të ofruara deri tani për punë.

*“Ndoshta jam i vetmi që vazhdoj dhe shkoj rregullisht për të plotësuar formularët që kërkojnë. Deri para pak kohësh, kërkonin që të plotësoja kërkesën çdo tre muaj, tani çdo një muaj. Kështu, çdo muaj, pavarësisht vështirësive në lëvizje, mua më duhet të ngjitem deri në katin e tretë. Megjithatë, në dhjetë vite, asnjëherë nuk me kanë ofruar asnjë pozicion.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Pasi përfundova universitetin, aplikova dhe më pranuan për gjashtë muaj praktikë në Bashki. Tani kam më shumë se një vit e gjysmë që pres të më ofrojnë ndonjë pozicion, por nuk ka ndodhur, pavarësisht se kanë punësuar disa persona në fushën time. Shkoj pothuaj përditë për t’u interesuar... aq shpesh sa javën e kaluar dikush më tha ‘Bravo, paske filluar punë në Bashki!’.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Në të gjitha rastet që njoh, askush nuk më ka përmendur që bashkë me regjistrimin e kërkesës për punë, bëjnë dhe një vlerësim mbi nevojat që secili ka për përshtatshmëri. Në fund të çdo procesi të thonë që të vetmet vende punë që kanë janë në fasoneri, pa u kërkuar asnjëherë këtyre bizneseve të përshtatin kushtet e punës.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

*“Unë e njoh ligjin. Edhe ndryshimet që bëjnë vjet mbi sanksionet e reja për ndërmarrjet private. Po cili institucion pritet ta monitorojë, kur dhe vetë institucionet publike nuk i zbatojnë kuotat. Vetëm në Bashki njohim një person me aftësi të kufizuara. Dhe ajo është punësuar sepse është e afërmja e kryetarit (të bashkisë).” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

## 3.4. Arsimi

Arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara përbën qëllimin e katërt strategjik<sup>15</sup> të PKVPAK, i cili synon të arrihet nëpërmjet dy objektivave: përmirësimi i cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve mbi mësimdhënien për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara<sup>16</sup> dhe shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore<sup>17</sup>. Të dy këta objektiva janë vlerësuar në këtë studim mes një seti të vetëm pyetjesh të përbërë nga tetë aktivitete.

Të dhënat në Tabelën 27 dhe Tabelën 28 paraqesin vlerësimin e përgjithshëm të qëllimit të katërt strategjik nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave, të shprehura në mesatare ku 1 është vlera më e vogël dhe 4 vlera më e madhe.

15. Qëllimi strategjik nr 4: “Të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara”

16. Objektivi nr. 4.1: “Përmirësimi i cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara”

17. Objektivi nr. 4.2: “Transformimi i shkollave të specializuara në qendra burimore”

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, në mënyrë të ngjashme me përfaqësuesit e organizatave, e vlerësojnë përmbushjen e qëllimit mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe cilësor në tërësi si “pak” të kënaqshëm, me një mesatare të njëjtë **2.39**.

**Tabela 27: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi arsimin cilësor dhe gjithëpërfshirës nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Arsimi gjithëpërfshirës	366	2.34	517	2.39

**Tabela 28: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi arsimin cilësor dhe gjithëpërfshirës nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Arsimi gjithëpërfshirës	56	1.99	64	2.39

Pavarësisht vlerës mesatare të njëjtë mes dy grupimeve, të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 tregojnë se vlerësimi i këtij qëllimi nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre ka ngelur i ngjashëm me atë të vitit të kaluar, ndërsa përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në krahasim me vlerësimin e një viti më parë.

### 3.4.1. Vlerësimi i aktiviteteve lidhur me përmirësimin e cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët aftësi të kufizuara

Aktivitetet e lidhur me arsimin gjithëpërfshirës vlerësohen nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në nivel “pak” dhe “disi” të kënaqshëm, me mesatare që variojnë nga **1.92 – 2.55** (Tabela 29).

Pavarësisht se vlerësimi mesatar i këtij qëllimi strategjik nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre nuk ka ndryshuar në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë, pjesëmarrësit kanë identifikuar ndryshime statistikisht të rëndësishme në pesë nga tetë aktivitetet e vlerësuar. Megjithatë, ndryshimet e identifikuara nuk tregojnë domosdoshmërisht një përmirësim të situatës, duke qenë se në tre prej aktiviteteve raportohet përkeqësim i vlerësimit, ndërsa në dy të tjera përmirësim.

Të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 tregojnë se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre e vlerësojnë më pak të kënaqshme situatën krahasuar me vitin e mëparshëm lidhur me cilësinë e shkollimit (**M = 2.42**), punën e komisioneve të vlerësimit pranë DAR dhe institucioneve arsimore (**M = 2.43**) dhe mundësitë që iu ofron shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u integruar me fëmijët e tjerë (**M = 2.47**).

Ndërkohë, raportojnë përmirësim të situatës lidhur me informacionin e ofruar nga Bashkia për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (**M = 2.40**) dhe mundësinë e transportit falas për ndjekjen e procesit mësimor (**M = 1.92**). Pavarësisht ndryshimeve pozitive, ky i fundit mbetet

aktiviteti i vlerësuar më negativisht dhe gjatë vitit të dytë të monitorimit brenda këtij qëllimi, me më shumë se një në tre të intervistuar (**35.8%**) që raportojnë se nuk u ofrohet asnjë mundësi transporti falas për në shkollë (Shtojca B).

Vlerësimi ka mbetur i njëjtë dhe këtë vit lidhur me praninë e mësuesit ndihmës dhe përdorimin e Planit Edukativ Individual (PEI), aktivitete për të cilat **58.1%** dhe **54.2%** e të anketuarve respektivisht shprehen “disi” ose “shumë” të kënaqur (Shtojca B).

**Tabela 29: Arsimi gjithëpërfshirës vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Arsimi gjithëpërfshirës	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Informacion i ofruar nga Bashkia, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara	325	2.01	489	2.40
Informacion (materialet që ofrohen) nga DAR, institucionet arsimore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara	309	2.37	499	2.37
Kënaqësia në lidhje me shkollimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në përgjithësi (me programin mësimor, cilësinë e mësimin, aftësitë e mësuesve, pajisjet didaktike, etj.)	322	2.61	511	2.42
Kënaqësia me praninë e mësuesit ndihmës në institucionet arsimore	293	2.61	492	2.55
Kënaqësia me punën e komisionit të vlerësimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, pranë DAR dhe institucioneve arsimore	235	2.59	468	2.43
Kënaqësia me Planin Edukativ Individual (PEI) të nxënësve në shkollë (procesi i hartimit, ndjekja, vlerësimi i rezultateve, marrja e mendimit të prindërve, etj.)	250	2.59	452	2.52
Kënaqësia me mundësitë që iu jep shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u integruar me fëmijët e tjerë, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme	333	2.65	484	2.47
Kënaqësia me ofrimin e transportit falas për të shkuar në shkollë, për fëmijët me aftësi të kufizuara	298	1.55	483	1.92

Aktivitetet e lidhur me arsimin gjithëpërfshirës vlerësohen nga përfaqësuesit e organizatave me mesatare që variojnë nga **2.14 – 2.65** (Tabela 30). Në ndryshim nga personat me aftësi të kufizuara, vlerësimi i raportuar nga ky grupim gjatë vitit 2020 është statistikisht më pozitiv lidhur me përbushjen e qëllimit strategjik dhe katër nga tetë aktiviteteve të përfshirë në të.

Kështu, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar nivele më të larta vlerësimi lidhur me informacionin që ofrohet nga Bashkia (**M = 2.36**), cilësinë e shkollimit (**M = 2.35**), praninë e mësuesit ndihmës (**M = 2.64**) dhe ofrimin e transportit falas për të shkuar në shkollë (**M = 2.14**).

Vlerësimet disi më pozitive të raportuara përmes pyetësorit lidhur me këtë qëllim të katërt strategjik në krahasim me fushat e tjera të monitoruara reflektohen dhe në shembujt dhe eksperiencat e ofruara nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave të pyetur rreth arsimit gjithëpërfshirës, sidomos lidhur me ofrimin e mësuesit ndihmës.

Pavarësisht se shumica e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara u shprehën të kënaqur me shërbimet e mësuesit ndihmës, pjesëmarrësit identifikuan dhe nevojën për përmirësime të mëtejshme në këtë drejtim, të cilat lidhen kryesisht me numrin e mësuesve ndihmës, sidomos në zonat rurale, dhe kualifikimet e tyre profesionale.

**Tabela 30: Arsimi gjithëpërfshirës vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Arsimi gjithëpërfshirës	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Kënaqësia me informacionin (materialet që ofrohen) nga Bashkia, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara	49	1.67	56	2.36
Kënaqësia me informacionin (materialet që ofrohen) nga DAR, institucionet arsimore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara	49	2.18	59	2.36
Kënaqësia në lidhje me shkollimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në përgjithësi (me programin mësimor, cilësinë e mësimit, aftësitë e mësuesve, pajisjet didaktike, etj.)	48	1.95	62	2.35
Kënaqësia me praninë e mësuesit ndihmës në institucionet arsimore	49	2.16	61	2.64
Kënaqësia me punën e komisionit të vlerësimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, pranë DAR dhe institucioneve arsimore	44	2.13	56	2.48
Kënaqësia me Planin Edukativ Individual (PEI) të nxënësve në shkollë (procesi i hartimit, ndjekja, vlerësimi i rezultateve, marrja e mendimit të prindërve, etj.)	41	2.26	54	2.65
Kënaqësia me mundësitë që iu jep shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u integruar me fëmijët e tjerë, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme	54	2.20	60	2.55
Kënaqësia me ofrimin e transportit falas për të shkuar në shkollë, për fëmijët me aftësi të kufizuara	43	1.62	56	2.14

*“Në Bashkinë tonë ende nuk është plotësuar numri i nevojshëm i mësuesve ndihmës. Për momentin kemi vetëm 11, ndërkohë që sipas standardeve duhet të kishim 22. Megjithatë, asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk ka mbetur pa mësues ndihmës, të paktën për disa nga ditët e javës. Me ndarjen e re, emërimet për këto pozicione në Berat duhet të bëhen nga Drejtoria Rajonale e Korçës dhe largësia fizike e bën të pamundur që ne të kërkojmë llogari më shpesh.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Kur doja të regjistroja fëmijën në shkollën e lagjes para tre viteve, drejtoresha më tha që nuk kishin mësues ndihmës, ndaj nuk mund të regjistroja fëmijën tim. Bëra ankesë dhe në zyrën e arsimit, por me thanë që do më njoftonin nëse emërohej mësuese për atë shkollë. U detyrova dhe e dërgova fëmijën në shkollën e lagjes në hyrje të qytetit, ku çdo ditë, se ftohtë, se shi, më duhet të eci me fëmijën mbi 30 minuta për të shkuar dhe 30 minuta për t'u kthyer. Por të paktën atje drejtoresha dhe mësuesja ndihmëse sillen shumë mirë me vajzën.” (prindër fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Fëmija im ka mësuese ndihmëse, por ajo e mban vetëm një orë dhe në orën nëntë më duhet ta marr sërish fëmijën nga shkolla. Edhe mësimin ia bën vetëm në një dhomë të veçantë, pra fëmija nuk rri asnjëherë në klasë me nxënësit e tjerë.” (prindër fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Nëpër fshatra ka një mësues ndihmës për tre shkolla. Domethënë që punon vetëm një ose dy ditë në javë me një fëmijë.” (përfaqësues i një organizate)*

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e organizatave identifikuan dhe mangësi lidhur me vështirësitë e hasura prej tyre për regjistrimin e fëmijëve në institucione të arsimit parashkollor dhe mungesat e specialistëve në shkollat speciale. Gjithashtu, pjesëmarrësit referuan vështirësi të shumta lidhur me aksesueshmërinë fizike në shkolla dhe mundësitë e transportit drejt këtyre shërbimeve, sidomos për fëmijët e zonave rurale.

*“Këtë vit doja ta regjistroja fëmijën në kopësht. Drejtoresha më tha që nuk mund ta regjistronte se së shpejti do të shpërngulen sepse do rikonstruktohet ndërtesa. U thashë që kur dhe ku të lëvizin fëmijët e tjerë, atje do shkojë dhe fëmija im.” (prindër fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Në shkollën speciale mungon logopedi dhe pjesa tjetër e stafit ka nevojë për trajnime.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Në shkollën speciale ka pasur një makinë të falur nga një fondacion anglez në mes të viteve 90. Për rreth 10 vjetë ajo shërbeu për të transportuar fëmijët në shkollë, sidomos ata nga fshatrat përreth Korçës. Më pas, bazuar në një vendim qeverie mbi kufizimin e makinave zyrtare, e bllokuan dhe atë. Vazhdon të jetë ende aty.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Shumica e shkollave nuk kanë rampa. Kanë vetëm dy shkollat e reja që u rikonstruktuan. Por dhe atje ku ka, ato mundësojnë të hysh vetëm nga oborri në katin e parë, por nuk kanë menduar që për të hyrë fillimisht në oborrin e shkollës duhet të ngjitësh katër shkallë.” (prindër fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Në qytetin tonë nuk ka shërbim urban, por fëmijët me aftësi të kufizuara nga fshatrat përreth duhet të marrin çdo ditë furgonin për të ardhur në shkollë. Kjo është kohë dhe kosto shtesë dhe për prindërit që duhet t'i shoqërojnë dy herë në ditë.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

## 3.5. Kujdesi shoqëror

Përmirësimi i cilësisë së jetës nëpërmjet shërbimeve sociale përbën qëllimin e pestë strategjik<sup>18</sup> të PKVPAK dhe përbëhet nga tre objektiva, përkatësisht: përmirësimi i vlerësimit të aftësisë të kufizuara me anë të kalimit nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social<sup>19</sup>; ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (cash) me kujdesin social cilësor<sup>20</sup> dhe nxitja e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale komunitare<sup>21</sup>. Të tre objektivat janë parashikuar të përmbushen përmes realizimit të nëntë aktiviteteve.

Në lidhje me këtë qëllimin strategjik, pjesëmarrësit në studim gjatë vitit 2020 raportojnë përmbushjen e tij në nivel “pak” të kënaqshëm, duke e vlerësuar me një mesatare **2.06** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre (Tabela 31) dhe **2.08** nga përfaqësuesit e organizatave (Tabela 32).

18. Qëllimi strategjik nr. 5: “Të përmirësohet cilësia e jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/ përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht, të fokusuara te klienti dhe sa më pranë tij në komunitet”

19. Objektivi nr. 5.1: “Përmirësimi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar me anë të kalimit nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social”

20. Objektivi nr. 5.2: “Ofrimi i shërbimeve sociale të integruara me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë dhe kujdesit social cilësor”

21. Objektivi nr. 5.3: “Nxitja e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet”

**Tabela 31: Vlerësimi i përmirësimit të cilësisë së jetës nëpërmjet shërbimeve shoqërore nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Kujdesi Shoqëror</b>	<b>484</b>	<b>1.82</b>	<b>529</b>	<b>2.06</b>
Vlerësimi nga modeli mjekësor në bio-psiko-social	472	2.31	520	2.55
Shërbime sociale të integruara	479	1.66	529	2.05
Deinstitutionalizimi	438	1.48	509	1.71

**Tabela 32: Vlerësimi i përmirësimit të cilësisë së jetës nëpërmjet shërbimeve shoqërore nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Kujdesi Shoqëror</b>	<b>58</b>	<b>1.86</b>	<b>64</b>	<b>2.08</b>
Vlerësimi nga modeli social në bio-psiko-social	54	2.16	56	2.37
Shërbime sociale të integruara	58	1.93	64	2.17
Deinstitutionalizimi	50	1.35	59	1.72

Të dhënat e mësipërme tregojnë një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë, e cila lidhet me ndryshime pozitive të identifikuara në të tre objektivat përbërës të këtij qëllimi. Ndërkohë, përfaqësuesit e organizatave nuk kanë raportuar asnjë ndryshim statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin mesatar të qëllimit dhe objektiveve të tij nga viti në vit.

Ndryshimet e nisura në procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke kaluar nga modeli mjekësor në atë bio-psiko-social, përbëjnë dhe objektivin e vlerësuar më pozitivisht nën këtë qëllim edhe gjatë vitit 2020, duke u raportuar me një mesatare **2.55** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.37** nga përfaqësuesit e organizatave.

Objektivi lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale të integruara është vlerësuar si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, duke u raportuar gjatë vitit 2020 me mesatare **2.05** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.17** nga përfaqësuesit e organizatave.

Ndërkohë, objektivi i vlerësuar në nivel më pak të kënaqshëm brenda këtij qëllimi strategjik nga të dy grupimet e kampionit për të dytin vit radhazi është ai i lidhur me nxitjen e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet. Ky objektivi është vlerësuar me një mesatare **1.71** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **1.72** nga përfaqësuesit e organizatave.

Më poshtë përmbledhen vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave lidhur me secilin nga aktivitetet e përfshirë në studim për të tre objektivat kryesore të lidhur me kujdesin shoqëror.

### 3.5.1. Vlerësimi i aktiviteteve për përmirësimin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar me anë të kalimit nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social

Ndryshimet pozitive të raportuara nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në vlerësimin e këtij objekti reflektohen nga ndryshimet statistikisht pozitive lidhur me të dy aktivitetet e raportuara gjatë vitit 2020 nga pjesëmarrësit krahasuar me vitin e mëparshëm.

Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në kampionin e vitit 2020 kanë raportuar se janë “disi” ose “shumë” të kënaqur me njohuritë e stafit (**60.9%**) dhe procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (**55.2%**) (Shtojca B), duke i vlerësuar me mesatare **2.60** dhe **2.50** respektivisht (Tabela 33).

**Tabela 33: Vlerësimi nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Vlerësimi i modelit bio-psiko-social	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Kënaqësia me njohuritë e stafit të institucioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar (arsimit, punësimit, administratorët socialë)	458	2.26	514	2.60
Kënaqësia me procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (procedurat e përfitimit, trajtimi gjatë intervistës, etj.)	464	2.38	513	2.50

Edhe përfaqësuesit e organizatave raportojnë nivele të kënaqshme të përmbushjes së këtij objekti, duke qenë se pothuajse gjysma e tyre në kampionin e vitit 2020 kanë raportuar se janë “disi” ose “shumë” të kënaqur me njohuritë e stafit (**46%**) dhe procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (**50%**) (Shtojca B), duke i vlerësuar të dy këto aktivitete me mesatare **2.40** (Tabela 34).

**Tabela 34: Vlerësimi nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Vlerësimi i modelit bio-psiko-social	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Kënaqësia me njohuritë e stafit të institucioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar (arsimit, punësimit, administratorët socialë)	51	2.17	50	2.40
Kënaqësia me procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (procedurat e përfitimit, trajtimi gjatë intervistës, etj.)	50	2.10	52	2.40

### 3.5.2. Vlerësimi i aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (cash) me kujdesin social cilësor

Aktivitetet e lidhur me cilësinë e shërbimeve sociale të integruara vlerësohen nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 me mesatare që variojnë nga **1.69 – 2.37** (Tabela 35).

Në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e objektivit të parë, dhe për objektivin e dytë, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme për të katërt aktivitetet e përfshira.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve pozitive krahasuar me vitin e mëparshëm, edhe në rezultatet e vitit 2020 vërehen ndryshime në nivelin e raportuar të kënaqësisë mes të katër aktiviteteve, ku shërbimet e marra nga shërbimet sociale (**M = 2.37**) dhe informacionet e ofruara prej tyre (**M = 2.21**) vlerësohen më të kënaqshme se masa e pagesës cash (**M = 1.69**) dhe ofrimi i paketave higjienike dhe sanitare për personat me aftësi të kufizuara (**M = 1.95**).

Lidhur me dy aktivitetet e fundit, siç tregojnë dhe të dhënat në Shtojcën B të këtij raporti, më shumë se 3 në 4 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me masën e pagesës cash (**83.4%**) dhe paketat higjienike dhe sanitare (**80%**).

**Tabela 35: Vlerësimi i shërbimeve sociale të integruara nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Shërbime sociale të integruara	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara që janë ngritur në zonën tuaj (qendra ditore, qendra rezidenciale, qendra këshillimi psiko-social dhe terapi të ndryshme)	367	1.92	512	2.37
Niveli i kënaqësisë me njohuritë dhe informacionin e ofruar nga stafi i shërbimeve sociale	404	1.93	500	2.21
Niveli i kënaqësisë me masën e pagesës së aftësisë së kufizuara (a i mbulon ajo nevojat e një individi me aftësi të kufizuara)	468	1.57	524	1.69
Niveli i kënaqësisë me ofrimin e mjeteve higjienike dhe sanitare për personat me aftësi të kufizuara	362	1.50	515	1.95

Të njëjtat diferenca në nivelin e kënaqësisë të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre në përmbushjen e aktiviteteve të ndryshme të këtij objekti raportohen dhe nga përfaqësuesit e organizatave, të cilat gjatë vitit të dytë të monitorimit janë vlerësuar me mesatare që variojnë nga **1.76 në 2.41** (Tabela 36).

I vetmi ndryshim pozitiv statistikisht i rëndësishëm mes vlerësimeve të mbledhura në vitin 2020 krahasuar me vitin paraardhës lidhen me nivelin e raportuar të kënaqësisë me njohuritë dhe informacionin e ofruar nga stafi i shërbimeve sociale (**M = 2.41**).

Në mënyrë të ngjashme më nëngrupin tjetër të kampionit të vitit 2020, më shumë se 3 në 4 përfaqësues të organizatave raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me masën e pagesës cash (**82.8%**) dhe paketat higjienike dhe sanitare (**84%**) (Shtojca B).

**Tabela 36: Vlerësimi i shërbimeve sociale të integruara nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Shërbime sociale të integruara	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara që janë ngritur në zonën tuaj (qendra ditore, qendra rezidenciale, qendra këshillimi psiko-social dhe terapi të ndryshme)	49	2.24	61	2.41
Niveli i kënaqësisë me njohuritë dhe informacionin e ofruar nga stafi i shërbimeve sociale	52	2.05	59	2.41
Niveli i kënaqësisë me masën e pagesës së aftësisë së kufizuar (a i mbulon ajo nevojat e një individi me aftësi të kufizuara)	55	1.69	58	1.88
Niveli i kënaqësisë me ofrimin e mjeteve higjienike dhe sanitare për personat me aftësi të kufizuara	48	1.64	50	1.76

### 3.5.3. Vlerësimi i aktiviteteve për nxitjen e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet

Ashtu siç u theksua dhe në fillim të këtij seksioni, edhe gjatë vitit 2020, aktivitetet e lidhur me nxitjen e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet janë vlerësuar më pak të kënaqshme nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në krahasim me objektivat e tjerë nën të njëjtin qëllim, me mesatare që variojnë nga **1.64 – 1.81** (Tabela 37).

Pavarësisht se gjatë vitit 2020 janë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme për të tre aktivitetet e përfshira në këtë objektiv krahasuar me vitin e mëparshëm, më shumë se 3 në 4 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me shërbimet që mbështesin jetesën e pavarur (**85.5%**), grantet për strehimin social (**76.9%**) dhe aplikimin e tarifave favorizuese për legalizimin e banesave e mjediseve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara (**82.2%**) (Shtojca B).

**Tabela 37: Vlerësimi i deinstitutionalizimit nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Deinstitutionalizimi	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me shërbimet që mbështesin jetesën e pavarur për persona me aftësi të kufizuara në moshë madhore	416	1.48	503	1.66
Niveli i kënaqësisë me grantet (ndihmën financiare) për strehimin social të dhënë për persona me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj	320	1.63	473	1.81
Niveli i kënaqësisë me aplikimin/dhënien e tarifave favorizuese për legalizimin e banesave/mjediseve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara	240	1.41	462	1.64

Vlerësime të ngjashme me ato të personave me aftësi të kufizuara kanë raportuar dhe përfaqësuesit e organizatave në vitin 2020, me mesatare që variojnë nga **1.62 në 1.73**, dhe me ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme në dy nga tre aktivitetet e këtij objektivi krahasuar me vitin e mëparshëm (Tabela 38). Edhe në këtë objektiv, më shumë se 3 në 4 përfaqësues të organizatave mbështesin nivelin e pakënaqësisë së raportuar nga grupimi i parë

lidhur me shërbimet që mbështesin jetesën e pavarur (**87.8%**), grantet për strehimin social (**80.4%**) dhe aplikimin e tarifave favorizuese për legalizimin e banesave e mjediseve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara (**82%**) (Shtojca B).

**Tabela 38: Vlerësimi i deinstitutionalizimit nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Deinstitutionalizimi	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me shërbimet që mbështesin jetesën e pavarur për persona me aftësi të kufizuara në moshë madhore	47	1.31	57	1.68
Niveli i kënaqësisë me grantet (ndihmën financiare) për strehimin social të dhënë për persona me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj	40	1.37	51	1.73
Niveli i kënaqësisë me aplikimin/dhënien e tarifave favorizuese për legalizimin e banesave/mjediseve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara	33	1.42	47	1.62

Lidhur me cilësinë e shërbimeve sociale të integruara, pjesëmarrësit në anketim dhe grupet e diskutimit u kërkuan të ndanin eksperiencat dhe sfidat e tyre lidhur me aktivitetet e parashikuar për të tre objektivat e këtij qëllimi të parashikuar në PKVPAK.

Lidhur me procesin e ri të vlerësimit, shumica e të intervistuarve në katër bashkitë e përfshira në monitorim nuk kishin informacionin e mjaftueshëm lidhur me kriteret që do të përfshihen në vlerësimin bio-psiko-social, si dhe afatet kohore kur ky vlerësim do të fillojë të zbatohet në të gjithë territorin e vendit. Megjithatë, procedurat aktuale të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe aftësisë për punë raportohen shpeshherë se janë të vështira, kushtueshme dhe evasive, duke sjellë dhe diferenca të padrejta në përfitimet dhe mbështetjen që u ofrohet kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Sfidat e mësipërme vlerësohen se u përkeqësuan dhe nga situata e emergjencës dhe kufizimit të lëvizjes si rrjedhojë e pandemisë.

*“Shpesh ka vonesa në procesin e rivlerësimit, të cilat sjellin që personat (me aftësi të kufizuara) të humbin pagesat e dy ose tre muajve. Këtë vit, vonesat duket se do jenë dhe më të gjata, për shkak të radhës së gjatë që është krijuar nga karantina. I kemi kërkuar Bashkisë që të mos i ndërpresë pagesat, por përgjigjen që fajin e kanë vetë personat, se kujtohen për të përgatitur dokumentet e rivlerësimit vetëm kur po vjen fundi. Unë mendoj se kjo duhet të jetë një nga përgjegjësitë kryesore të administratorëve – të mbajnë një regjistër dhe t’i kujtojnë dhe ndihmojnë personat në këtë proces.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Këtu nuk ka asnjë psikiatër fëmijësh, ndaj për vlerësimin, sidomos atë fillestar, duhet të kalojmë disa ditë në Tiranë. Përveç udhëtimit dhe kostove, mendoni sa e vështirë është të sorollatesh nëpër spitale që nuk njeh me një fëmijë me aftësi të kufizuara.” (prindër fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Kam shumë muaj që përpiqem të vendos një rivlerësim për vjehrrën, duke qenë se situata e saj është rënduar ndjeshëm dhe mendoj se i takon kategori tjetër. Megjithatë, as këtu dhe as në Tiranë nuk më kanë dhënë përgjigje të sakta se çfarë duhet të bëj dhe cilat dokumente duhet të plotësoj.” (familjar personi me aftësi të kufizuar)*

*“Herën e fundit më thanë që dokumentet për rivlerësimin duhen plotësuar çdo gjashtë muaj ‘online’. Këtë herë, pagova 2,000 lekë të qendra e internetit dhe më ndihmoi ai djali. Vetë nuk do mund ta plotësoja.” (person me aftësi të kufizuara)*

Lidhur me vlerësimin mbi shërbimet shoqërore të ofruara pranë zonave të banimit, pjesëmarrësit në studim identifikuan sfida të shumta, kryesisht të lidhura me mungesën e qendrave ditore dhe rezidenciale për grupe të ndryshme, aksesin në shërbimet e pakta ekzistuese, si dhe mungesën e mjeteve didaktike dhe specialistëve.

*“Në bashkinë tonë ka vetëm një qendër ditore për fëmijë dhe të rinj, por asnjë shërbim për personat e rritur ose moshuar me aftësi të kufizuara. Nuk ka as ndonjë qendër rezidenciale që personat me aftësi të kufizuara të mos jetojnë vetëm.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Në qendrën ditore përballemi me vështirësi. Nuk kemi logoped dhe as mjek. Mjeku nuk ka nevojë të qëndrojë gjatë të gjithë kohës, por është e rëndësishme të kesh një konsultë lidhur me nevojat e fëmijës, jo vetëm nga ana sociale dhe psikologjike, por dhe ajo shëndetësore. Dhe në ato pak raste kur i kemi kërkuar mjekut të familjes dosjen ose konsultë na kanë thënë që janë informacione sekrete.” (punonjës i qendrës ditore)*

*“Në qendrën ditore ka mangësi me mjete didaktike. Gjithashtu, nuk pranohen fëmijë të cilët kanë vështirësi në lëvizje, dëgjim ose shikim. Edhe transport nuk është ofruar asnjëherë për fëmijët që banojnë brenda ose jashtë qytetit. Vetëm për fëmijët e një grupi fshatrash në jug të qytetit, transporti është ofruar tre vitet e fundit nga fabrika e çimentos.” (familjar personi me aftësi të kufizuara)*

Gjithashtu, të pyetur rreth kënaqësisë me masën e pagesës në cash dhe bonuset për strehim ose qera të ofruara nga pushteti vendor, pjesëmarrësit theksuan nevojën për ndryshimin e sistemit aktual të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përcaktimit të mbështetjes, si dhe priorizimin e familjeve me aftësi të kufizuara nga ana e pushtetit vendor në uljen e taksave dhe ofrimin e mundësive për strehim social të përshtatur.

*“Gjatë procesit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara, duhet të përfshijnë dhe dëgjojnë gjithmonë edhe prindin ose familjarin. Ata i dinë problematikat dhe vështirësitë sociale me të cilat përballen. Pagesa cash dhe kujdestaria mund të përcaktohet vetëm nga diagnoza.” (familjar personi me aftësi të kufizuara)*

*“Thonë që vlerësimi i ri do përcaktojë shërbimet që duhet të ndjekësh dhe më pas pagesën. Unë jam dakord me pjesën e parë, por përpara duhet të sigurohen që qendrat ditore dhe rehabilituese të jenë në nivelin e duhur. Pavarësisht nëse unë vendos ta dërgojë ose jo fëmijën në këto qendra, pagesa nuk duhet të ulet. Fëmija sërish ka nevojë për ushqim dhe shërbime që pagesa aktuale nuk arrin t'i mbulojë.” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Nuk kemi shumë informacion lidhur me shpërndarjen e banesave sociale. Këtu në Berat njohim tre persona me aftësi të kufizuara që u kanë dhënë apartamente tek blloku i pallateve sociale. Fillimisht ua dhanë në kate të ndryshme, por duke qenë se nuk kishin ashensor, nuk ishin të aksesueshme. Më pas i lëvizën në katin e parë të banimit, por u dhanë garsoniere, pavarësisht madhësisë së familjes, se ato kishin në atë kat.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues i një organizate)*

*“Duke qenë se shtëpia ku banoj nuk është në emrin tim, bashkia nuk më njeh uljen e taksave të pastrimit ose favorizime të tjera.” (person me aftësi të kufizuara)*

## 3.6. Kujdesi shëndetësor

Sigurimi i kujdesit shëndetësor të aksesueshëm, të përbalueshëm dhe të barabartë për personat me aftësi të kufizuara përbën objektivin e gjashtë strategjik<sup>22</sup> të PKVPAK, i cili është vlerësuar në këtë monitorim përmes përbushjes së 14 aktiviteteve lidhur me dy objektivat në vijim: (1) forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara<sup>23</sup> dhe (2) zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, integritimit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara<sup>24</sup>.

Të dhënat në Tabelën 39 dhe në Tabelën 40 paraqesin vlerësimin e përgjithshëm të qëllimit të gjashtë strategjik dhe objektivave përkatëse nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të organizatave gjatë vitit 2019 dhe 2020. Rezultatet në këtë vlerësim paraqiten me mesatare ku 1 është vlera më e vogël (aspak i/e kënaqur) dhe 4 vlera më e madhe (shumë i/e kënaqur).

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre raportojnë “nivel të ulët kënaqësie” lidhur me sigurimin e kujdesit shëndetësor të aksesueshëm, të përbalueshëm dhe të barabartë vlerësuar me mesatare **1.94** (Tabela 39). Duke e vlerësuar përbushjen e këtij objekti me të njëjtin nivel kënaqësie, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar mesatare **2.07** (Tabela 40).

**Tabela 39: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me kujdesin shëndetësor të aksesueshëm dhe të barabartë nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Kujdesi Shëndetësor</b>	<b>479</b>	<b>1.80</b>	<b>535</b>	<b>1.94</b>
Kapacitetet njerëzore dhe teknike për shërbimet shëndetësore	478	1.73	535	1.88
Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi i fëmijëve dhe të rriturve me AK	469	1.80	522	1.94

**Tabela 40: Vlerësimi i qëllimit strategjik dhe objektivave lidhur me kujdesin shëndetësor të aksesueshëm dhe të barabartë nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Kujdesi Shëndetësor</b>	<b>57</b>	<b>1.75</b>	<b>61</b>	<b>2.07</b>
Kapacitetet njerëzore dhe teknike për shërbimet shëndetësore	57	1.70	58	2.01
Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi i fëmijëve dhe të rriturve me AK	53	1.77	60	2.05

22. Qëllimi strategjik nr. 6: “Të sigurohet një kujdes shëndetësor i aksesueshëm, i përbalueshëm dhe i barabartë për personat me aftësi të kufizuara”

23. Objekti nr. 6.1: “Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara”

24. Objekti nr. 6.2: “Zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, integritimit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara”

Të dhënat e mësipërme tregojnë një ndryshim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik raportuar nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë bazuar në ndryshimet pozitive në të dy objektivat e këtij qëllimi strategjik.

Objektivi i parë lidhur me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara është vlerësuar edhe gjatë vitit 2020 si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, pavarësisht ndryshimeve pozitive të identifikuara, duke u raportuar me mesatare **1.88** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.01** nga përfaqësuesit e organizatave.

Objektivi i dytë lidhur me zhvillimin e shërbimeve të parandalimit, integritit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara është vlerësuar gjithashtu si “pak i kënaqshëm” nga të dy grupimet, duke u raportuar me mesatare **1.96** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.05** nga përfaqësuesit e organizatave.

Më poshtë përmbledhen vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave lidhur me secilin nga aktivitetet e përfshirë në studim për të dy objektivat kryesorë të lidhur me sigurimin e kujdesit shëndetësor të aksesueshëm, të përballeshëm dhe të barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

### **3.6.1. Vlerësimi i aktiviteteve mbi forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara**

Aktivitetet e lidhur me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara është vlerësuar edhe gjatë vitit 2020 si “pak i kënaqshëm” me mesatare që variojnë nga **1.53 – 2.34** (Tabela 41).

Ndryshimet pozitive të raportuara nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në vlerësimin e këtij objektivi reflektohen nga ndryshimet statistikisht pozitive lidhur me të pestë aktivitetet e përfshira të raportuara gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin e mëparshëm.

Megjithatë, dhe brenda aktiviteteve të këtij objektivi raportohen vlerësime të ndryshme, ku shërbimet e përgjithshme shëndetësore janë vlerësuar më pozitivisht në krahasim me ato të ofruar nga shërbimi stomatologjik. Kështu, rreth gjysma e pjesëmarrësve në kampionin e vitit 2020 kanë raportuar se janë “aspak” të kënaqur me ofrimin e shërbimit dentar falas në zonën e banimit (**48.2%**) dhe në shkolla (**61.9%**) (Shtojca B).

Në mënyrë të ngjashme me personat me aftësi të kufizuara, edhe përfaqësuesit e organizatave raportojnë një nivel të ulët kënaqësie me përmbushjen e aktiviteteve të këtij objektivi, me mesatare që variojnë nga **1.76 në 2.52** (Tabela 42).

Krahasuar me vlerësimet e ofruara gjatë vitit 2019, gjatë vitit 2020 përfaqësuesit e organizatave raportojnë ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme lidhur me tre nga pesë aktivitetet e këtij objektivi që lidhen me shërbimin e ofruar nga institucionet shëndetësore (**M = 2.52**), ofrimin e shërbimit dentar falas në zonën e banimit (**M = 1.82**) dhe trajnimin e dentistëve për të ofruar shërbim dentar të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara (**M = 1.92**).

Pavarësisht këtyre ndryshimeve pozitive në disa nga aktivitetet, përqindja e të anketuarve që janë “disi” ose “shumë” të kënaqur lidhur me përmbushjen e këtyre aktiviteteve mbetet e ulët, sidomos lidhur me ofrimin e shërbimit dentar falas në zonën e banimit (**20.4%**) dhe në shkolla (**13.8%**) (Shorjca B).

**Tabela 41: Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me shërbimin për personat me aftësi të kufizuara në institucionet shëndetësore	455	2.13	526	2.34
Niveli i kënaqësisë me shërbimin shëndetësor në banesë (kur personi me aftësi të kufizuara e ka të pamundur të lëvizë drejt institucioneve shëndetësore)	426	1.90	517	2.01
Niveli i kënaqësisë me ofrimin e shërbimit dentar falas për personat me aftësi të kufizuara në zonën ku banoni	427	1.32	496	1.62
Niveli i kënaqësisë me ofrimin e shërbimit dentar falas në shkolla, për fëmijë me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ata fëmijë që nuk janë regjistruar në shkollë	336	1.37	480	1.53
Dentistët të trajnuar për të ofruar shërbim dentar për personat me aftësi të kufizuara	197	1.45	423	1.81

**Tabela 42: Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimeve shëndetësore	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me shërbimin për personat me aftësi të kufizuara në institucionet shëndetësore	54	2.00	54	2.52
Niveli i kënaqësisë me shërbimin shëndetësor në banesë (kur personi me aftësi të kufizuara e ka të pamundur të lëvizë drejt institucioneve shëndetësore)	48	1.72	50	2.00
Niveli i kënaqësisë me ofrimin e shërbimit dentar falas për personat me aftësi të kufizuara në zonën ku banoni	46	1.26	49	1.82
Niveli i kënaqësisë me ofrimin e shërbimit dentar falas në shkolla, për fëmijë me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ata fëmijë që nuk janë regjistruar në shkollë	44	1.56	51	1.76
Dentistët të trajnuar për të ofruar shërbim dentar për personat me aftësi të kufizuara	30	1.40	38	1.92

### 3.6.2. Vlerësimi i aktiviteteve për zhvillimin e shërbimeve të parandalimit, integritit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara

Aktivitetet e lidhur me zhvillimin e shërbimeve të parandalimit, integritit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara janë vlerësuar edhe gjatë vitit 2020 si “pak i kënaqshëm” nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, me mesatare që variojnë nga **1.87 – 2.14** (Tabela 43).

Pavarësisht se në nivel objektiv është raportuar një ndryshim pozitiv, rezultatet e vitit 2020 tregojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme në gjashtë nga nëntë aktivitetet e vlerësuar. Megjithatë, këto ndryshime janë vlerësuar pozitive krahasuar me një vit më parë vetëm për pesë aktivitete, lidhur me ofrimin e trajtimit të specializuar (**M = 1.95**) dhe shërbimeve riaftësuese (**M = 1.93**), informacionin e dhënë nga institucionet publike për shërbime shëndetësore (**M = 2.14**), informacionin që ofrohet në lidhje me sëmundje të ndryshme që mund të shkaktojnë aftësi të kufizuara (**M = 2.04**) dhe rimbursimin e shpenzimeve për pajisje ndihmëse (**M = 1.88**).

Në të kundërt, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre kanë raportuar përkeqësim të situatës lidhur me diagnostikimin e aftësisë së kufizuar (**M = 2.06**) krahasuar me një vit më parë (**M = 2.33**), ku rreth tre në katër të intervistuar (**73.1%**) raportojnë se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur me këtë proces (Shtojca B). Pavarësisht se vlerësimet lidhur me parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk kanë shënuar ndryshime lidhur me vitin e mëparshëm, këto dy aktivitete vijnë të raportohen në nivel të pakënaqshëm dhe gjatë vitit 2020, me respektivisht **78.7%** dhe **81.5%** që përgjigjen se janë “aspak” ose “pak” të kënaqur.

**Tabela 43: Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Vlerësimi mbi masat e duhura (informim, këshillim për stilin e jetës, mënyrën e të ushqyerit etj.) për të parandaluar aftësitë e kufizuara	319	1.84	485	1.88
Vlerësimi mbi angazhimin (sa punë bëhet) për zbulimin dhe trajtimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara	316	1.99	477	1.92
Niveli i kënaqësisë për diagnostikimin e aftësisë së kufizuar	408	2.33	487	2.06
Niveli i kënaqësisë për trajtimin e specializuar që iu ofrohet personave me aftësi të kufizuara	367	1.82	481	1.95
Niveli i kënaqësisë me shërbimet riaftësuese (fizioterapi, logoterapi, terapi e të folurit, etj.)	340	1.46	493	1.93
Niveli i kënaqësisë me informacionin e dhënë nga institucionet publike për shërbime shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara	420	1.94	495	2.14
Niveli i kënaqësisë me informacionin që ofrohet në lidhje me sëmundje të ndryshme që mund të shkaktojnë aftësi të kufizuara, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe atij të aftësisë së kufizuar	246	1.87	470	2.04
Niveli i kënaqësisë me fushatat e ndërmarra në zonën tuaj për të ofruar informacion shëndetësor për persona që nuk flasin e nuk dëgjojnë	288	1.78	471	1.87
Niveli i kënaqësisë për rimbursimin e shpenzimeve për karrige me rrota, orteza, proteza, aparate dëgjimi apo pajisje të tjera të teknologjisë ndihmëse	397	1.61	475	1.88

Aktivitetet e lidhur me këtë objektiv janë vlerësuar gjatë vitit 2020 si “pak i kënaqshëm” edhe nga përfaqësuesit e organizatave, me mesatare që variojnë nga **2.00 – 2.26** (Tabela 44).

Ndryshimet pozitive statistikisht të rëndësishme mes dy viteve të monitorimit raportohen nga pjesëmarrësit për pesë nga nëntë aktivitetet e vlerësuar, që përfshijnë masat parandaluese (**M = 2.02**), ofrimin e trajtimit të specializuar (**M = 2.26**), informacionin e dhënë nga institucionet publike për shërbime shëndetësore (**M = 2.10**), fushatat e ndërmarra në zonën tuaj për të ofruar informacion shëndetësor për persona që nuk flasin e nuk dëgjojnë (**M = 2.02**) dhe rimbursimin e shpenzimeve për pajisje ndihmëse (**M = 2.00**).

**Tabela 44: Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Parandalimi, integrimi dhe rehabilitimi	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Vlerësimi mbi masat e duhura (informim, këshillim për stilin e jetës, mënyrën e të ushqyerit etj.) për të parandaluar aftësitë e kufizuara	44	1.61	53	2.02
Vlerësimi mbi angazhimin (sa punë bëhet) për zbulimin dhe trajtimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara	42	1.83	51	2.00
Niveli i kënaqësisë për diagnostikimin e aftësisë së kufizuar	48	2.08	53	2.08
Niveli i kënaqësisë për trajtimin e specializuar që iu ofrohet personave me aftësi të kufizuara	45	1.68	53	2.26
Niveli i kënaqësisë me shërbimet riaftësuese (fizioterapi, logoterapi, terapi e të folurit, etj.)	49	1.93	56	2.16
Niveli i kënaqësisë me informacionin e dhënë nga institucionet publike për shërbime shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara	47	1.59	51	2.10
Niveli i kënaqësisë me informacionin që ofrohet në lidhje me sëmundje të ndryshme që mund të shkaktojnë aftësi të kufizuara, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe atij të aftësisë së kufizuar	43	1.69	55	2.02
Niveli i kënaqësisë me fushatat e ndërmarra në zonën tuaj për të ofruar informacion shëndetësor për persona që nuk flasin e nuk dëgjojnë	36	1.27	55	2.02
Niveli i kënaqësisë për rimbursimin e shpenzimeve për karrige me rrota, orteza, proteza, aparate dëgjimi apo pajisje të tjera të teknologjisë ndihmëse	45	1.37	51	2.00

Më poshtë janë përmbledhur disa nga eksperiencat dhe problematikat kryesore të referuara nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave mbi dy objektivat kryesorë të parashikuar në PKVPAK mbi shërbimet shëndetësore.

Të pyetur lidhur me vlerësimin e tyre mbi kapacitetet njerëzore dhe teknike në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe nismat e marra për parandalimin, integrimin dhe rehabilitimin për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, pjesëmarrësit në diskutimet në grup kanë vlerësuar pozitivisht rolin e përfshirjes së disa profesioneve të reja brenda shërbimeve shëndetësore, si dhe nismat e marra kryesisht nga organizata të shoqërisë civile dhe pushteti lokal për ofrimin e disa shërbimeve riaftësuese në komunitet. Megjithatë, edhe në këtë drejtim rekomandimet për përmirësime të mëtejshme nuk mungojnë, kryesisht lidhur me rritjen e numrit të profesionistëve që ofrojnë shërbime të specializuara në shërbimet shëndetësore

*“Në bashkinë tonë për momentin funksionon një njësi lëvizëse me logopedistë dhe fizioterapistë që ofrojnë shërbime në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara. Deri më tani, shërbimi është mbështetur 80 për qind nga grante dhe 20 për qind nga Bashkia. Duhet të presim muajin tjetër për të parë nëse do të ketë dhe një vit të dytë të këtij shërbimi, ose nëse bashkia do të mund të rrisë buxhetin e saj në këtë drejtim.” (përfaqësues i një organizate)*

*“Në të gjithë Dibrën nuk ka asnjë mjek psikiatër, ndaj të gjithë fëmijët dhe të rriturit që kanë nevojë për këtë shërbim duhet të shkojnë të vizitohen ose në Shkodër ose në Tiranë” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Mjekët, sidomos ata të familjes, nuk kanë informacionin e duhur lidhur me shumë nga problematikat shëndetësore që mund të shfaqen bashkë me aftësinë e kufizuar. Duhet t’ua shpjegoj vetë që si paraplegjik, djali ka më shumë mundësi të zhvillojë sëmundje në veshka a prostatë, ndaj duhet të bëjë kontrolle të herëpashershme.” (prind personi me aftësi të kufizuara)*

*“Fëmija im ka nevojë për logoped, por nuk ka asnjë të tillë që të ofrohet në shërbimet publike. Nëse dua të ndihmoj fëmijën tim, më duhet ta dërgoj në një specialist në klinikë private, ku çdo seancë kushton 10,000 lek (të vjetra).” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Në qendrën ditore është hapur disa herë pozicioni për logoped, por nuk ka pasur aplikime. Profesionistët e rinj ndoshta nuk duan të punojnë në qytetet e vogla ose në institucionet publike.” (profesionist në qendrën ditore)*

publike, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore ekzistuese, si dhe shkëmbimin më të mirë të informacionit mes shërbimeve të ndryshme.

Problematikat më të shumta u raportuan nga pjesëmarrësit në studim lidhur me aftësitë e sistemit shëndetësor për të parandaluar dhe identifikuar në mënyrë të hershme aftësinë e kufizuar, si dhe përmbushjen e nevojave me mjete ndihmëse si karrige me rrota, orteza, proteza, aparate dëgjimi apo pajisje të tjera të teknologjisë.

*“Për sa vite kam që punoj me aftësinë e kufizuar, si nënë dhe mësuese, nuk mbaj mend asnjë rast të vetëm fëmije me aftësi të kufizuar që të jetë identifikuar dhe referuar në shërbime nga konsultorja. Ata e kanë për detyrë që të bëjnë të gjitha vlerësimet e nevojshme për çdo aspekt të zhvillimit të fëmijës, por as fëmijës tim nuk ia kanë bërë. Pse kjo pjesë (vlerësimi) u duket më pak e rëndësishme sesa vaksinat, për të cilat ndjekin çdo familje nga pas.” (familjar personi me aftësi të kufizuara, përfaqësues organizate)*

*“Si persona që nuk shohim të kategorisë së dytë, ne duhet të ndërrojmë syzet të paktën çdo vit, për të mbrojtur shikimin e mbetur, por asnjë nga shpenzimet për pikat (ilaç për sytë) ose syzet nuk na rimburohet. Kështu që tani po bëhen tre vjet pa i ndërruar, se një palë të tilla kushtojnë rreth 500 mijë lek (të vjetra).” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues organizate)*

*“Vajza ime ka nevojë për një aparat dëgjimi, por deri tani nuk kam arritur t’ia siguroj. Ndoshta dhe nuk njoh organizata a shoqata që ndoshta merren me këtë punë. ... Bile nesër do shkoj për vizitën e radhës në Tiranë dhe kur fola sot me mjekun më tha që ezhetë tani i kanë kaluar privatit. Unë nuk mund t’i mbuloj vetë të gjitha këto kosto.” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

## 3.7. Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike përbën qëllimin e shtatë strategjik<sup>25</sup> të PKVPAK dhe përbëhet nga tre objektiva që synojnë: mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje<sup>26</sup>; promovimin e punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike<sup>27</sup> dhe dhënien e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive<sup>28</sup>. Të tre objektivat janë parashikuar të përmbushen përmes realizimit të shtatë aktiviteteve.

Në lidhje me këtë qëllimin strategjik, pjesëmarrësit në studim gjatë vitit 2020 raportojnë përmbushjen e tij në nivel “pak” të kënaqshëm, duke e vlerësuar me një mesatare **1.89** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre (Tabela 45) dhe **1.92** nga përfaqësuesit e organizatave (Tabela 46).

**Tabela 45: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike</b>	<b>463</b>	<b>1.80</b>	<b>485</b>	<b>1.89</b>
Votimi, advokimi dhe vendimmarrja	422	1.81	468	1.81
Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike	385	1.73	439	1.98
Pjesëmarrja në aktivitete sportive	402	1.93	469	1.98

**Tabela 46: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
<b>Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike</b>	<b>53</b>	<b>1.82</b>	<b>62</b>	<b>1.92</b>
Votimi, advokimi dhe vendimmarrja	49	1.73	61	1.79
Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike	39	1.69	57	2.00
Pjesëmarrja në aktivitete sportive	45	1.94	59	2.10

Të dhënat e mësipërme nuk tregojnë ndryshime statistike të rëndësishme në vlerësimin e këtij qëllimi strategjik nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 në krahasim me një vit më parë.

25. Qëllimi strategjik nr. 7: “Të mundësohet për personat me aftësi të kufizuara që të përfaqësojnë interesat e tyre dhe të marrin pjesë në jetën publike dhe politike në Shqipëri”

26. Objektivi nr. 7.1: “Mundësimi i personave me aftësi të kufizuara për të votuar, advokuar për interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje”

27. Objektivi nr. 7.2: “Nxitja e punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike”

28. Objektivi nr. 7.3: “Ofrimi i mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive”

Objektivi i parë nën këtë qëllim strategjik lidhur me mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje është vlerësuar si “pak” i kënaqshëm edhe gjatë vitit 2020, duke u raportuar me një mesatare **1.81** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **1.79** nga përfaqësuesit e organizatave.

Objektivi lidhur me promovimin e punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike është vlerësuar me mesatare **1.98** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.00** nga përfaqësuesit e organizatave, por duke qenë njëkohësisht i vetmi objektivi për të cilin është raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht i rëndësishëm nga ana e nëngrupit të parë.

Ndërkohë, objektivi i tretë brenda këtij qëllimi strategjik lidhur me dhënien e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive është vlerësuar me një mesatare **1.98** nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre dhe **2.10** nga përfaqësuesit e organizatave.

Më poshtë përmbledhen vlerësimet e mbledhura nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave lidhur me secilin nga aktivitetet e përfshirë në studim për të tre objektivat kryesore të lidhur me pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike.

### **3.7.1. Vlerësimi i aktiviteteve që lidhen me mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje**

Aktivitetet e objektivit të parë nën këtë qëllim strategjik lidhur me mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje janë vlerësuar si “pak” të kënaqshme edhe gjatë vitit 2020 nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, duke u raportuar me një mesatare nga **1.65 në 1.91** (Tabela 47).

Pavarësisht se në nivel objektivi nuk ka rezultuar një ndryshim në vlerësimin e përgjithshëm të vitit 2020 krahasuar me një vit më parë, ndryshime statistikisht të rëndësishme në tre nga katër aktivitetet e vlerësuar.

Kështu, rezultatet e raportuara gjatë vitit 2020 tregojnë një ndryshim pozitiv në nivelin e kënaqësisë së pjesëmarrësve lidhur me përfshirjen si vëzhgues në procese zgjedhore (**M = 1.79**) dhe pjesëmarrjen, përfshirjen dhe përfaqësimin që kanë çështjet e aftësisë së kufizuara në nivel qendror dhe vendor (**M = 1.91**). Në të kundërt, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre e vlerësojnë si më pak të kënaqshme në vitin 2020 nivelin e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje përmes sigurimit të kushteve për një votim të lirë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë (**M = 1.81**).

Pavarësisht se nuk është shënuar asnjë ndryshim në vlerësimin e pjesëmarrësve lidhur me informacionin në formate të përshtatura (gjuha e shenjave, audio, Braille, titra, etj.) për pjesëmarrjen në zgjedhje, ky aktivitet është vlerësuar më negativisht gjatë këtij monitorimit të dytë (**M = 1.65**), me mbi gjysmën e kampionit (**50.9%**) që shprehen “aspak” të kënaqur në këtë drejtim (Shtojca B).

Aktivitetet e këtij objektivi të parë janë vlerësuar si “pak” të kënaqshme gjatë vitit 2020 edhe nga përfaqësuesit e organizatave, duke u raportuar me një mesatare nga **1.70 në 1.89** (Tabela 48).

**Tabela 47: Mundësia për të votuar, mbrojtur interesat dhe për vendimmarrje vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Votimi, advokimi dhe vendimmarrja	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me informacionin në formate të përshtatura (gjuha e shenjave, audio, Braille, titra, etj.) për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara	380	1.72	446	1.65
Niveli i kënaqësisë me pjesëmarrjen në zgjedhje përmes sigurimit të kushteve për një votim të lirë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë	421	1.95	457	1.81
Niveli i kënaqësisë me përfshirjen si vëzhgues në procese zgjedhore të personave me aftësi të kufizuara	372	1.67	419	1.79
Niveli i kënaqësisë për pjesëmarrjen, përfshirjen dhe përfaqësimin që kanë çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe vendor	369	1.80	451	1.91

Në mënyrë të ngjashme me personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, pothuaj gjysma e përfaqësuesve të organizatave e vlerësojnë si “aspak” të kënaqshme situatën lidhur me informacionin në formate të përshtatura (gjuha e shenjave, audio, Braille, titra, etj.) për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara (**47.2%**) dhe pjesëmarrjen në zgjedhje të tyre përmes sigurimit të kushteve për një votim të lirë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë (**46.4%**).

**Tabela 48: Mundësia për të votuar, mbrojtur interesat dhe për vendimmarrje vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Votimi, advokimi dhe vendimmarrja	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me informacionin në formate të përshtatura (gjuha e shenjave, audio, Braille, titra, etj.) për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara	42	1.54	53	1.70
Niveli i kënaqësisë me pjesëmarrjen në zgjedhje përmes sigurimit të kushteve për një votim të lirë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë	47	1.68	56	1.77
Niveli i kënaqësisë me përfshirjen si vëzhgues në procese zgjedhore të personave me aftësi të kufizuara	39	1.61	50	1.84
Niveli i kënaqësisë për pjesëmarrjen, përfshirjen dhe përfaqësimin që kanë çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe vendor	44	1.65	54	1.89

### 3.7.2. Vlerësimi i aktiviteteve të promovimit të punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike

Objekti i dytë lidhur me promovimin e punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike është vlerësuar përmes përmbushjes së një aktiviteti të vetëm me mesatare **1.98** nga personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre (Tabela 49) dhe **2.00** nga përfaqësuesit e organizatave (Tabela 50). Brenda këtij qëllimi strategjik, ky shënon të vetmin objektiv për të cilin gjatë vitit 2020 është raportuar një ndryshim pozitiv statistikisht i rëndësishëm nga ana e personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre

krahasuar me një vit më parë. Pavarësisht këtij ndryshimi, vetëm **22.8%** e personave me aftësi të kufizuara dhe **21.1%** e përfaqësuesve të organizatave të anketuar gjatë vitit 2020 shprehen “disi” ose “shumë” të kënaqur me nivelin e nxitjes dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike të katër bashkive (Shtojca B).

**Tabela 49: Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore (koncerte, teatër, muze, kinema)	385	1.73	439	1.98

**Tabela 50: Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Nxitja dhe pjesëmarrja në jetën artistike	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore (koncerte, teatër, muze, kinema)	39	1.69	57	2.00

### 3.7.3. Vlerësimi i aktiviteteve për dhënien e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive

Aktivitetet e objektivit të tretë nën këtë qëllim strategjik lidhur me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive (**M = 1.63**) dhe punën e mësuesve të edukimit fizik për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara (**M = 2.26**) janë vlerësuar si “pak” të kënaqshme edhe gjatë vitit 2020 nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre (Tabela 51).

**Tabela 51: Pjesëmarrja në aktivitete sportive vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Pjesëmarrja në aktivitete sportive	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive, përfshirë ato të organizuara nga Olimpiku Special	333	1.63	425	1.63
Niveli i kënaqësisë me punën e mësuesve të edukimit fizik për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara	300	2.28	460	2.26

Aktivitetet e objektivit të tretë lidhur me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive (**M = 1.95**) dhe punën e mësuesve të edukimit fizik për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara (**M = 2.25**) janë vlerësuar si “pak” të kënaqshme gjatë vitit 2020 edhe nga përfaqësuesit e organizatave që punojnë në këtë fushë (Tabela 52).

Rezultatet tregojnë se një në dy persona me aftësi të kufizuara (**57.4%**) dhe një në tre përfaqësues të organizatave (**33.9%**) nuk janë “aspak” të kënaqur me nivelin dhe mundësitë e ofruara për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive (Shtojca B).

**Tabela 52: Pjesëmarrja në aktivitete sportive vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Pjesëmarrja në aktivitete sportive	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i kënaqësisë me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive, përfshirë ato të organizuara nga Olimpiku Special	31	1.70	56	1.95
Niveli i kënaqësisë me punën e mësuesve të edukimit fizik për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara	40	2.02	52	2.25

Të pyetur rreth pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike në nivel qendror dhe vendor, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në studim raportuan se nuk ndiheshin të barabartë në proceset zgjedhore për shkak se mungon përshtatshmëria e fletësve të votimit, për shembull në gjuhën Braille, dhe shpesh qendrat e votimit janë të paaksesueshme.

Gjithashtu, personat me aftësi të kufizuara nuk mendojnë se janë të përfaqësuar dhe përfshirë në nivelet e ndryshme të vendimmarrjes të pushtetit lokal dhe qendror, ku ndihet mungesa e të zgjedhurve që përfaqësojnë këtë komunitet dhe mospërfshirja në proceset e konsultimeve publike.

*“Nuk kam marrë pjesë në votime. Qendra e votimit është në katin e dytë dhe është e pamundur të ngjitem.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Nuk jemi ftuar asnjëherë në konsultime nga Bashkia. Kur po projektohej sheshi i ri, përgatitëm një projekt të detajuar si shoqatë se çfarë kushtesh duhet të plotësoheshin që të ishte i aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara dhe ia dorëzuam kryetarit (të bashkisë). E kuptoj se disa nga ndërhyrjet mund të kushtonin – si rampa, udhëzues për shkopin, etj. – pavarësisht se është detyrim ligjor, por nuk morëm asnjëherë përgjigje pse nuk vijëzuan me bojë të bardhë shkallët dhe trotualet, që të mund të dalloheshin nga personat me vështirësi në shikim. Kjo nuk do u kushtonte aspak.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues organizate)*

*“Para pak kohësh erdhën – si donacion më duket – rreth dhjetë karrige me rrota në bashki. Drejtori në bashki vendosi se si do i shpërndante dhe kujt do ia jepte dhe nuk na përfshiu fare në vendimmarrje. Ne si shoqatë i njohim shumë më mirë se ai nevojat që ka komuniteti.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues organizate)*

*“Vëmendja e bashkisë dallohet që nga ambientet që na ka dhënë në përdorim. Ne (personat që nuk shikojnë) e kemi zyrën pothuaj pa ndriçim natyral dhe në katin e tretë. Kur u lirua një zyrë në katin e parë e kërkua, por ajo është ende bosh. Ndërsa invalidët e punës ende nuk kanë marrë asnjë ambient nga bashkia për zyra.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues organizate)*

Personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave raportuan se aktivitetet kulturore dhe sportive janë të pakta, dhe shpesh mbahen në ambiente të paaksesueshme fizikisht nga personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, pjesëmarrësit në këtë studim identifikuan nevojën e angazhimit më të madh të shkollës dhe mësuesve të edukimit fizik në angazhimin dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore e sportive brenda shkollës.

### 3.8. Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit

Qëllimi i tetë strategjik i PKVPAK<sup>29</sup> lidhet me nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, monitorimin dhe vlerësimin e tij dhe parashikon të realizohet nëpërmjet katër objektivave, si: sigurimi i një bashkëpunimi dhe koordinimi më të mirë në përcaktimin dhe monitorimin e aktiviteteve mes MSHMS-së dhe gjithë njësive të qeverisjes vendore (NJQV)<sup>30</sup>; monitorimi i pabarazive me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe koordinimi i politikave publike që synojnë uljen e tyre<sup>31</sup>; ngritja e sistemit për mbledhjen e treguesve të monitorimit të shoqëruara me pasaportat për çdo tregues<sup>32</sup>; dhe nxitja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>33</sup>. Të dhënat tregojnë se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre janë “të pakënaqur” me përmbushjen e këtij qëllimi strategjik, e vlerësuar kjo me mesatare **1.37** (Tabela 53). Ndërsa përfaqësuesit e organizatave raportojnë një mesatare pak më të lartë **1.92** (Tabela 54) që tregon se janë “pak të kënaqur” për sa i përket nxitjes së bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit mes sektorëve të ndryshëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

**Tabela 53: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi nxitjen e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre sipas viteve**

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit	366	1.31	414	1.37

**Tabela 54: Vlerësimi i qëllimit strategjik mbi nxitjen e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Përfaqësuesit e organizatave	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit	50	1.78	59	1.92

Pavarësisht objektivave të parashikuar për zbatim nga ana e institucioneve publike, personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave u kërkuan edhe gjatë monitorimit të vitit 2020 të jepnin vlerësimin e tyre lidhur me përmbushjen e tre aktiviteteve kryesore. Aktivitetet nën këtë qëllim strategjik janë vlerësuar nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre gjatë vitit 2020 me mesatare që variojnë nga **1.15 në 1.55**, duke identifikuar dy ndryshime të rëndësishme statistikore (Tabela 55). Kështu, pavarësisht se gjatë monitorimit të dytë pjesëmarrësit shprehen më të kënaqur me nivelin e pjesëmarrjes në procese të monitorimit të Planit të Veprimit (M

29. Qëllimi strategjik nr. 8: “Të krijohen sinerji midis sektorëve të ndryshëm për nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme”

30. Objektivi nr. 8.1: “Sigurimi i një bashkëpunimi dhe koordinimi më të mirë për projektimin dhe monitorimin e aktiviteteve mes MMSR-së dhe gjithë Bashkive”

31. Objektivi nr. 8.2: “Monitorimi i pabarazive me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe koordinimi i politikave publike që synojnë reduktimin e tyre”

32. Objektivi nr. 8.3: “Ngritja e sistemit për mbledhjen e indikatorëve të monitorimit të shoqëruar me pasaportat për çdo indikator”

33. Objektivi nr. 8.4: “Nxitja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

= **1.55**), niveli i pjesëmarrjes së tyre në konferenca në vende anëtare të BE për të parë e shkëmbyer përvoja pozitive në fushën e aftësisë së kufizuar ka shënuar rënie (**M = 1.15**). Pavarësisht ndryshimeve pozitive të raportuara lidhur me aktivitetin e parë, vetëm një në dhjetë persona me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre (**9.5%**) shprehen se janë përfshirë “disi” ose “shumë” në proceset e monitorimit të PKVPAK (Shtojca B).

**Tabela 55: Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit vlerësuar nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre sipas viteve**

Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i pjesëmarrjes në procese të monitorimit të Planit të Veprimit të Aftësisë së Kufizuar 2016-2020	288	1.41	408	1.55
Niveli i pjesëmarrjes në konferenca të organizuara nga Ministria mbi vendimarrjen e mbështetur, shërbimet komunitare, sipërmarrjen sociale	339	1.36	404	1.39
Niveli i pjesëmarrjes në konferenca në vende anëtare të BE për të parë e shkëmbyer përvoja pozitive në fushën e aftësisë së kufizuar	357	1.23	397	1.15

Aktivitetet nën këtë qëllim strategjik janë raportuar nga përfaqësuesit e organizatave gjatë vitit 2020 me mesatare që variojnë nga **1.42 në 1.94**, duke i vlerësuar si “pak” të kënaqshme iniciativat e ndërmarra deri më tani në këtë drejtim (Tabel 56).

**Tabela 56: Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit vlerësuar nga perspektiva e përfaqësuesve të organizatave sipas viteve**

Nxitja e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit	2019		2020	
	N	Mesatare	N	Mesatare
Niveli i pjesëmarrjes në procese të monitorimit të Planit të Veprimit të Aftësisë së Kufizuar 2016-2020	43	1.55	54	1.94
Niveli i pjesëmarrjes në konferenca të organizuara nga Ministria mbi vendimarrjen e mbështetur, shërbimet komunitare, sipërmarrjen sociale	49	2.18	58	2.28
Niveli i pjesëmarrjes në konferenca në vende anëtare të BE për të parë e shkëmbyer përvoja pozitive në fushën e aftësisë së kufizuar	45	1.35	53	1.42

Të pyetur rreth vlerësimit të tyre mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, monitorimin dhe vlerësimin e PKVPAK, personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave identifikuan mungesën e informacionit lidhur me këtë plan veprimi, si dhe mangësitë në monitorimin e tij.

*“Nuk e njoh Planin e Veprimit. E kam dëgjuar nga ju (përfaqësuesit e organizatave), por të them të drejtën nuk e di se çfarë parashikohet aty. Dhe në institucionet që shkoj nuk ma kanë përmendur ndonjëherë.” (person me aftësi të kufizuara)*

*“Kam qenë disa herë në takime të organizatave ose me prindër të tjerë. U themi gjithmonë se çfarë problemesh kemi, por më duket sikur asgjë nuk ndryshon. Unë nuk i kërkoj asgjë më shumë shtetit, sesa të zbatojë ato që ka shkruar në letër. Vetëm kaq. Të zbatojë ato që vetë ka miratuar.” (prind fëmije me aftësi të kufizuara)*

*“Unë mendoj se monitorimi i Planit të Veprimit duhet të bëhet nga vetë personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre. Dhe më pas, të vijmë në takim me ne vetë ministri dhe kryetari i bashkisë që të dëgjojë hallet tona. Asnjëherë nuk janë ulur në një tavolinë me ne.” (person me aftësi të kufizuara, përfaqësues organizate)*

# Përfundime

Sipas statistikave të fundit zyrtare për periudhën Korrik - Gusht 2020<sup>34</sup>, numri i personave që janë njohur zyrtarisht të kenë një aftësi të kufizuar në Shqipëri është 168,418, nga të cilët 74,350 janë përfitues në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe 74,194 persona në sistemin e ndihmës sociale. Prej tyre, 19,874 persona me aftësi të kufizuara përfitojnë edhe pagesë kujdestarie.

Qeveria Shqiptare, me miratimin e Planit kombëtar të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016–2020, ka ndërmarrë angazhimin për përmbushjen në afate dhe me buxhete konkrete të 179 aktiviteteve të fokusuara në tetë fushat prioritare, zbatimimi i të cilave do të mundësonte përmirësimin e cilësisë së jetës dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. PKVPAK parashikon monitorimin e përvitshëm të tij në nivel vendor dhe mbështet organizatat e shoqërisë civile për të realizuar një raport progresi të pavarur.

Të dhënat e këtij raporti të dytë monitorimi tregojnë se në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile tregojnë një vlerësim jo të kënaqshëm me arritjen e aktiviteteve dhe objektivave të parashikuar për t'u realizuar gjatë periudhës 2016-2020. Pjesëmarrësit në studim ende vlerësojnë të gjithë qëllimet specifike në nivel “aspak” ose “pak” të kënaqshëm, me mesatare që variojnë nga 1.37 në 2.39.

Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre vlerësojnë me nivel më të ulët kënaqësie përmbushjen e qëllimit strategjik lidhur me nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, monitorimin dhe vlerësimin të PKVPAK (M = 1.37) dhe atij lidhur me barazinë në sistemin e drejtësisë (M = 1.44).

34. Shërbimi Social 2020, Përfituesit e PAK Korrik-Gusht 2020, <http://www.sherbimisocial.gov.al/perfituesit-e-pak-2020/>, aksesuar tetor 2020

Lidhur me aktivitetet e përfshira në qëllimet e mësipërme, të dhënat tregojnë se mbi dy në tre pjesëmarrës në studim gjatë vitit 2020 vlerësojnë se nuk janë përfshirë në konferenca vendore (71.2%) dhe ndërkombëtare (88.7%), ndërsa mundësitë e ofrimit të ndihmës ligjore falas (73.8%) dhe përshtatshmëria e gjuhës dhe informacionit gjatë ofrimit të këtij shërbimi (68.3%) mbeten “aspak” të kënaqshme.

Ndërkohë, qëllimet e vlerësuar më pozitivisht nga ky grupim gjatë vitit 2020 lidhen me arsimin gjithëpërfshirës (M = 2.39) dhe shërbimet shoqërore (M = 2.06). Hapat pozitivë të ndërmarrë gjatë periudhës 2016-2020 në fushën e arsimit gjithëpërfshirës reflektohen në vlerësimet e ofruara nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, ku mbi gjysma e pjesëmarrësve “disi” ose “shumë” të kënaqur me praninë e mësuesit ndihmës (58.1%), përdorimin e Planit Edukativ Individual (54.2%), si dhe mundësitë që iu jep shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u integruar me fëmijët e tjerë (51.9%). Në mënyrë të ngjashme, më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në kampionin e vitit 2020 kanë raportuar se janë “disi” ose “shumë” të kënaqur me njohuritë e stafit (60.9%) dhe procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (55.2%).

Krahasuar me rezultatet e monitorimit të një viti më parë, përmes të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2020, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre identifikuan ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme në katër nga tetë qëllimet strategjike të PKVPAK, si dhe në 11 nga 19 objektivat e përfshirë në këtë studim.

Në krahasim me personat me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e organizatave në monitorimin e vitit 2020 ofrojnë një vlerësim më të unifikuar lidhur me përmbushjen e qëllimeve strategjike të PKVPAK, me mesatare që variojnë nga 1.92 në 2.39, por duke u shprehur “pak” të kënaqur me ecurinë e tyre.

Pavarësisht një vlerësimi të përgjithshëm më pozitiv, krahasuar me rezultatet e ofruara nga i njëjti grupim në monitorimin e parë, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar ndryshime pozitive statistikisht të rëndësishme vetëm në dy nga tetë qëllimet strategjike dhe tre nga 19 objektivat e vlerësuar. Ndryshimet pozitive të raportuara nga ky grupim lidhen me fushën e arsimit gjithëpërfshirës (M = 2.39) dhe kujdesin shëndetësor të aksesueshëm dhe të barabartë për personat me aftësi të kufizuara (M = 2.07).

Ndërkohë, në nivel objektiv, përfaqësuesit e organizatave kanë raportuar dhe të vetmin ndryshim negativ statistikisht të rëndësishëm në këtë monitorim, lidhur me mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike falas (M = 1.88). Ky objektiv dhe tre ndër aktivitetet e vlerësuara më negativisht nga pjesëmarrësit, ku më shumë se gjysma shprehen “aspak” të kënaqur me përdorimin e gjuhës së përshtatur gjatë ofrimit të ndihmës juridike (61.3%), trajnimet e ofruara mbi shërbimet e ndihmës juridike dhe kriteret e përfitimit (63.3%), si dhe informacionin e ofruar në internet për ndihmën juridike për personat me aftësi të kufizuara (61.1%).

.....

# Rekomandime

.....

Në këtë seksion përmbledhen rekomandimet, bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e këtij raporti, si dhe sugjerimet e ofruara në këtë drejtim nga personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre, si dhe përfaqësuesit e organizatave që punojnë në këtë fushë gjatë diskutimeve në grup të kryera në të katër bashkitë e përfshira në komunikim.

Të dhënat e këtij monitorimi duhet t'i shërbejnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe institucioneve të linjës përgjegjëse për zbatimin e PKVPAK si një tregues i ecurisë së deritanishme të zbatimit dhe arritjes së objektivave dhe qëllimeve të parashikuar gjatë periudhës 2016-2020. Gjithashtu, këto gjetje duhet të furnizojnë me ide dhe të priorizojnë fushat kryesore të ndërhyrjes gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të ardhshëm të veprimit për periudhën 2021-2025, duke siguruar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, parandalimin e diskriminimit dhe eliminimin e pengesave në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjinë e Bashkimit Evropian për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Rekomandimet specifike të identifikuara janë ndarë sipas qëllimeve strategjike të përfshira në Planin e Veprimit, për të adresuar në mënyrë sa më konkrete ndërhyrjet e nevojshme, duke ritheksuar shumë nga rekomandimet e identifikuara në raportin e monitorimit të vitit 2019.

## **Për të garantuar aksesueshmërinë rekomandohet:**

- ◇ Marrja e masave të shpejta nga bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse (përfshirë institucionet në nivel qendror) për të siguruar akses pa barriera<sup>35</sup> për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara;
- ◇ Vëmendje e veçantë duhet të tregohet lidhur me eliminimin e pengesave fizike dhe mangësive në sinjalizime sidomos në objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët;
- ◇ Çdo institucion qendror duhet të marrë masa për të hartuar dhe buxhetuar planet e aksesueshmërisë, të cilat duhet të konsultohen me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara;
- ◇ Rampat dhe elementët e tjerë të aksesueshmërisë infrastrukurore duhet të ndërtohen duke respektuar të gjitha kriteret teknike të sigurisë, si dhe të jenë pjesë e kushteve të detyrueshme në çdo proces prokurimi publik;
- ◇ Mjetet, mënyrat dhe formatet e komunikimit të përdorura në ofrimin e shërbimeve publike duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmërisë në komunikim, duke publikuar informacionin në gjuhën braille dhe/ose shkrim të zmadhuar dhe/ose në formatin audio për individët me vështirësi shikimi ose plotësisht të verbër dhe përkthimin në gjuhën e shenjave për personat me vështirësi në dëgjim, me përparësi zbatimi nga institucionet e ligjit dhe tatim-taksave, ato të arsimit dhe botimit, të shëndetësisë, të punësimit dhe të transportit;
- ◇ Njësitë e pushtetit vendor duhet të monitorojnë me përparësi përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve private ose publike të licencuara për ofrimin e transportit urban dhe interurban, duke siguruar ofrimin e transportit qytetas me mjete tërësisht të përshtatura minimum çdo një orë dhe shërbim transporti ndër qytetas minimum një herë në ditë sipas parashikimeve të kuadrit rregullator;
- ◇ Operatorët e medias, sidomos ato audiovizive publike dhe me licenca kombëtare, duhet të transmetojnë emisionet kryesore të lajmeve të shoqëruar me titra ose me gjuhën e shenjave;
- ◇ Institucionet publike përgjegjëse për teknologjinë e informacionit duhet të buxhetojnë në mënyrë të përshtatshme zhvillimin dhe shpërndarjen e aplikacioneve që do të mundësonin aksesin në informacion, sidomos përmes telefonave celularë, të personave me vështirësi në shikim.

---

35. VKM 1074 datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara"

## **Për të garantuar barazinë para ligjit rekomandohet:**

- ◇ Zbatimi i Ligjit për Ndihmën Juridike të garantuar nga shteti dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij. Është e domosdoshme gjithashtu që të ndërmerren hapa për njohjen e barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara, shfuqizimin e dispozitave që kanë të bëjnë me heqjen e zotësisë për të vepruar dhe kujdestarisë ligjore. Në këtë drejtim, rekomandohet të ndërmerren studime të cilat sqarojnë konceptin e “kapacitetit ligjor” dhe “vendimmarrjes së mbështetur”;
- ◇ Shkolla e magistraturës dhe dhoma e avokatisë duhet të sigurojë ofrimin e trajnimeve periodike dhe kurrikulave për gjyqtarë dhe avokatë lidhur me kuadrin rregullator vendas, standardet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- ◇ Gjithashtu, në këtë kuadër, përmirësimi i standardeve të aksesit në sistemin e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me aksesin fizik, aksesin në informacion ligjor në formate të përshtatura për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, formate në versionin audio, Braille, gjuhë të thjeshtuar dhe garantimi i shërbimit të interpretit të gjuhës së shenjave, është themelor.

## **Për të garantuar arsim dhe formim profesional, si dhe punësim rekomandohet:**

- ◇ Sigurimi i aksesueshmërisë fizike dhe në informacionin që ofrohet në qendrat dhe në shkollat e arsimit dhe formimit profesional, duke i bërë ato të arritshme dhe të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara;
- ◇ Sigurimi i mbështetjes me pajisje dhe mjete për vetëpunësim të personave me aftësi të kufizuara që mbarojnë kurset e formimeve profesionale për të nxitur vetëpunësimin dhe përfshirjen në tregun e punës;
- ◇ Trajnimi dhe zhvillimi profesional i stafeve të qendrave dhe shkollave të arsimit dhe formimit profesional dhe të zyrave të punësimit, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve që ofrohen nga këto institucione për personat me aftësi të kufizuara për të nxitur dhe lehtësuar integrimin e tyre në tregun e punës;
- ◇ Rishikimi i formateve të regjistrimit të kërkesave për punësim, si dhe pozicioneve të ofruara nga operatorë publikë dhe privatë në mënyrë që të përfshijnë nevojat dhe nivelin e përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar punësimin në përputhje me aftësitë;
- ◇ Monitorimi dhe zbatimi i sanksioneve për çdo punëdhënës, me fokus të veçantë në institucionet publike, që nuk punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo 25 punonjës;
- ◇ Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të punëdhënësve publikë dhe privatë në lidhje me programet që ofrojnë subvencione për punësimin e punëkërkuësve të

papunë më aftësi të kufizuara, zbatimi me efektivitet dhe zgjerimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme;

- ◇ Rishikimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor me qëllim nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, përmes bashkëpunimit në mënyrë të veçantë mes MSHMS dhe MFE, veçanërisht për të adresuar çështje që frenojnë/pengojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara, sikurse janë ato që lidhen me pagesat dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, vlerësimin, etj.

### **Për të garantuar arsim gjithëpërfshirës e cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara rekomandohet:**

- ◇ Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës nga MAS, DAR dhe ZA në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe forcimi i kapaciteteve mbi mësimdhënien për fëmijët me aftësi të kufizuara; këto masa duhet të adresojnë: (a) Garantimin e qëndrueshmërisë dhe praktikave të mira, përmes investimit në përmirësimin e cilësisë së tyre dhe monitorimit të vazhdueshëm; (b) Sigurimin që çdo fëmijë në çdo bashki të ketë mësuesin ndihmës me aftësitë e duhura profesionale, PEI cilësore, të hartuara e të dakordësuara së bashku me prindin dhe vlerësimin nga komisione të ngritura për këtë qëllim pranë DAR dhe institucioneve arsimore;
- ◇ Investimi në krijimin e kapaciteteve të mësuesve ndihmës, por edhe të gjithë mësuesve e personelit në shkollë dhe arsim parashkollor përmes trajnimeve cilësore, si një domosdoshmëri për të rritur cilësinë e mësimdhënies për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ◇ Investime në infrastrukturë për eliminimin e pengesave që lidhen me aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore, përfshirë garantimin e transportit falas, aksesueshmërinë në ambiente, përfshirë mjediset e brendshme dhe të jashtme, në infrastrukturën mbështetëse (tekste Braille/ interpret i gjuhës së shenjave/ mjete didaktike dhe shërbime të tjera mbështetëse brenda dhe jashtë ambienteve të shkollës) në ndihmë të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ◇ Nxitjen e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aktivitetet kulturore, sportive dhe argëtuese të organizuara nga institucionet arsimore, duke siguruar dhe informimin e përshtatshëm dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm kundër diskriminimit të të gjithë nxënësve.

## **Për të garantuar akses dhe cilësinë e shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuara rekomandohet:**

- ◇ Shtrirja e përdorimit të modelit të ri bio-psiko social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ndërmarrja e fushatave të informimit nga MSHMS, SHSSH dhe nga bashkitë e njësitë administrative mbi qëllimin, procesin dhe përfitimet që sjell ky model për ta e për familjet e tyre;
- ◇ Rishikimi i skemave të mbështetjes financiare për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë nivelin e pagesës që ofrohet për shkak të aftësisë së kufizuar, për të ndikuar në përbalimin e kostove shtesë të jetesës së përditshme që lidhen me aftësinë e kufizuar, por edhe për të krijuar skema për përbalimin e kostove të nevojshme të shërbimeve shoqërore, të cilat aktualisht nuk ofrohen nga shërbimet publike;
- ◇ Ngritja e më shumë qendrave ditore dhe multifunksionale të cilat do u shërbejnë fëmijëve, por dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në të gjitha bashkitë e vendit, si dhe sigurimi i aksesueshmërisë në shërbimet ekzistuese publike, duke përfshirë sigurimin e transportit falas;
- ◇ Ngritja e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse në nivel lokal, pranë bashkisë, DRSHSSH, qendrave që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, për ofrimin e shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, duke garantuar gamën e gjerë të profesionistëve si dhe mjeteve didaktike të nevojshëm;
- ◇ Krijimi i shërbimeve që nxisin jetesën e pavarur, për personat me aftësi të kufizuara në moshë madhore, përfshirë rritjen e aksesit në skemat e bonuseve për strehim social, me qëllim zbatimin në praktikë të deinstitutionalizimit;
- ◇ Informimi në vazhdimësi i specialistëve, ofrues të shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, për ndryshimet ligjore në fushën e aftësisë së kufizuar, me qëllim aftësimin e tyre për të informuar në kohë dhe si duhet personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre për përfitimet që ata mund të kenë për shkak të aftësisë së kufizuar nga skema të mbështetura financiarisht nga shteti.

## **Për të garantuar akses dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara rekomandohet:**

- ◇ Forcimi i kapaciteteve të MSHMS, DRSH, stafëve të gjitha institucioneve shëndetësore, specialistëve të sistemit të kujdesit shëndetësor për mënyrat e komunikimit dhe trajtimit që nevojitet përkundrejt personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për kujdes shëndetësor;
- ◇ Sigurimi i mbulimit të të gjithë bashkive me mjekë specialistë të nevojshëm për trajtimin e problematikave shëndetësore të personave me aftësi të kufizuar dhe sidomos atyre në moshë të hershme;
- ◇ Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese, përmes shpërndarjes së materialeve informative,

në formate të përshtatura, për personat që nuk flasin dhe dëgjojnë, personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe atyre me aftësi të kufizuara intelektuale, me qëllim informimin e tyre për shërbimet shëndetësore që ofrohen nga sistemi shëndetësor në vend si dhe të drejtat që ata kanë për t'i përfituar këto shërbime;

- ◇ Përmirësimi i nivelit të aksesueshmërisë në çdo institucion shëndetësor, në zbatim të kuadrit ligjor, i cili duhet të përfshijë aspekte të infrastrukturës ndërtimore ashtu dhe në aspektin e informacionit dhe shërbimeve bazuar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara;
- ◇ Forcimi i njohurive dhe kapaciteteve të personelit shëndetësor, sidomos atij në konsultore për identifikimin, diagnostikimin dhe ndërhyrjen e hershme në fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ◇ Inspektimi sistematik nga institucionet përgjegjëse për inspektimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në nivel qendror dhe lokal dhe vlerësim mbi baza vjetore të nivelit të aksesueshmërisë në institucionet shëndetësore në përputhje me standardet, por dhe se sa ato respektojnë legjislacionin në drejtim të ofrimit falas të shërbimeve të caktuara të tilla si shërbimi dentar;
- ◇ Ngritja në nivel lokal e qendrave të aftësimin dhe rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara si dhe ofrimi në banesë i shërbimeve në rastet e nevojshme;
- ◇ Sigurimi i respektimit të masave aktuale, si dhe zgjerimi i tyre, lidhur me rimbursimin e shpenzimeve për medikamente, karrige me rrota, orteza, aparate dëgjimi apo pajisje të tjera të teknologjisë ndihmëse.
- ◇ Për të garantuar pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike rekomandohet:
- ◇ Respektimi i procedurave ligjore lidhur me konsultimin publik me të gjithë aktorët e interesit të vendimmarrjes dhe politikave të hartuara në nivel qendror dhe lokal që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë personat me aftësi të kufizuara;
- ◇ Sigurimi i dëgjësive të vazhdueshme të këshillave bashkiakë me personat e interesit dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e tyre, përfshirë konsultimin mbi sigurimin e aksesueshmërisë në investimet publike dhe hartimin e buxheteve;
- ◇ Përmirësimi dhe zbatimi i Kodit Zgjedhor dhe dispozitave të cilat ende në praktikë nuk mundësojnë votim të drejtpërdrejtë, të fshehtë e të barabartë për të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara;
- ◇ Mbajtja dhe përditësimi në sistemin e të dhënave, i informacionit me të dhëna për organizatat e shoqërisë civile, me qëllim informimin në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme të grupeve të interesit, përfshirë organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar, për ndryshimet në politika, kuadrin ligjor dhe atë programatik që ndikon në jetën e tyre;
- ◇ Garantimi i aksesit të lirë, pa barriera fizike, në informacion dhe komunikim, si dhe mbështetje për transport të përshtatur, kur është e nevojshme, për të garantuar pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në mjediset e institucioneve ku zhvillohen aktivitete me karakter politik apo publik, përfshirë zgjedhjet, apo aktivitete kulturore e sportive.

## **Për të garantuar bashkëpunim, monitorim dhe vlerësim për realizimin e PKVPAK dhe KNDPAK rekomandohet:**

- ◇ Sigurimi i përfshirjes domethënëse të personave me aftësi të kufizuara në procesin e hartimit dhe prioritizimin e aktiviteteve dhe buxheteve që lidhen me PKVPAK 2021-2025;
- ◇ Krijimi i strukturave të monitorimit, para së gjithash duke emëruar/përcaktuar pikat e kontaktit në çdo institucion në nivel qendror e vendor, përgjegjës për të mbledhur të dhëna, për të informuar, koordinuar e monitoruar zbatimin e PKVPAK;
- ◇ Krijimi i mekanizmave të komunikimit me shoqërinë civile dhe me të gjithë grupet e interesit në nivel lokal dhe qendror dhe mundësimi i realizimit të raporteve alternative të monitorimit nga këta të fundit;
- ◇ Zbërthimi i PKVPAK në plane lokale, të shoqëruara me afate kohore dhe kosto financiare. Për të qenë efikase, këto plane mund të jenë pjesë integrale e planeve të tjera lokale, si atyre për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose e planeve sociale, të cilat aprovohen për zbatim në këshillat bashkiakë. Këto plane në zbatim të PKVPAK nevojitet të paraprihen nga analiza e situatës dhe me pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara, familjarëve dhe organizatave të fushës;
- ◇ Ofrimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve dhe mbështetje e nevojshme për sigurimin e ambienteve për shoqatat ose grupet informale të personave me aftësi të kufizuara që duan të organizohen në nivel lokal;
- ◇ Forcimi i mekanizmave të ankimimit dhe ndjekjes së tyre pranë ministrive të linjës dhe institucioneve të pavarura mbi moszbatimin e parashikimeve të kuadrit rregullator;
- ◇ Mundësimi i konferencave rajonale me qëllim shkëmbimin e eksperiencave në funksion të përmirësimit dhe avancimit të masave të parashikuara në këtë plan;
- ◇ Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit dhe në mënyrë të veçantë koordinimi me donatorë dhe organizata të shoqërisë civile për të mundësuar realizimin në kohë dhe në mënyrë cilësore të masave në PKVPAK dhe planet lokale në zbatim të tij;
- ◇ Organizimi i konferencave vjetore në nivel qendror e vendor me personat me aftësi të kufizuara për të mundësuar raportim nga strukturat përgjegjëse për rezultatet e arritura mbi baza vjetore për zbatimin e PKVPAK.



.....

# Shtojca

.....

## Shtojca A

### Instrumentet dhe forma e pëlqimit

Kodi pyetësorit

Ora e fillimit të intervistës


#### **PYETËSOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA/FAMILJARË TE TYRE**

Ky pyetësor është pjesë e procesit të vlerësimit të zbatimit të planit kombëtar të veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2016 – 2020) nga perspektiva e OSHC-ve, personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarëve të tyre në Berat, Dibër, Korçë dhe Lezhë, dhe organizohet në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, që zbatohet nga “World Vision”, “Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (ADRF), dhe “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësitë Kufizuar” (MEDPAK), me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (BE).

Pjesëmarrja juaj në këtë studim është plotësisht vullnetare. Të dhënat e studimit do të jepen të përmbledhura, pa përmendur personin që ka plotësuar pyetësin. I gjithë informacioni që do të merret nga ky studim do të trajtohet si informacion konfidencial dhe do të jetë vetëm në dispozicion të studjuesit që do të përpunojë të dhënat e këtij studimi. Ju lutem përgjigjuni me vërtetësi çdo pyetjeje, në mënyrë që të dhënat që do të grumbullojmë të paraqesin gjendjen reale, me të gjitha arritjet dhe vështirësitë.

**1. Rajoni:** 1.  Berat 2.  Dibër 3.  Lezhë 4.  Korçë

**2. Vendbanimi:** 1.  Fshat 2.  Qytet

**3. Unë jam:**

1.  Person me aftësi të kufizuara 2.  Prind/familjar i një personi me aftësi të kufizuara

**3.1 Ka marrë pjesë familja në plotësimin e pyetësorit të raportit të parë:**

1.  Po 2.  Jo

Nëse Po, por familjari i intervistuar është i ndryshëm nga hera e parë, ju lutem shpjegoni:

---

**4. Mosha e familjarit/kujdestarit të fëmijës/personit me aftësi të kufizuara \_\_\_\_\_**

**5. Mosha e personit me aftësi të kufizuara \_\_\_\_\_**

**6. Gjinia:** 1.  Femër 2.  Mashkull

**7. Kategoria e aftësisë së kufizuar:**

*Cila nga alternativat në vijim pasqyron më shumë gjendjen tuaj apo të familjarti/afërmit tuaj:*

1. Aftësi e kufizuar intelektuale
2. Shikimi
3. Shëndeti mendor/çrregullime të sjelljes/emocionale
4. Dëgjimi/të foluri
5. Aftësi e kufizuar fizike  
(mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

**Perceptimi mbi Zbatimin e Planit të Veprimit:**

**Ju lutem vlerësoni nga 1 në 4 alternativat në vijim.**

**Nëse nuk keni informacion, zgjidhni alternativën “s’ kam informacion”.**

**Kur i intervistuari/a refuzon të përgjigjet, në krah të pyetjes shënoni numrin 99.**

## AKSESUESHMËRIA

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

<b>8.1 Si e vlerësoni AKSESUESHMËRINË FIZIKE në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj?</b>						
Sa të kënaqur jeni me aksesueshmërinë fizike në:						
1	<b>bashkinë tuaj/ në zyrat e njësisë administrative</b> , ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	<b>në institucionet edukuese/arsimore</b> (DAR, Zyrat arsimore, institucionet parashkollore, ato të arsimit baze/ fillor dhe të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, universitetet)?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	<b>institucionet kulturore e sportive</b> (qëndër kulturore, qëndër rinore, kinema, muzeum, fushë sporti, ambiente sportive në shkollë e në sallat sportive etj) në bashkinë/ qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	<b>institucionet shëndetësore</b> (qëndër shëndetësore, qëndër spitalore, qëndër rehabilitimi fizik) në qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	<b>institucionet e shërbimeve shoqërore</b> (qëndër ditore/ qëndër zhvillimi, zyrat e Drejtorise rajonale të shërbimit social shtetëror, zyrat e sigurimeve shoqërore), në qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	<b>zyrat e punësimit, qëndrat e formimit profesional, shkollat e mesme profesionale</b> , në qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	<b>Qendrat e votimit</b> në qytetin/ fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	<b>institucionet e drejtësisë</b> (gjykata, prokurori, polici) në bashkinë tuaj?	1	2	3	4	S'kam informacion
<b>8.2 Si e vlerësoni nivelin e AKSESIT NË INFORMACION në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara?</b>						
1	A merrni informacion nga shërbimet publike mbi legjislacionin/ politikat/ programet/ projektet/ çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	A ka mundësi për <b>komunikim të përshtatur me nevojat tuaja</b> (në format audio apo brail; në gjuhën e shenjave; në formate të thjeshta, me gjuhë të thjeshtë, me figura; me gjuhën e shenjave etj.) në Bashki, në KMCA, në qëndra ditore, në qëndra shëndetësore, në kopësht/shkollë/në muze ose ndërmarrje?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	A ka mundësi për <b>komunikim të përshtatur</b> (etj.) <b>në shtëpi</b> dhe me anëtarët e familjes <b>për personat me probleme në dëgjim</b> ?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	A i përdorni faqet e internetit të institucioneve publike?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	Nëse po, a janë ato të përshtatura? Nëse jo, kaloni në pyetjen 6, në vijim.	1	2	3	4	S'kam informacion
6	A ka informacion të përshtatur në mediet kombëtare (përkthim në gjuhën e shenjave, informacion të thjeshtuar, titra)?	1	2	3	4	S'kam informacion
<b>8.3 Si e vlerësoni AKSESUESHMËRINË në transportin publik për personat me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj?</b>						
1	Sa të lehtë e ka një person me karrocë ose i verbër të përshkojë rrugët e qytetit e të shkojë ku ka nevojë?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni me nivelin e rimbursimit të kostove të transportit kur udhëtoni me mjete të transportit urban e interurban?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni me nivelin e rimbursimit të karburantit?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e aksesueshmërisë, me notën përkatëse.

---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara ?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## BARAZIA PARA LIGJIT

Ju lutemi në varësi të pyetjes vlerësoni përgjigjen sipas njërës nga format/alternativat në vijim:  
**1 =Asnjëherë; 2 =ndonjëherë; 3 =shpesh; 4 = gjithmonë**

**1= aspak, 2 = pak, 3 = disi, 4 = shumë**

5.1 Barazia. Si e vlerësoni shërbimin e ndihmës juridike falas për personat me aftësi të kufizuara?						
1	A keni marrë ndihmë juridike (ndihmë ligjore)?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Nëse po, a keni mbetur të kënaqur? Nëse jo, vijoni në pyetjen 5.	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Nëse keni marrë ndihmë juridike, a kanë qenë të trajnuar juristët që ju kanë ofruar ndihmën juridike për çështje të aftësisë së kufizuar?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Nëse keni marrë ndihmë juridike, a është ofruar përkthim në gjuhën e shenjave? Formate Braille, gjuhë e thjeshtuar?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	A keni marrë ndonjë trajnim për shërbimet e ndihmës juridike, kriteret e përfitimit, e të tjera?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	A keni marrë ndonjëherë informacion në internet për ndihmën juridike?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	A keni kujdestar ligjor (përveç kujdestarit që përfitoni në bazë të vendimit të KMCAP)?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Nëse po, si e ushtron ky person kujdestarinë? Nëse jo, kaloni në pyetjen 9, në vijim.	1	2	3	4	S'kam informacion
9	A njihni persona që janë nën kujdestari ligjore?	1	2	3	4	S'kam informacion
10	A keni ndjekur ndonjë çështje në gjykatë? Në prokurori?	1	2	3	4	S'kam informacion
11	A jeni të kënaqur nga shërbimi i avokatit që ka ndjekur çështjen?	1	2	3	4	S'kam informacion

12	A keni mbetur të kënaqur nga procedurat? shpenzimet, kohëzgjatja, aksesit, komunikimi?	1	2	3	4	S'kam informacion
13	A njihni ndonjë person që ka kujdestar ligjor? Nëse jo kalo tek pyetja 15	1	2	3	4	S'kam informacion
14	A ka probleme me vendimarrjen?	1	2	3	4	S'kam informacion
15	A keni dëgjuar për ndryshime ligjore në lidhje me kujdestarinë ligjore?	1	2	3	4	S'kam informacion
16	A keni dëgjuar për vendimarrjen e mbështetur?	1	2	3	4	S'kam informacion
17	A mendoni që sistemi i drejtësisë është i aksesueshëm për PAK?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj në fushën e barazisë përpara ligjit, me notën përkatëse.

---



---



---

Cilat janë, sipas opinionit tuaj, tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me barazinë para ligjit për personat me aftësi të kufizuara ?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## PUNËSIMI, ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi, 4 = shumë

6.1 Punësimi, Arsimit dhe Formimi Profesional						
1	A keni informacion për ndjekjen e kurseve të formimit profesional falas për personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni nga larmia e kurseve që ofrohen në qendrat e formimit profesional?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni nga cilësia e mësimdhënies/përgatitja e instruktorëve në kurset e formimit profesional?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	A janë kurrikulat të qarta, të thjeshta dhe në formate të kuptueshme për ju?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	A ju ofrohet mbështetje me pajisje, mjete për vetëpunësim pasi mbaroni kursin e formimit profesional?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Sa të kënaqur jeni me mundësitë që u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për tu punësuar në përputhje me aftësitë e tyre?	1	2	3	4	S'kam informacion

7	Sa të kënaqur jeni me programet e nxitjes së punësimit që ofron zyra e puësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Sa të kënaqur jeni me mundësitë e ofruara për të kryer praktika profesionale në institucione apo biznese?	1	2	3	4	S'kam informacion
9	Sa të kënaqur jeni me mbështetjen e ofruar për ndërmarjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
10	Sa të kënaqur jeni me cilësinë e shërbimit që ofrohet për personat me aftësi të kufizuara nga zyrat e punësimit?	1	2	3	4	S'kam informacion
11	A bëjnë punonjësit e zyrave të punësimit një vlerësim të detajuar mbi aftësitë dhe nevojat e veçanta për një person me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
12	A ofrohet nga zyrat e punës informacion për programet dhe subvencionet ( <i>mbështetjet financiare</i> ) që ato ofrojnë për punësimin e PAK?	1	2	3	4	S'kam informacion
13	Sa të kënaqur jeni nga fushatat infomuese ( <i>respektimin e kuotës, çështjet e diskriminimit, shembuj pozitiv etj.</i> ) nga zyrat e punës, për punësimin e personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
14	Si do e vlerësoni nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrën e Punësimit?	1	2	3	4	S'kam informacion
15	Si do e vlerësoni nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Qëndrën Rinore?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e punësimit, arsimit dhe formimit profesional, me notën përkatëse.

---



---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me punësimin dhe arsimin profesional të personave me aftësi të kufizuara?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## ARSIMI

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

7.1 Arsimi						
1	Sa të kënaqur jeni me informacionin ( <i>materialet që ofrohen</i> ) nga Bashkia, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni me informacionin ( <i>materialet që ofrohen</i> ) nga DAR, institucionet arsimore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni me shkollimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në përgjithësi ( <i>me programin mësimor, cilësinë e mësimin, aftësitë e mësuesve, pajisjet didaktike, etj.</i> )?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Sa të kënaqur jeni me praninë e mësuesit mbështetës në institucionet arsimore?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	Sa të kënaqur jeni me punën e komisionit të vlerësimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, pranë DAR dhe institucionit arsimor?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Sa të kënaqur jeni me Planin Edukativ Individual (PEI) të nxënësve në shkollë ( <i>procesi i hartimit, ndjekja, vlerësimi i rezultateve, marrja e mendimit të prindërve, etj.</i> ).	1	2	3	4	S'kam informacion
7	Sa të kënaqur jeni me mundësitë që iu jep shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për tu integruar me fëmijët e tjerë, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Sa të kënaqur jeni me ofrimin e transportit falas për të shkuar në shkollë, për fëmijët me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e arsimit, me notën përkatëse.

---

---

---

---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me arsimimin e personave me aftësi të kufizuara?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## KUJDESI SHOQËROR

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

8.1 Kujdesi Shoqëror						
1	Sa të kënaqur jeni me njohuritë e stafit të institucioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar ( <i>arsimit, punësimit, administratorët socialë</i> )?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni me procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga KMCAP (procedurat e përfitimit, trajtimi gjatë intervistës, etj.)?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni me shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara që janë ngritur në zonën tuaj ( <i>qendra ditore, qendra rezidenciale, qendra këshillimi psiko-social dhe terapi të ndryshme</i> )?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Sa të kënaqur jeni me njohuritë dhe informacionin e ofruar nga stafi i shërbimeve sociale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të personalizuar, bazuar në kategorinë e aftësisë së kufizuar dhe nevojat individuale të personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	Sa të kënaqur jeni me masën e pagesës së aftësisë së kufizuar? ( <i>a i mbulon ajo nevojat e një individi me aftësi të kufizuara</i> )?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Sa të kënaqur jeni me ofrimin e mjeteve higjienike dhe sanitare për personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	Sa të kënaqur jeni me shërbimet që mbështesin jetesën e pavarur për persona me aftësi të kufizuara në moshë madhore?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Sa të kënaqur jeni me grantet ( <i>ndihmën financiare</i> ) për strehimin social të dhënë për persona me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj?	1	2	3	4	S'kam informacion
9	Sa të kënaqur jeni me aplikimin/dhënien e tarifave favorizuese për legalizimin e banesave/ambienteve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e Kujdesit Shoqëror, me notën përkatëse.

---



---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me ofrimin e kujdesit shoqëror për persona me aftësi të kufizuara ?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## KUJDESI SHËNDETËSOR

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

9.1 Kujdesi Shëndetësor						
1	Sa të kënaqur jeni me shërbimin për personat me aftësi të kufizuara <b>nw institucionet shëndetësore</b> (procedura e pritjes, sjellja e stafit mjekësor, njohuritë që stafi ka për të orientuar problemin tuaj, etj.)?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni me shërbimin shëndetësor <b>në banesë</b> (kur personi me aftësi të kufizuara e ka të pamundur të lëvizë drejt institucioneve shëndetësore)?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni me ofrimin e <b>shërbimit dentar</b> falas për personat me aftësi të kufizuara <b>në zonën ku banoni</b> ?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Sa të kënaqur jeni me ofrimin e <b>shërbimit dentar</b> falas <b>në shkolla</b> , për fëmijë me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe ata fëmijë që nuk janë të regjistruar në shkollë?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	A janë dentistët të trajnuar për të ofruar shërbim dentar për personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Sipas mendimit tuaj, në Shqipëri, a merren <b>masat e duhura</b> (informim, këshillim për stilin e jetës, mënyrën e të ushqyerit etj.) <b>për të parandaluar</b> aftësinë të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	Sipas mendimit tuaj, në Shqipëri, sa angazhim (sa punë bëhet) ka për <b>zbulimin dhe trajtimin e hershëm</b> të fëmijëve me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Sa të kënaqur jeni me diagnostikimin e aftësisë së kufizuar?	1	2	3	4	S'kam informacion
9	Sa të kënaqur jeni me <b>trajtimin e specializuar</b> që i ofrohet personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
10	Sa të kënaqur jeni me <b>shërbimet riaftësuese</b> (fizioterapi, logoterapi, terapi e të folurit, etj.)?	1	2	3	4	S'kam informacion
11	Sa të kënaqur jeni me informacionin e dhënë nga institucionet publike për shërbime shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
12	Sa të kënaqur jeni me informacionin që ofrohet në lidhje me sëmundje të ndryshme që mund të shkaktojnë aftësi të kufizuara, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe atij të aftësisë së kufizuar?	1	2	3	4	S'kam informacion
13	Sa të kënaqur jeni me fushatat e ndërmarra në zonën tuaj për të ofruar informacion shëndetësor për persona që nuk flasin e nuk dëgjojnë?	1	2	3	4	S'kam informacion
14	Sa të kënaqur jeni për rimbursimin e shpenzimeve për karrige me rrota, orteza, proteza, aparate dëgjimi apo pajisje të tjera të teknologjisë ndihmëse?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e kujdesit shëndetësor, me notën përkatëse.

---



---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## PJESËMARRJA NË POLITIKË DHE NË JETËN PUBLIKE

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

10.1 Pjesëmarrja në Politikë dhe në Jetën Publike.						
1	Sa të kënaqur jeni me informacionin në formate të përshtatura për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni me pjesëmarrjen në zgjedhje përmes sigurimit të kushteve për një votim të lirë, të barabartë e të drejtpërdrejtë?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni me përfshirjen si vëzhgues në procese zgjedhore të personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Sa të kënaqur jeni me nivelin e pjesëmarrjes, përfshirjes dhe përfaqësimit që kanë çështjet e aftësisë së kufizuar, në nivel vendor e qendror?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	Sa të kënaqur jeni me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore (koncerte, teatër, muze, kinema)?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Sa të kënaqur jeni me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive, përfshirë ato të organizuara nga Olimpiku Special?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	Sa të kënaqur jeni me punën e mësuesve të edukimit fizik për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e Pjesëmarrja në Politikë dhe në Jetën Publike, me notën përkatëse.

---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike të personave me aftësi të kufizuara?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## NXITJA E BASHKËPUNIMIT DHE MONITORIMI & VLERËSIMI

1 =Asnjëherë; 2 =ndonjëherë; 3 =shpesh; 4 = gjithmonë

11.1 Nxitja e bashkëpunimit dhe Monitorimi & Vlerësimi.						
1	A keni marrë pjesë në procese të monitorimit të Planit të Veprimit të Aftësisë së Kufizuar 2016-2020	1	2	3	4	S'kam informacion
2	A keni marrë pjesë në konferenca të organizuara nga Ministria mbi vendimmarrjen e mbështetur, shërbimet komunitare, sipërmarrjen sociale?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	A keni marrë pjesë në konferenca në vende antare të BE për të parë e shkëmbyer përvoja pozitive në fushën e aftësisë së kufizuar?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e Nxitja e bashkëpunimit dhe Monitorimi & Vlerësimi, me notën përkatëse.

---

---

---

---

Cilat janë sipas opinionit tuaj, tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me forcimin e bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit me personat me aftësi të kufizuara dhe oranzatat e tyre?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## NDIKIMI NGA COVID-19

Sipas opinionit tuaj, a është ndikuar marrja e shërbimeve të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara të listuara më lart në këtë pyetësor nga situata e emergjencës së koronavirusit / COVID-19? 1.  Po 2  Jo

Nëse po, ju lutem ndani me ne një ose dy shembuj konkretë:

---

---

---

---

**Ju faleminderit!**

**Data:** \_\_\_\_\_ **Ora e mbarimit të intervistës :** \_\_\_\_\_

Kodi pyetësorit

Ora e fillimit të intervistës


## PYETSËOR PËR ORGANIZATAT

Ky pyetësor është pjesë e procesit të vlerësimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2016 – 2020) nga perspektiva e OSHC-ve, personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarëve të tyre në Berat, Dibër, Korçë dhe Lezhë, dhe organizohet në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, që zbatohet nga “World Vision”, “Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (ADRF), dhe “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësitë Kufizuar” (MEDPAK), me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (BE).

Pjesëmarrja juaj në këtë studim është plotësisht vullnetare. Të dhënat e studimit do të jepen të përmbledhura, pa përmendur personin që ka plotësuar pyetsorin. I gjithë informacioni që do të merret nga ky studim do të trajtohet si informacion konfidencial dhe do të jetë vetëm në dispozicion të studjuesit që do të përpunojë të dhënat e këtij studimi. Ju lutem përgjigjuni me vërtetësi çdo pyetjeje, në mënyrë që të dhënat që do të grumbullojmë të paraqesin gjendjen reale, me të gjitha arritjet dhe vështirësitë.

**1. Rajoni:**      1.  Berat                      2.  Dibër                      3.  Lezhë                      4.  Korçë

**Vendi ku operon organizata:** 1.  Fshat                      2.  Qytet  
(mund të zgjidhni të dyja alternativat)

### 3. Unë jam:

- Organizatë e personave me aftësi të kufizuara
- Organizatë që punon për personat me aftësi të kufizuara
- Qendër shërbimesh
- Tjetër, të lutem specifikoj \_\_\_\_\_  
(mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

**3.1. Keni marrë pjesë në plotësimin e pyetësorit të raportit të parë?:**      1.  Po      2.  Jo

**Perceptimi mbi Zbatimin e Planit të Veprimit:**

**Ju lutem vlerësoni nga 1 në 4 alternativat në vijim.**

**Nëse nuk keni informacion, zgjidhni alternativën “s’ kam informacion”.**

**Kur i intervistuari/a refuzon të përgjigjet, në krah të pyetjes shënoni numrin 99.**

## AKSESUESHMËRIA

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

4.1	<b>Si e vlerësoni AKSESUESHMËRINË FIZIKE në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj?</b>					
	Sa të kënaqur jeni me aksesueshmërinë fizike në:					
1	<b>bashkinë tuaj/ në zyrat e njësisë administrative, ku ju banoni?</b>	1	2	3	4	S'kam informacion
2	<b>në institucionet edukuese/arsimore</b> (DAR, Zyrat arsimore, institucionet parashkollore, ato të arsimit baze/ fillor dhe të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, universitetet)?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	<b>institucionet kulturore e sportive</b> (qëndër kulturore, qëndër rinore, kinema, muzeum, fushë sporti, ambiente sportive në shkolla e në sallat sportive etj) në bashkinë/ qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	<b>institucionet shëndetësore</b> (qendër shëndetësore, qëndër spitalore, qëndër rehabilitimi fizik) në qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	<b>institucionet e shërbimeve shoqërore</b> (qëndër ditore/ qëndër zhvillimi, zyrat e Drejtorise rajonale të shërbimit social shtetëror, zyrat e sigurimeve shoqërore), në qytetin/fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	<b>zyrat e punësimit, qëndrat e formimit profesional, shkollat e mesme profesionale, në qytetin/fshatin ku ju banoni?</b>	1	2	3	4	S'kam informacion
7	<b>qëndrat e votimit</b> në qytetin/ fshatin ku ju banoni?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	<b>institucionet e drejtësisë</b> (gjykata, prokurori, polici) në bashkinë tuaj?	1	2	3	4	S'kam informacion
4.2	<b>Si e vlerësoni nivelin e AKSESIT NË INFORMACION në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara?</b>					
1	A merrni informacion nga shërbimet publike mbi legjislacionin/politikat/ programet/ projektet/ çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	A ka mundësi për <b>komunikim të përshtatur</b> (në format audio apo brail etj.) në Bashki, në KMCAP, në qëndra ditore, në qëndra shëndetësore, në kopësht/shkollë/në muze ose ndërmarrje <b>për një person me probleme në shikim ?</b>	1	2	3	4	S'kam informacion
3	A ka mundësi për <b>komunikim të përshtatur</b> (në gjuhën e shenjave etj.) në Bashki, në KMCAP, në qëndra ditore, në qëndra shëndetësore, në kopësht/shkollë/në muze ose ndërmarrje <b>për një person me probleme në dëgjim e në të folur?</b>	1	2	3	4	S'kam informacion
4	A ka mundësi për <b>komunikim të përshtatur</b> , (në formate të thjeshta, me gjuhë të thjeshtë, me figura ) në Bashki, në KMCAP, qëndra ditore, në qëndra shëndetësore, në kopësht/shkollë/ në muze ose ndërmarrje <b>për një person me aftësi të kufizuara intelektuale?</b>	1	2	3	4	S'kam informacion
5	A ka mundësi për <b>komunikim të përshtatur</b> (me gjuhën e shenjave etj.) <b>në shtëpi</b> dhe me anëtarët e familjes <b>për personat me probleme në dëgjim?</b>	1	2	3	4	S'kam informacion
6	A i përdorni faqet e internetit të institucioneve publike dhe nëse po, a janë ato të përshtatura?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	A ka informacion të përshtatur në mediet kombëtare (përkthim në gjuhën e shenjave, informacion të thjeshtuar, titra)?	1	2	3	4	S'kam informacion

4.3 Si e vlerësoni AKSESUESHMËRINË në transportin publik për personat me aftësi të kufizuara në bashkinë tuaj?						
1	Sa të lehtë e ka një person me karrocë ose i verbër të përshkojë rrugët e qytetit e të shkojë ku ka nevojë?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	A iu rimbursohen kostot e transportit personave me aftësi të kufizuara, kur udhëtojnë me mjete të transportit <b>urban</b> ?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	A iu rimbursohen kostot e transportit personave me aftësi të kufizuara, kur udhëtojnë me mjete të transportit <b>interurban</b> ?					
4	Sa të kënaqur jeni me nivelin e rimbursimit të karburantit?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e aksesueshmërisë, me notën përkatëse.

---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara ?

4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_

## BARAZIA PARA LIGJIT

Ju lutemi në varësi të pyetjes vlerësoni përgjigjen sipas njërës nga format/alternativat në vijim:

**1 =Asnjëherë; 2 =ndonjëherë; 3 =shpesh; 4 = gjithmonë**

**1= aspak, 2 = pak, 3 = disi, 4 = shumë**

5.1 Barazia. Si e vlerësoni shërbimin e ndihmës juridike falas për personat me aftësi të kufizuara?						
1	A marrin ndihmë juridike ( <i>ndihmë ligjore</i> ) personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Nëse po, a janë ata të kënaqur? Nëse jo, vijoni në pyetjen 5.	1	2	3	4	S'kam informacion
3	A janë të trajnuar për çështje të aftësisë së kufizuar, juristët që ofrojnë ndihmë juridike?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Nëse është ofruar ndihmë juridike, a është komunikuar në mënyrë të përshtatut (përkthim në gjuhën e shenjave, formate Braille, gjuhë e thjeshtuar etj)?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	A keni marrë ndonjë trajnim për shërbimet e ndihmës juridike, kriteret e përfitimit, e të tjera?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	A ka/keni marrë ndonjëherë informacion në internet për ndihmën juridike?	1	2	3	4	S'kam informacion

7	A njihni persona që janë nën kujdestari ligjor (jo kujdestari i KMCAP-së)?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Nëse po, si e ushtron ata, kujdestarinë? Nëse jo, kaloni në pyetjen 9, në vijim.	1	2	3	4	S'kam informacion
9	A keni mbështetur person/a me aftësi të kufizuara në gjykatë, prokurori?	1	2	3	4	S'kam informacion
10	A keni mbetur të kënaqur nga procedurat? shpenzimet, kohëzgjatja, aksesit, komunikimi?	1	2	3	4	S'kam informacion
11	A keni dëgjuar për ndryshime ligjore në lidhje me kujdestarinë ligjore?	1	2	3	4	S'kam informacion
12	A keni dëgjuar për vendimarrjen e mbështetur?	1	2	3	4	S'kam informacion
13	A mendoni që sistemi i drejtësisë është i aksesueshëm për PAK?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj në fushën e barazisë përpara ligjit, me notën përkatëse.

---



---



---

Cilat janë, sipas opinionit tuaj, tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me barazinë para ligjit për personat me aftësi të kufizuara ?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## PUNËSIMI, ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi, 4 = shumë

6.1 Punësimi, Arsimi dhe Formimi Profesional						
1	A keni informacion për ndjekjen e kurseve të formimit profesional falas për personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni nga larmia e kurseve që ofrohen në qendrat e formimit profesional?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni nga cilësia e mësimdhënies/përgatitja e instruktorëve në kurset e formimit profesional?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	A janë kurrikulat të qarta, të thjeshta dhe në formate të kuptueshme për ju?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	A ju ofrohen mbështetje me pajisje, mjete për vetëpunësim pasi personat me aftësi të kufizuara përfundojnë kursin e formimit profesional?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Si i vlerësoni mundësitë që i'u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për tu punësuar në përputhje me aftësitë e tyre?	1	2	3	4	S'kam informacion

7	Sa të kënaqur jeni me programet e nxitjes së punësimit që ofron zyra e punës për personat me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
8	Sa të kënaqur jeni me mundësitë që iu ofrohen personave me aftësi të kufizuara për të kryer praktika profesionale në institucione apo biznese?	1	2	3	4	S'kam informacion
9	Sa të kënaqur jeni me mbështetjen e ofruar për ndërmarjet sociale që punësojnë persona me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
10	Sa të kënaqur jeni me cilësinë e shërbimit që ofrohet për personat me aftësi të kufizuara nga zyrat e punësimit?	1	2	3	4	S'kam informacion
11	A bëjnë punonjësit e zyrave të punësimit një vlerësim të detajuar mbi aftësitë dhe nevojat e veçanta për një person me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
12	A ofrohet nga zyrat e punësimit informacion për programet dhe subvencionet (mbështetjet financiare) që ato ofrojnë për punësimin e PAK?	1	2	3	4	S'kam informacion
13	Sa të kënaqur jeni nga fushatat infomuese (respektimin e kuotës, çështjet e diskriminimit, shembuj pozitiv etj.) nga zyrat e punës, për punësimin e personave me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
14	A ka persona me aftësi të kufizuara të punësuar në Zyrën e Punësimit?	1	2	3	4	S'kam informacion
15	A ka persona me aftësi të kufizuara të punësuar në Qendrën Rinore?	1	2	3	4	S'kam informacion

Ju lutem ndani me ne një përvojë (histori, ngjarje) që ilustron vlerësimin tuaj për fushën e punësimit, arsimin dhe formimin profesional, me notën përkatëse.

---



---



---



---

Cilat janë sipas opinionit tuaj tre nevojat kryesore të paplotësuara dhe emergjente që lidhen me punësimin dhe arsimin profesional të personave me aftësi të kufizuara?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## ARSIMI

1= aspak, 2 = pak, 3 = disi dhe 4 = shumë

7.1	Arsimi					
1	Sa të kënaqur jeni me informacionin (materialet që ofrohen) nga Bashkia, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
2	Sa të kënaqur jeni me informacionin (materialet që ofrohen) nga DAR, institucionet arsimore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?	1	2	3	4	S'kam informacion
3	Sa të kënaqur jeni me shkollimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në përgjithësi (me programin mësimor, cilësinë e mësimit, aftësitë e mësuesve, pajisjet didaktike, etj.)?	1	2	3	4	S'kam informacion
4	Sa të kënaqur jeni me praninë e mësuesit mbështetës në institucionet arsimore?	1	2	3	4	S'kam informacion
5	Sa të kënaqur jeni me punën e komisionit të vlerësimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, pranë DAR dhe institucionit arsimor?	1	2	3	4	S'kam informacion
6	Sa të kënaqur jeni me Planin Edukativ Individual (PEI) të nxënësve në shkollë (procesi i hartimit, ndjekja, vlerësimi i rezultateve, marrja e mendimit të prindërve, etj.)?	1	2	3	4	S'kam informacion
7	Sa të kënaqur jeni me mundësitë që i'u jep shkolla fëmijëve me aftësi të kufizuara për tu integruar me fëmijët e tjerë, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme?	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>S'kam informacion</b>
